




PARATHËNIE

30 vitet e fundit, Shqipëria ka votuar 17 herë, prej të cilave 9 herë për të zgjedhur qeverinë qendrore dhe 8 herë për të zgjedhur kryetarët e bashkive përmes zgjedhjeve vendore.

Prej vitesh, përveç cilësisë së posterave dhe fushatave të sofistikuara elektorale, kandidatët u drejtohen njerëzve/votuesve në mënyrë të njëanshme dhe me premtime në këmbim të votave. Kësisoj, premtimet e parealizuara nga zgjedhjet e mëparshme përsëriten, e ndër-kohë një tjetër votë kërkohet në këmbim.

Nisur nga ky kontekst dhe nga përvojat ndër vite, me mënyrën sesi i qasemi këtij momenti të rëndësishëm zgjedhor, lindi nevoja mes aktorëve të shoqërisë civile në vend për të ndarë/komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë propozime konkrete për ndryshim me partitë politike në vend në prag të zgjedhjeve parlamentare të 25 prillit.

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit dhe *Westminster Foundation for Democracy*, në bashkëpunim me një spektër të gjerë organizatash dhe aktorësh kontribuues nga shoqëria civile, organizuan Forumin Kombëtar “Qeverisje për Ndryshim – Propozime të Shoqërisë Civile” më 23.02.2021, si një platformë paraelektorale, ku aktorë të shoqërisë civile nga sektorë të ndryshëm dhe me mandate të qarta përfaqësuese, parashtruan problematika dhe artikuluan propozime për ndryshim. Kjo nismë synon të ndikojë përmbajtësisht në agjendat dhe programet politike në terma sa më konkretë dhe të matshëm, përtej semantikës dhe metaforave në takime elektorale.

Ky dokument përmban propozimet për ndryshime të prezantuara përgjatë forumit, me fokus në zhvillim ekonomik dhe rajonal; qeverisje dhe decentralizimi; edukim, kërkim shkencor dhe media; mjedis, energji dhe ndryshimet klimatike; shëndet dhe siguri ushqimore; të drejtat e njeriut, rini, art dhe kulturë. Propozimet vijnë si kontribute të drejtpërdrejta dhe ekskluzive të organizatave pjesëmarrëse, të cilat mund të kontaktohen për hulumtime të mëtejshme në lidhje me propozimet e parashtruara dhe pse jo, mbështetje teknike për shtjellimin apo realizimin e tyre.

Ne shpresojmë që këto propozime do të merren në konsideratë nga aktorët politikë dhe si aktorë të shoqërisë civile angazhohemi të inkurajojmë dhe monitorojmë ecurinë e zbatimit të këtyre propozimeve për ndryshim dhe të çdo nisme tjetër në këtë drejtim.

PASQYRA

EKONOMIA, QEVERISJA, MJEDISI, INFORMACIONI DHE EDUKIMI

Zhvillimi ekonomik dhe zhvillimi rajonal

Sektori privat dhe industria

Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë - Z. Arben Shkodra 8

Zhvillimi rural

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar - Z. Agim Rrapaj. 10

Biznesi dhe teknologjia

Albanian Business Services Association - Znj. Arjodita Mustali. 15

Zhvillimi i turizmit

Shoqata Shqiptare e Turizmit - Z. Zak Topuzi. 20

Shoqata Shqiptare e Turoperatorëve dhe Agjencive Turistike - Z. Kliton Gërxhani. 23

Zhvillimi rajonal

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit - Znj. Anila Bejko. 27

Qeverisja dhe demokratizimi

Demokratizimi, institucionet dhe administrata Publike

Instituti i Studimeve Politike - Z. Afrim Krasniqi. 31

Shoqëria civile

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim / Burimi Kombëtar për Shoqërinë Civile në Shqipëri - Znj. Juliana Hoxha. 34

Decentralizimi

Shoqata për Autonominë Vendore - Znj. Adelina Farrici. 39

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë - Z. Agron Haxhimali. 41

Prokurimi publik

Open data - Znj. Aranita Brahaj. 44

Edukimi, kërkimi shkencor, dhe media

Edukim, kërkim, inovacion

Konferenca e Rektorëve - Prof. Dr. Artan Hoxha. 47

Forumi i Pavarur i Rektorëve - Dr. Elona Karafil. 50

Prof. Dr. Artan Fuga. 52

SwissContact - Z. Fatjon Dragoshi 59

Media

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë - Z. Aleksandër Çipa. 64

Këshilli Shqiptar i Medias - Z. Koloreto Cukali.	66
---	----

Digjitalizimi dhe shoqëria e informacionit

Shoqata Shqiptare e TIK - Z. Dritan Mezini.	69
--	----

Mjedisi, energjia dhe ndryshimet klimatike

Mjedis, klima, biodiversiteti, ekonomia qarkulluese, zvogëlimi i riskut të fatkeqësive REC - Z. Mihallaq Qirjo.	72
---	----

Energji/Ndryshime klimatike

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit - Z. Rodion Gjoka.	77
---	----

Pyjet dhe Kullotat

Organizata PSEDA - ILIRIA - Z. Abdulla Diku.	81
---	----

SHËNDETI, TË DREJTAT E NJERIUT, ARTI DHE KULTURA

Shëndeti dhe siguria ushqimore

Sistemi shëndetësor

Together for Life - Znj. Eglantina Bardhi.	87
Urdhri i Mjekut - Dr. Fatmir Brahimaj.	90

Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit

Industria Ushqimore Shqiptare - Z. Alban Zusi.	92
Shoqata për Mbrojtjen e Konsumatorit, Qendra Alert - Z. Granit Sokolaj.	94

Të Drejtat e Njeriut, rinia, arti dhe kultura

Të drejtat e njeriut


Komiteti i Helsinkit - Znj. Erida Skëndaj.	97
Qendra Europiane - Znj. Ina Xhepa.	100

Rinia

Qëndresa Qytetare - Z. Rigels Xhemollari.	103
World Vision - Z. Igli Çerpja.	106

Arti dhe kultura

Organizata Argjiro - Znj. Ilda Mara.	108
---	-----



QEVERISJE PËR NDRYSHIM

EKONOMIA,
QEVERISJA,
MJEDISI,
INFORMACIONI
DHE EDUKIMI

EKONOMIA, QEVERISJA, MJEDISI, INFORMACIONI DHE EDUKIMI

Zhvillimi ekonomik dhe zhvillimi rajonal

Sektori privat dhe industria

Z. Arben Shkodra / Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Në lidhje me kontekstin e zhvillimit për sektorin që përfaqëson, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë parashtron nevoja dhe probleme si në vijim:

- Mungesë e dialogut publik-privat në mënyrë sistematike dhe me dashje, e cila sjell krijimin e një klime mosbesimi të prodhuesve ndaj politikave publike që qeveria ndërmerr.
- Pasiguria ligjore që sjell hartimi i keq i legjislacionit, duke krijuar dëme dhe përkeqësim të klimës së biznesit.
- Mbirregullim procedural, që sjell mbingarkesë në aktivitetin e përditshëm të sipërmarrjes, me një barrë burokratike që krijon mundësinë për korrupsion dhe padyshim rëndon financat e saj.
- Sistemi fiskal i çoroditur dhe me shumë shtojca, i cili prodhon vetëm konfuzion dhe vështirësi për pagesën e taksave dhe tatimeve, duke krijuar fasha që vështirësojnë marrëdhënien tregtare midis niveleve të ndryshme të sipërmarrjes.
- Mungesë e një strategjie për eksportet, gjë që vështirëson ose pengon nxitjen e tyre.
- Problemet me aftësimin në punë, të cilat sjellin ulje të produktivitetit dhe mungesa të theksuara në stafin e industrive prodhuese, duke ulur ndjeshëm nxitjen e punësimit.

2. Propozime për ndryshim

Nisur nga problemet e parashtruara, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë ofron propozime konkrete për ndryshim:

- Ndryshimi i ligjit për konsultimin publik, duke vendosur penalizime për çdo zyrtar që anashkalon dialogun, si dhe krijimi i një platforme të përhershme konsultimi.
- Përcaktimi i një mekanizmi të ri për hartimin e politikave publike në dialog me sipërmarrjen, për të garantuar jo vetëm cilësinë e legjislacionit, por edhe harmonizimin dhe përputhjen e plotë me direktivat e BE-së.
- Fillimi i një reforme të thellë të lehtësimit procedural, duke ulur ndjeshëm jo vetëm mbirregullimin, por edhe tarifat për procedurat që shteti vendos ndaj sipërmarrjes.

- Hartimi i legjisllacionit të ri të procedurave tatimore dhe rikonceptimi i një sistemi fiskal të thjeshtë, të kuptueshëm, të zbatueshëm, që nuk krijon disavantazhe midis kategorive të ndryshme të sipërmarrjes.
- Hartimi i strategjisë për eksportet dhe i dokumentit strategjik mbi politikat industriale, të cilat duhet të mbështeten me politika publike, që çojnë në rritjen e aftësisë për të konkurruar.
- Rikonceptimi i modelit të arsimit profesional në bashkëpunim me organizatat e sipërmarrjes, për të siguruar fuqi punëtore të kualifikuar dhe për të nxitur punësimin.

Zhvillimi rural

Z. Agim Rrapaj / Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar - KASH

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Në ditët e sotme, fermerët gjenden të frikësuar nga modeli ekonomik i dështuar i kooperimit që ndodhi para vitit 1990. Mungesa e përvojës për të zbatuar me eficiencë modelin e ri ekonomik, bën që jo vetëm të mos i kushtohet vëmendje, por edhe të nënvlerësohet **procesi i kooperimit dhe koordinimit**, jo vetëm midis hallkave të zinxhirit ushqimor, por dhe me institucionet e tjera publike. Si pasojë, edhe partitë politike, në programet e hartuara deri tani, nuk po u japin zgjidhje eficiente disa problemeve të parashtruara nga grupimi më i madh i fermerëve, si: **konkurrenca e pandershme, informaliteti** në përmasa të mëdha, **kosto të larta të prodhimit**, krahasuar me fuqinë blerëse dhe koston e produkteve të importuara, **tarifa të larta** të shërbimeve me mekanikë bujqësore dhe jo vetëm, **çmimi i lartë i lëndëve të para**, inputeve dhe mallrave të importuara, moskompensimi në kohë dhe me kosto të lartë i **dëmtimeve nga kushtet jo të mira atmosferike**, efienca e ulët e investimeve, kjo edhe për shkak të **moskoordinimit për financimin harmonik** në të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor, mospërdorimi i **kredive me kushte lehtësuese** dhe me interesa të ulëta, mosprogramimi në masën e duhur i buxhetit për zhvillimin rural dhe **mosdisbursimi në kohë i fondeve grant**, të akorduara nga buxheti dhe donatorët etj.

Në Shqipëri, **bujqësia** ka qenë dhe do të vazhdojë të mbetet edhe për shumë kohë **hallka kryesore** dhe më e rëndësishme e zinxhirit ushqimor. Në vitin 1991, Shqipëria kishte 699 021 ha tokë bujqësore që kultivohej, nga e cila mbi 400 mijë ha ishte sipërfaqe toke që ujitej dhe punohej me mekanikë bujqësore. Nga viti 1991 e në vazhdim u nda sipas Ligjit Nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për token", dhe legjislacionit për ndarjen e tokës së ndërmarrjeve bujqësore shtetërore, duke bërë që rreth **460 mijë familje të përfitojnë tokë bujqësore falas** dhe 354 pronarë të rinj të regjistroheshin si fermerë. Fermerët prodhonin dhe po prodhojnë ende një gamë të gjerë lëndësh të para, për nevojat familjare, për blegtorinë e tyre, dhe një pjesë që tepron për tregti. **Pikërisht kjo tepricë produkti që dedikohet për treg**, ka qenë dhe mbetet një problem i madh që kërkon zgjidhje, duke **vlerësuar procesin e kooperimit dhe koordinimit**.

Toka bujqësore, nisur nga interesa politike, e për të kapërcyer disa vështirësi të çastit, si dhe nga mungesa e dijes për pasojat negative të fragmentarizmit, **u copëzua në 1,8 milionë parcela**. Infrastruktura e ujitjes dhe, veçanërisht, kanalet kulluese dhe vaditëse nuk u mirëmbajtën dhe brenda një kohe të shkurtër, dolën jashtë funksionit. **Konsolidimi i tokës bujqësore** është një tjetër problem madhor që kërkon zgjidhje, sërish duke integruar **procesin e Kooperimit dhe Koordinimit**. Me angazhimin e KASH-it dhe me iniciativë individuale, fermerët kanë bërë disa përpjekje për konsolidim, duke krijuar dhe regjistruar në QKB 104 Shoqëri Bashkëpunimi Bujqësor (SHBB), por pa realizuar eficiencë të lartë.

Formën e klasterit po e përdorin rreth 42 mijë fermerë, kryesisht për të shitur prodhimet e tyre në eksport, duke bashkëpunuar me rreth 227 qendra grumbullimi. Ky grupim ka arritur disa **rezultate pozitive**. Për të përmirësuar procesin e formalizimit, mbi **54 mijë fermerë** ose 15% e fermerëve të reregjistruar janë pajisur me **NIPT fermeri**, proces që u mundëson mekanizim më të lehtë të punës, të përfitojnë nga inovacioni dhe digjitalizimi, të shesin prodhimet e tyre në mënyrë formale, të përfitojnë fonde grant nga buxheti i shtetit dhe BE-së, rimbursim të TVSH-së, dhe, së fundi, të përfitojnë edhe mbulim të 50% të kostos së naftës që u nevojitet për punimet bujqësore.

Problem i madh për zgjidhje është grupimi tjetër prej 300 mijë fermerësh të regjistruar, por të paformalizuar, që kanë në pronësi dhe vendosin për eficiencën e rreth 85% të sipërfaqes bujqësore, pra, për rreth 600 mijë ha tokë. Situata aktuale e kooperimit dhe koordinimit **nuk u mundëson përfitimin** e asnjë prej lehtësive të drejtpërdrejta të përmendura më lart. Kjo do të sjellë edhe **më shumë sipërfaqe toke të lënë djerrë në të ardhmen**. Shqipëria, sipas sondazheve të KASH-it, disponon mbi **100 mijë ha tokë produktive që nuk kultivohet**. Nëse kjo sipërfaqe do të kultivohet, të ardhurat bruto të fermerëve do të rriten me mbi 100 milionë euro në një vit bujqësor. Në të gjithë hallkat e zinxhirit ushqimor mungon **potenciali për punësim** edhe për 100 mijë forca të reja pune, të cilat duhet të incentivohen për t'u bërë aktorë në zhvillim rural.

2. Propozime për ndryshim

Procesi i kooperimit në bujqësi dhe në të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor, bazuar në eksperiencën e vendeve të tjera, realizohet përmes disa formave eficiente të organizimit si: Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB), Shoqëritë Anonime (SHA), Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK), si dhe në formën e Klasterave.

KASH-i u ka propozuar një paketë masash shoqatave simotra, institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve publike, partive politike në pushtet edhe në opozitë, në katër drejtime kryesore: në procesin e **kooperimit dhe koordinimit**; në fushën e **mekanizimit, inovacionit dhe digjitalizimit**; për **rritjen e financimit** dhe konsolidimin e sektorit të mikrofancës; si dhe për **Përmirësimin e ligjeve** dhe të disa akteve nënligjore, për t'i përafruar me legjislacionin evropian.

A. Për procesin e kooperimit dhe koordinimit:

- Të krijohet një front i përbashkët dhe të punohet me synime dhe objektiva të unifikuar për mbështetjen e formave bashkëkohore të organizimit të fermerëve, kryesisht në **SHBB dhe Klastera**. Në këtë drejtim, prioritet kryesor është është

grupimi i **300 mijë fermerëve që është aktualisht i paorganizuar**.

- **Të falen gjordat dhe kamatëvonesat për SHBB**, që rezultojnë aktualisht debitorë dhe që faktikisht janë dhe do të jenë të pamundura për t'u arkëtuar nga organet tatimore dhe doganore.
- Të shfuqizohet ose amendohet Ligji Nr. 38/2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor". **SHBB dhe Klasterat të trajtohen në ligj me statusin e shoqërive jofitimprurëse**. Për SHBB-në në tërësi, dhe për ato që do të marrin me qira toka prone publike djerrë, në veçanti, **të stimulohen duke aplikuar tarifën 1 euro** dhe të diferencohet në rritje mbështetja me grante, me kredi me kushte lehtësuese dhe me mbështetje prioritare nga projektet e donatorëve.
- Administratorët e SHBB-së duhet të pajisen me një **certifikatë të posaçme kualifikimi** dhe **paga e tyre duhet të kompensohet** pjesërisht për 5 vitet e para përmes një skeme granti.
- **Të unifikohet me 20% ose me 6% rimbursimi i TVSH-së** kur blihen prodhimet tek fermerët vendas, me atë të pagesës që bëhet për TVSH-në në buxhet nga qendrat e grumbullimit dhe nga SHBB-ja, kur prodhimet shiten në treg pas ambalazhimit dhe standardizimit prej këtyre të fundit.
- Qeveria të organizojë procesin e **vlerësimit të tokave bujqësore produktive të lëna djerrë** dhe, për ata fermerë që nuk e kultivojnë pa arsye objektive, apo që u është propozuar një kërkesë për ta marrë me qira dhe nuk e kanë pranuar, të detyrohen me ligj **të paguajnë një taksë shumë herë më të madhe** sesa taksa aktuale e tokës.
- **Të caktohet një afat** për pajisjen e poseduesve të tokës bujqësore, dhe jo vetëm, me **certifikatën e pronësisë së tokës**.

B. Për fushën e digjitalizimit, inovacionit dhe mekanizimit:

- **Ristrukturimi i programit të Qendrës Kombëtare të Biznesit** ose krijimi i një Qendre Kombëtare të Regjistrimit të dedikuar Agrobiznesit, për të mundësuar **regjistrimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së fermerëve** dhe atyre që operojnë në hallkat kryesore të zinxhirit ushqimor. Aktualisht, fermerëve me **NIPT Fermeri** nuk u mundësohet regjistrimi në QKB. Gjithashtu, për SHBB-të e regjistruara, për Federatat, Konfederatën dhe klasterat, QKB-ja nuk ka një program specifik për ndjekjen e veprimtarisë së tyre.

- Hartimi i **regjistrimit elektronik të fermës** dhe pajisja me kartë elektronike për marrjen e disa shërbimeve nga fermerët.
- Mbështetje ndaj shoqatave të agrobiznesit sipas sektorëve apo hallkave kryesore të zinxhirit ushqimor, për të ndërtuar dhe për të përdorur gjerësisht platforma elektronike specifike komunikimi.
- **Krijimi i librit kombëtar të regjistrimit të mjeteve të mekanikës bujqësore.** Kjo duhet të shoqërohet me masa mundësuese ligjore dhe administrative për subjektet e zinxhirit ushqimor, **që të pajisin të gjitha mjetet e mekanikës bujqësore me të gjitha dokumentet për qarkullim sipas standardeve bashkëkohore, të kërkuara edhe nga legjislacioni në fuqi.**

C. Në lidhje me rritjen e financimit dhe konsolidimin e sektorit të mikrofinancës

- **Të rritet ndjeshëm financimi nga buxheti i shtetit** për të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor.
- **Institucioneve të mikrofinancës** dhe veçanërisht Kooperativës financiare “FED INVEST” SHKK, **t’u akordohen të njëjtat lehtësi** si ato të akorduara në dy paketat e para nga qeveria dhe Banka e Shqipërisë **për bankat e nivelit të dytë.** BERZH duhet të mundësojë përfshirjen e Kooperativës financiare “FED INVEST” SHKK në **skemën e garancisë së dhënies së kredive për subjektet prodhuese** të zinxhirit ushqimor, që nuk e kanë kolateralin e nevojshëm të kërkuar nga institucionet kredidhënëse.
- **Fondet e mbetura të IPARD II** për thirrjen e tretë **të disbursohen sa më parë** të jetë e mundur dhe **fondet e parashikuara për masat 4 dhe 5 të pahapura akoma, të vihen në dispozicion** të subjekteve të hallkave të zinxhirit ushqimor.
- **Të krijohen kushte për zgjerimin e bazës së taksapaguesve,** kontribuesve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe përfituesve të kredive me kushte lehtësuese, të fondeve grant.
- **Subjekteve të zinxhirit ushqimor t’u falen disa detyrime të prapambetura** në vite dhe të pamundura për t’u arkëtuar në vijim si:

- Detyrimet të cilat janë krijuar padrejtësisht për disa subjekte, që kanë kontribuar dhe kontribuojnë në mirëfunksionimin e hallkave të zinxhirit ushqimor, **dhe kanë patur si burim fondet grant të dhëna nga qeveria e Japonisë**, zbatuar e disbursuar përmes Projektit “Rritja e Prodhimit Ushqimor 2KR” dhe “Non Projekt Grant Aid” për blerjen e disa mallrave për këto subjekte në vitet 1999-2006.
- **Detyrimet e prapambetura** që kanë këto subjekte edhe ndaj Agjencisë së Trajtimit të Kredive me probleme.
- MBZHR dhe AZHBR **të ristrukturojnë të gjitha afatet për kreditë e dhëna** për subjektet e zinxhirit ushqimor dhe **të falen gjordat dhe interesat e papaguara më parë deri në përfundim të gjendjes së emergjencës**.
- MBZHR **të rishikojë të gjitha kontratat e dhënies së tokës** me qira subjekteve të hallkave të zinxhirit ushqimor, duke u falur të gjitha gjordat dhe kamatëvonesat e krijuara deri në përfundim **të gjendjes së emergjencës së krijuar nga tërmeti, pandemia Covid-19 dhe kushtet e vështira atmosferike**.

D. Përmirësimi i ligjeve dhe akteve nënligjore të mëposhtme, për t'i përafruar me ato evropiane:

- Ligji nr. 8669, datë 26.10.2000, “Për Regjistrimin e Përgjithshëm të Popullsisë dhe Banesave”;
- Ligji nr. 7747, datë 28.07.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)” i ndryshuar;
- Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë; Miratuar me ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, ndryshuar me ligjin nr. 9808, datë 24.09.2007 dhe ligjin nr. 10488, datë 05.12.2011.
- Ligji nr. 62/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 38/2012, “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor”;
- Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për Zhvillimin Bujqësor Rural”;
- Ligji 10431/2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- Ligji 10463/2011, “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”;
- **Hartimi dhe miratimi i një ligj të ri “Për siguracionet** në hallkat kryesore të subjekteve prodhuese të zinxhirit për furnizimin e popullit me ushqime”.

Biznesi dhe teknologjia

Znj. Arjodita Mustali / Albanian Business Services Association (ABSA)

ABSA është një organizatë e pavarur joqeveritare, jopolitike dhe jofitimprurëse, e cila operon në sektorin e shërbimeve të biznesit në formën e anëtarësisë dhe synon të përfaqësojë dhe të mbrojë të drejtat dhe interesat e përbashkëta ekonomike, profesionale dhe shoqërore të anëtarëve të saj dhe punëdhënësve të këtij sektori, për tregun vendas dhe atë të huaj. Misioni i saj është lobimi, ndërmjetësimi dhe ndërtimi i urave të dialogut ndërmjet këtij sektori, bizneseve dhe institucioneve shtetërore.

ABSA synon që të jetë autoriteti drejtues, sa i përket sektorit të nënkontraktimit të shërbimeve të biznesit, e t'u vijë në ndihmë bizneseve në këta sektorë për të përmirësuar mënyrën e tyre të funksionimit, për të rritur kapacitetet e punonjësve të punësuar në këta sektorë, si dhe të jetë një përfaqësues i denjë i nevojave të sektorëve.

ABSA, së shpejti ABSL Albania, mbulon sektorin e shërbimeve të biznesit, duke përfshirë sektorin BPO (*Business Process Outsourcing*), ITO (*Information Technology Outsourcing*), SSC (*Shared Service Center*) dhe R&D (*Research and Development*). Sektori përfshin shërbime të ndryshme, duke filluar nga shërbimet e klientit dhe ato me vlerë të shtuar si analiza financiare, burime njerëzore, analiza të dhënash, kodim/programim, shërbime IT, kërkim, zhvillim etj. Sektori në Shqipëri ofron punësim për rreth 30 000 të rinj, ka një xhiro vjetore mbi 500 milionë euro ose rreth 5% të GDP-së, si dhe është i orientuar drejt eksportit. Gjatë aktiviteteve tona me biznese dhe *stakeholders* (aktorë) të tjerë, kemi identifikuar këto probleme kryesore:

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

1. Zhvillimi i kapitalit njerëzor. Bizneset tona janë para sfidës për të zhvilluar shërbime të reja me vlerë të shtuar dhe për këtë kërkohen aftësi profesionale, që do të mundësojnë edhe zhvillimin e avantazheve konkurruese. Pjesa më e madhe e bizneseve mbështetet te burimet e veta për trajnimin e fuqisë punëtore, e cila është një kosto në rritje për to. Bashkëpunimi i bizneseve me sektorin akademik dhe qendrat kërkimore mbetet në nivele të ulëta në rang rajonal, në shifrat prej 9%, ku bashkëpunojnë vetëm me entitete të tilla për kërkim dhe zhvillim (R&D) (RCC, 2020, f.114)¹.

2. Mospërshtatje e kuadrit ligjor për sektorin BPO. Ekzistojnë problematika të tilla si mosnjohja e shumë shpenzimeve në bilanci vjetore, rimbursimi me shumë vonesë i TVSH-së për kompanitë BPO pa risk etj. (ABSA, 2020)²

¹ Regional Cooperation Council, 2020. *Balkan Barometer 2020, Business Opinion Analytical Report*. <https://www.rcc.int/balkanbarometer/publications>.

² ABSA, 2020. *Business Process Outsource*. <https://absa.al/wp-content/uploads/2019/03/BUSINESS-PROCESS-OUTSOURCE-Shqip.pdf>.

3. Inovacioni. Pjesa më e madhe e bizneseve mbështetet te burimet e veta për të përmbushur nevojën e tyre për teknologji të reja. Pra, megjithëse teknologjia është një mjet i nevojshëm për bizneset, digjitalizimi dhe inovacioni mbeten të cunguar nëse nuk ka informim për mundësitë e bashkëpunimit me aktorë të tjerë apo shfrytëzim të burimeve ekzistuese, qoftë nga partnerë shtetërorë apo nga donatorë privatë.

4. Mungesa e statistikave të plota të sektorit (sipas rekomandimeve të mbledhjes së Këshillit të Investimeve, më datë 27.04.2016). Brenda sektorit ICT/BPO ka shumë kompani që ofrojnë shërbime me vlerë të shtuar, por në statistikatat e INSTAT-it dalin të dhëna vetëm për *Call Center*-at.

2. Propozime për ndryshim

1. Zhvillimi i kapitalit njerëzor. Të krijohen incentiva për trajnimin e fuqisë punëtore. Të konsiderohet mundësia që për personat e punësuar rishtazi në sektorët BPO, kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për muajin e parë (periudha e trajnimit) të mbulohen nga shteti dhe jo nga sipërmarrësi (sipas rekomandimit nr. 2.3 të mbledhjes së Këshillit të Investimeve, datë 27.04.2016).

2. Mospërshtatje e kuadrit ligjor për sektorin BPO. Evidentimi i kostove të njohura dhe të panjohura të kompanive të shërbimeve të biznesit; përfshirja e kompanive BPO në skemën e rimbursimit të shpejtë të TVSH-së, ashtu siç veprohet me sektorët e fasonerisë, duke qenë se janë sektorë eksporti (ABSA, 2020).

3. Inovacioni. Bashkëpunimi me sektorin e arsimit është jetik për të avancuar me procesin e digjitalizimit. Financimi i projekteve “Triple Helix”, duke përfshirë aktorët publikë, kompani private dhe universitete. Bizneset mund të optimizojnë performancën e tyre me anë të transformimit digjital në menaxhim, financë dhe komunikim & marketing. Raste Suksesi: Të punuarit *remote* u provua si një rast i suksesshëm dhe për disa biznese arriti të përballonte edhe kostot e gjendjes së pandemisë.³

4. Mungesa e statistikave të plota të sektorit. Duke parë mungesën e të dhënave, është e nevojshme që INSTAT-i dhe QKB-ja të përditësojnë të dhënat më specifike për sektorin BPO, që do të ndihmojë procesin e politikëbërjes dhe për të tërhequr investitorë të huaj. Për këtë, mund të shfrytëzohet mbështetje nga donatorët.

³ Fleksibiliteti dhe qëndrueshmëria e biznesit në kohë krize. ABSA, 2020. <https://www.youtube.com/watch?v=6yDfNBKPTss&feature=youtu.be>

SHTOJCË

Sektori BPO në Shqipëri

Sektori BPO konsiderohet si një nga aktivitetet me rritjen më të madhe në vitet e fundit. Ky sektor, në Shqipëri, ka potencial për t'u zgjeruar më tej dhe për t'u kthyer në një nga promotorët kryesorë të rritjes në vend.

- Së pari, duke përfituar nga aftësia e popullsisë **për të folur disa gjuhë**, Shqipëria synon të tërheqë investitorë të huaj, që mund të ofrojnë shërbime në një treg më të gjerë në Evropën Perëndimore.
- Së dyti, sektori tregon perspektivë për t'u zhvilluar, duke **diversifikuar gamën e tij të aktiviteteve**, duke tërhequr investime në lidhje me procese më komplekse në financë dhe kontabilitet, procese digjitale, softuerë projektimi dhe zhvillimi.

Pse investimi në BPO është një mundësi që duhet ta merrni patjetër në konsideratë? (AIDA, 2018)

- Së pari, **penetrimi në internet** është mjaft i lartë.
- 63% e popullsisë ka **akses në internetin 4G** dhe më shumë se 50% e familjeve kanë linjë fikse interneti.
- Rreth 97,8% e bizneseve kanë **lidhje interneti**.
- Rreth 40% e popullsisë dinë të paktën një **gjuhë të huaj**.
- Më shumë se 20 universitete ofrojnë **degë në ekonomi, drejtësi dhe burime njerëzore**, gjë që është mjaft e dobishme për industrinë, pasi ka aftësinë të thithë individë me formim (orientim) specifik.

Kompanitë BPO parashikojnë të rriten në vitin në vazhdim, por kryesisht (88%) në shërbimet ekzistuese dhe një pjesë e vogël parashikon diversifikim në shërbime të reja (AIDA, 2018).

Nga të dhënat shohim disa shifra interesante, të cilat mund të na pasqyrojnë më saktësisht situatën ku gjendet aktualisht sektori.

Sa i përket sektorit të shërbimeve, në përgjithësi shohim se kemi një **ritje të pagës mesatare** duke filluar nga viti 2015, me një ritje mesatare afërsisht **10%** (INSTAT, 2020). Gjithashtu, shohim se industria e shërbimeve zë një peshë mjaft të madhe në aktivitetin ekonomik të vendit tonë. **Shërbimet përbëjnë 49% të GDP-së në vitin 2019 dhe kanë një tendencë**

rritëse (*po aty*). Gjithashtu, për të treguar rëndësinë e sektorit të shërbimeve, mjafton të përmendim që më shumë se **45% e të punësuarve i përkasin sektorit të shërbimeve, ku janë të punësuar afërsisht 340 000 punonjës** (*AIDA, 2018*).

Ndërsa numri i ndërmarrjeve aktive në sektorin e shërbimeve në vitin 2019 është afërsisht **91 000** (*INSTAT, 2020*).

Sa i përket sektorit BPO, të dhënat janë edhe më inkurajuese e pozitive.

Sektori i BPO-së (shërbime të nënkontraktuara) në Shqipëri ka treguar një rritje të qëndrueshme dhe aktualisht punëson rreth **35 000 profesionistë** në më shumë se **400 firma**. Tirana është epiqendra e BPO-së në Shqipëri, pasuar nga Durrësi, Shkodra dhe Vlora. (*Dhoma e Biznesit të Diasporës*)

Fuqia e forcës punëtore cilësore është një nga kushtet kryesore për zhvillimin e BPO-së. Pjesa dërrmuese e shqiptarëve të punësuar në këtë **sektor janë nën 35 vjeç**, me aftësi të shkëlqyera gjuhësore dhe larmishmëri të formimeve akademike. (*Dhoma e Biznesit të Diasporës*)

Tregjet aktuale të klientëve janë: Mbretëria e Bashkuar, Franca, Spanja, Gjermania, Austria, Zvicra dhe Italia (*Dhoma e Biznesit të Diasporës*). Vlera totale e industrisë përlllogaritet afërsisht mes **130-160 milionë dollarë** (*po aty*).

Kompanitë me aktivitet *Data Entry* dhe *Call Center* janë mes shërbimeve kryesore të sektorit BPO në Shqipëri.

Një nga avantazhet që u cilësua më sipër, ka të bëjë dhe me faktin se pjesa më e madhe e individëve të punësuar në BPO i përket arsimit të lartë. Duke ditur që afërsisht çdo vit regjistrohen rreth 35 000 studentë, kjo është një mundësi potenciale si për sektorin, ashtu edhe për vetë studentët, pasi ata mund të shfrytëzojnë aftësitë e fituara për të qenë më të përgatitur në momentin e punësimit. (*TheCityStats, 2021*)

Nga një studim i realizuar së fundmi prej *TheCityStats*, kemi parë disa gjetje interesante të cilat mund t'i përfshijmë në analizën tonë. Si rezultat i anketimit, rreth 44% e të anketuarve, kryesisht të rinj, duan të largohen nga vendi si pasojë e situatës aktuale dhe mungesës së shpresës për të ardhmen. Shqetësimi më i madh i të rinjve për të ardhmen është padyshim punësimi dhe kjo renditet si ndër motivet kryesore që ata kanë për t'u larguar. Për këtë

arsye, BPO mund të luajë një rol thelbësor në zbutjen e kësaj situate. Duke ofruar më tepër mundësi punësimi, përmirësim të kushteve të punës dhe sigurisht një pagesë më të mirë, do të kthehej në një faktor thelbësor në ndalimin e emigrimit të të rinjve, pasi duhet theksuar se një pjesë mjaft e madhe e tyre i përkasin arsimit të lartë dhe kjo do të sillte largimin e individëve të kualifikuar. (*TheCityStats, 2021*)

Zhvillimi i turizmit

Z. Zak Topuzi / Shoqata Shqiptare e Turizmit - ATA

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

“CEOWORLD MAGAZIN” (5 tetor 2020) rendit 10 vendet me varësinë më të madhe nga sektori i mikpritjes dhe turizmit në Bashkimin Evropian dhe Ballkanin Perëndimor. Në këtë listë, Shqipëria renditet e dyta, pas Malit të Zi, me 22% të Prodhimit të Brendshëm Bruto të gjeneruar nga turizmi. Ndërkohë, në vend të pestë renditet Kroacia dhe në vend të gjashtë Greqia përkatësisht me 20% dhe 19,5% të PBB-së. Sipas artikullit, Evropa vlerësohet të ketë 50% të mbërritjeve turistike dhe në të regjistruhen 37% e faturave të shpenzimeve globale të turistëve.

Kjo është vetëm një hyrje e shkurtër, për të kuptuar rëndësinë e turizmit si sektor dhe veçanërisht në ekonominë e vendit tonë. Mirëpo, pavarësisht rolit të madh të pozicionit gjeografik apo burimeve natyrore, në 30 vjet, nuk kemi mundur të dalim përtej një **turizmi të zhvilluar në mënyrë kaotike**, me hotele të vogla, pa standarde dhe rregulla funksionimi. Vendit i mungojnë resorte dhe hotele të kapaciteteve të mëdha në kategoritë 300-600 dhoma dhe mbi 600 dhoma, të cilat mundësojnë thithjen e turistëve që kërkojnë shërbime të plota, e që bëjnë të mundur zgjatjen e sezonit dhe thithjen e valutës prej shtimit të shërbimeve. Sipas *Western Balkans 6*¹, **Shqipëria siguron mesatarisht 390 dollarë/turist, duke pasur nivelin më të ulët në rajon**, e konkurruar nga Kosova me 2,5 herë më shumë të ardhura apo Serbia me 870 dollarë/turist, duke u krahasuar vetëm me Maqedoninë e Veriut (400 dollarë/turist). Rezulton që **as turizmi i rërës dhe as i borës nuk po arrijnë të shfrytëzojnë potencialin e madh që ka vendi. Mungesa e theksuar e infrastrukturës** dhe mungesa e strukturave akomoduese, e resorteve, na bën lehtësisht të konkurrueshëm nga fqinjët.

Ndërkohë, **strategjitë që janë përgatitur në vite, kanë qenë afatshkurtra**, pa prioritetë dhe gjatë qeverisjeve kanë ndryshuar qasje. Shqipëria nuk ka pasur strategji nga viti 2013 deri në 2018-ën. Strategjia 2018-2022 mbeti vetëm draft. Ndërsa, Strategjia në zbatim, 2019-2023, nuk mundëson asnjë investitor të investojë potencialisht.

Pandemia e Covid-19 e ka dëmtuar në mënyrë të veçantë të gjithë sektorin e turizmit, sidomos agjencitë dhe akomodimin turistik në të gjitha destinacionet. Shifrat zyrtare të vitit 2020 vërtetojnë një rënie prej 58,5% të numrit të turistëve, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në fakt, rënia është 62,8%, pasi 4,3% janë udhëtarë që kanë kaluar tranzit. Norma e shfrytëzimit të shtretërve të njësisë akomoduese në tremujorin e katërt 2020, sipas INSTAT-it është vetëm 4,5%, kundrejt 15,3% që ishte në 2019-ën, pra mbi 3,6 herë më pak. Situata bëhet alarmante në tremujorin e katërt të 2020-ës dhe fillimviti i 2021-shit është i zymtë.

¹ Raporti “Prospects for Travelling and Tourism Sector in the Western Balkans in 2020 (impact of the coronavirus pandemic)” në <https://www.wb6cif.eu/wp-content/uploads/2020/11/WB6-CIF-Study-Prospects-for-Travelling-and-Tourism-Sector-in-the-Western-Balkans-in-2020.pdf>.

Turizmi ka **numrin më të lartë të ndërmarrjeve jofunksionale**, për shkak të mbylljes nga kufizimet e vendosura në kuadrin e gjendjes së jashtëzakonshme. Kthimi në normalitet parashikohet të vijë pas një periudhe të gjatë, sipas ekspertëve ndërkombëtarë, në rastin më të mirë jo më shpejt se vera e vitit 2022. Alarmin e japin statistikët: Spanja, lidhur me numrin e net-qëndrimeve të turistëve të huaj, është kthyer në vitet '90-të, Austria, në vitet '70-të. **Në lidhje me turizmin, barra ekonomike dhe administrative është e lartë** dhe përfshin kredi apo qira mujore, taksa e tatime të llojeve të ndryshme, furnitorë dhe konsulentë, mirëmbajtje të objekteve, politikat e sigurimit etj.

Për të përballuar këtë situatë, vendet e rajonit kanë vënë në dispozicion iniciativa të rëndësishme në një kohë të shkurtër. Kështu, Mali i Zi, që prej shtatorit 2020 ka ofruar Paketën e Tretë të Masave me vlerë totale 1,22 miliardë euro për 2020-2024. Qeveria e Malit të Zi do të ndajë gati 200 milionë euro për turizmin përmes masave afatshkurtra dhe afatgjata. Fondet për periudhën 2020-2022 në mbështetje të industrisë së turizmit arrijnë në 83,3 milionë euro dhe 61% e tyre i referohen vitit 2020.

Ndërkohë, industria e turizmit në Shqipëri ka marrë vetëm 4 milionë dollarë ndihmë si pagë lufte për tre muaj izolim. Kredia për pagat dhe Kredia Sovrane nuk e ndihmuan këtë industri për kushtet e veçanta që ka ky sektor. Industria është goditur nga bllokimi i lëvizjeve ndërkombëtare. Hotelet janë praktikisht të mbyllura, ndërkohë që taksa e ndërtesës paguhet. FMN-ja, në raportin e muajit janar 2021, mbi nivelin e mbështetjes fiskale të drejtpërdrejtë për pandeminë, e rendit Shqipërinë të fundit në rajon, në nivelin 1,2% të PBB-së. Maqedonia e Veriut është në nivelin 2,6% të PBB-së, Bosnje dhe Hercegovina 5,1% të PBB-ë, Kosova 5,6% të PBB-ë, Serbia 5,6% të PBB-së dhe Mali i Zi me 8%.

Situata ku ndodhemi ka forcuar bindjen se rruga për të dalë nga Pandemia Covid-19 do të jetë e gjatë dhe me të papritura. Konkluzioni i nxjerrë se pa një vaksinim global të popullsisë nuk do të ketë liri të plotë, tashmë është realitet.

2. Propozime për ndryshim

Turizmi shqiptar ka nevojë për një program rimëkëmbjeje me masa të thelluara për zhvillimin e sektorit, si dhe për daljen nga falimenti i shkaktuar nga pandemia. Duhet të adresohen urgjentisht disa çështje kritike që **Shqipëria të bëhet konkurruese në rajon**:

- Të rriten **kapacitetet akomoduese**, ndërkohë që rritet **cilësia e akomodimit**. Për këtë qëllim, nuk mund të mbetemi vetëm në strukturat akomoduese që janë më së shumti banesa private, apartamente e dhoma me kushte minimale e pa shërbime.

- Të mundësohen *investime nga “markat” e njohura hoteliere dhe të operatorëve turistikë*. Aktualisht, në Shqipëri operojnë vetëm dy marka ndërkombëtare të hotelierisë në Tiranë, ndërkohë që në të gjitha vendet e rajoni janë prezentë 10 markat më të rëndësishme globale të hotelierisë.
- Të stimulohet e mbështetet **zhvillimi i një oferte të mbështetur në produktin e plotë turistik, mbi bazën e destinacionit**. Oferta aktuale turistike është e varfër dhe mundësitë e kombinimit të llojeve të ndryshme të turizmit janë të pakta. Kjo ofertë duhet të mundësojë turizmin 4-stinor përmes turizmit të shëndetit dhe atij sportiv, kulturor, natyror, bregdetar, dimëror-malor me resortet e skive etj.
- Të investohet në **infrastrukturë turistike**, si për shembull rrugët drejt destinacioneve, pistat e skive etj. Investimet private e publike duhet të orientohen drejt zonave me përparësi zhvillimin e turizmit dhe destinacionet turistike. Ky është një objektiv i parealizuar nga të gjitha strategjitë e deritanishme.
- Të stimulohet dhe mbështetet financiarisht sektori, për shembull përmes TVSH-së së reduktuar, apo taksa të reduktuara përkundrejt shërbimeve që janë miqësore me mjedisin. Politikat stimuluese duhet t’u përshtaten karakteristikave të destinacioneve. Prej vitesh, hotelet, e tashmë dhe restorantet në vendet e BE-së, në bazë të direktivave të Komisionit Evropian kanë mundësinë të jenë subjekt i TVSH-së së reduktuar². Kjo direktivë është zbatuar pothuajse në të gjitha vendet e Evropës, me uljen më të madhe në vendet që lagen nga Mesdheu, ku turizmi ka ndikim të rëndësishëm në PPB. Në Shqipëri, qeveria uli në 6% TVSH-në për hotelet, duke ndikuar në rritjen e investimeve dhe shtimit të kapaciteteve akomoduese, por ky vendim nuk preku shërbimet e mikpritjes (bar, restorant, evente etj.), që u lanë në nivelin 20%. Po ashtu, në vitin 2018, me ndërhyrje ligjore, u stimuluan hotelet me 5 apo 4 yje që lidhen me një brand të huaj, çka dëmtoi industrinë ekzistuese që ka investuar me kredi me interesa të larta bankare gjatë 10-20 viteve të fundit.

Të gjitha këto çështje si më lart, duhet të jenë pjesë e një strategjie afatgjatë të turizmit, e hartuar dhe e dakordësuar me të gjithë aktorët e fushës së turizmit.

² Direktiva 2006/112/EC dhe 2009/47/EC mbi sistemin e përbashkët të vlerës së shtuar e taksave, si dhe ndryshimet pasuese.

Turizmi në Shqipëri


Z. Kliton Gërxhani / Shoqata Shqiptare e Turoperatorëve dhe Agjencie Turistike (ATOA)

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim


- Industria e turizmit shqiptar është goditur shumë fort nga dy forca madhore: tërmeti i nëntorit 2019 dhe pandemia e Covid-19, që nga marsi i 2020-ës dhe në vazhdim.
 - Tërmeti solli dëme materiale në zonën bregdetare të Durrësit, që është edhe një nga zonat kryesore të plazhit në vend, si dhe një dëm në imazh prej pasigurisë ndaj zonës sizmike.
 - Pandemia e Covid-19 solli mbylljen e kufijve dhe bllokimin total botëror të aktivitetit turistik.
- Rrjedhimisht, bizneset turistike u gjenden përpara dy problemeve madhore:
 - mungesës së biznesit, pra dhe të likuiditetit;
 - detyrimin për largimin e stafit të kualifikuar prej shumë vitesh.
- Gjatë verës, por edhe pak në vjeshtë, bizneset e akomodimit dhe bar-restoranteve kryen pak aktivitet me tregun vendas dhe atë kosovar, ndërkohë që bizneset e turoperatorëve dhe agjencie turistike, si *incoming* dhe *outgoing*, guidave dhe transportit turistik, nuk kryen pothuajse asnjë.
- Nga një sondazh që ATOA kreu me 43 turoperatorë dhe agjenci turistike (rreth 21% e tregut zyrtar) në tetor 2020, mbi efektet e pandemisë në bizneset e tyre, dolën këto shqetësime kryesore:
 - rreth 60% e bizneseve kanë bërë në 2020-ën vetëm 0-10% të xhiros së 2019-ës;
 - më shumë se gjysma e punonjësve janë larguar nga puna në 2020-ën, kryesisht nga bizneset e mëdha;
 - 40,5% e bizneseve mund të mbijetojnë deri në fund të 2020-ës.
- Qeveria ofroi shpërblim luftë prej vetëm 40 000 lekë, si dhe shtyrje të tatimitit të 2020-ës deri në prill të 2021-shit, masa të papërfillshme këto kundrejt goditjes së dy forcave madhore të këtyre përmasave. Fatkeqësisht, qeveria nuk arriti ta kuptonte këtë realitet dramatik të industrisë së turizmit dhe nuk ofroi bashkëpunim, edhe pse i kërkuam mbështetjen e veçantë për grupin e turoperatorëve me:

- rroga të punonjësve tanë, duke e shtrirë skemën e ripunësimit si për punonjësit e larguar, ashtu edhe për ata që mbajtëm, gjatë gjithë kohës;
- grante për këto biznese në varësi të xhiros dhe madhësisë së tyre;


Rreth sa ka qenë % e xhiros tuaj nga 1 janari 2020 deri tani, në raport me xhiron e të njëjtës periudhë në 2019?



Numri i total punëtorëve në vitin 2019 dhe 2020



Nëse nuk do të përfitonit ndihmë nga qeveria: edhe sa kohë mendoni se mund ta mbani biznesin pa falimentuar?



2. Propozime për ndryshim

Nga parashikimet, duket se edhe 2021-shi do të jetë një vit i vështirë. Skenarët më optimistë thonë që në gjysmën e dytë të vitit mund të fillojë aktiviteti dhe mund të arrihet maksimumi 50% i xhiros së 2019-ës. Ndërkohë që 2019-a parashikohet të kapet rreth 2023-'24-ës.

Kjo e bën shumë të vështirë mbijetesën e bizneseve të brishta turistike shqiptare, të dominuara kryesisht nga bizneset e vogla. Shumica e tyre është me aktivitet të pezulluar por hapja kërkon:

- likuiditet, pra mbështetje financiare me grante;
- shtyrje të çdo lloj takse të mundshme;
- një skeme rikthimi të punonjësve të kualifikuar.

Këto masa janë afatshkurtra deri në fund të 2021-shit.

Megjithatë, dy goditjet e mëdha që pësuar nga natyra, kërkojnë jo vetëm një plan për daljen nga kriza, për të kompensuar thjesht atë që humbëm, por të rindërtojmë një sektor turizmi që duhet të jetë më i fortë ndaj krizave të tilla, më konkurrues në rajon, më jetëgjatë dhe i dobishëm si për njerëzit, ashtu edhe për natyrën, por edhe më i bashkuar ndërmjet aktorëve kryesorë.

Pra, në një plan afatmesëm dhe afatgjatë, nevojitet të kemi:

- një kuadër ligjor të plotësuar për vendosje standardesh dhe në shërbim të ringritjes së një industrie cilësore dhe jo sasiore të turizmit;
- rikthimin e një Fondi Turizmi si garanci financiare për sektorin e turizmit ndaj një krize të ngjashme në të ardhmen, por edhe për krijimin e pavarësisë së këtij sektori në zhvillimin dhe marketimin e vet;
- rishikimin e Strategjisë së Turizmit dhe Marketimit, duke ftuar aktorët më kryesorë në vend, dhe të huaj, dhe investimin në modelet e DMO-ve, ku vendimmarrja për menaxhimin dhe marketimin e turizmit bëhet në bashkëpunim ndërmjet sektorit privat dhe publik.

Zhvillimi rajonal

Znj. Anila Bejko / Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Një qasje e re për zhvillimin është jetike në Shqipëri, për të zgjidhur pabarazitë historike në territor, si dhe për t'iu përgjigjur sfidave të ardhshme, edhe në kuadër të integritetit në Bashkimin Evropian.

Pabarazitë krijohen si rezultat i larmisë territoriale dhe aksesit të ndryshëm të komuniteteve në shërbime e mundësi zhvillimi. Larmia territoriale, e cila është gjeografike, mjedisore, institucionale dhe social-ekonomike përkthehet në pabarazi të theksuara ndërmjet dhe brenda rajoneve zhvillimore. Përgjigjet ndaj këtyre pabarazive nuk mund të jenë të njëjta kudo dhe duhet të përshtaten me veçoritë lokale, rajonale e kombëtare.

Shoqëria dhe territori kanë pësuar ndryshime rrënjësore në tri dekadat e fundit në Shqipëri, duke i thelluar vazhdimisht pabarazitë. Vihen re disa fenomene:

- Së pari, **migrimi i brendshëm nga zonat rurale në ato urbane** ka çuar në shpopullimin e tyre të vazhdueshëm, rrezik ende i prekshëm. [Në periudhën 2001-2011, rreth 280 863 banorë lëvizën nga fshati në qytet¹, Ndërkohë që vetëm për vitin 2018, 6377 banorë kanë lëvizur drejt Tiranë-Durrësit nga tri rajonet e tjera zhvillimore të vendit.] Kjo, shoqëruar edhe me ritme natyrore demografike në rënie [shtesa natyrore për vitin 2019 ishte vetëm 6624 persona ose -17,4%, krahasuar me një vit më parë], forcon nevojën për politika që ruajnë identitetin e territoreve edhe në zonat më të thella të vendit.
- Së dyti, është **papunësia, në veçanti te të rinjtë** [Për vitin 2018, INSTAT regjistron një shkallë papunësie prej 12,3% të të rinjve (15+)]. Nevojitet një e ardhme për të rinjtë në Shqipëri, në rajonet e tyre të lindjes, me mundësi punësimi të larmishme.
- Së treti, modeli aktual stimulon **rajone jokonkurruese** mes tyre, që nuk vendosin në përdorim vlerat dhe veçoritë lokale. Ekonomia dominohet nga shërbimet dhe bujqësia [Sipas INSTAT-it, VSHB në bujqësi kishte një peshë prej 21,1% dhe shërbimet 21,9% nga totali] dhe është e fokusuar kryesisht në një rajon.

Institucionalisht, deri më sot, organe të ndryshme të administratës shtetërore kanë **kompetenca të mbivendosura në lidhje me alokimin e fondeve të investimeve** që adresojnë zhvillimin rajonal. Kjo lidhet kryesisht me Komitetin e Zhvillimit Rajonal të Fondit Shqiptar të Zhvillimit e disa ministri të linjës që ekzekutojnë drejtpërdrejt burimet e financimit në të njëjtat përparësi.

¹ Nga kjo, rreth 112 000 u vendosën në Qarkun e Tiranës.

Ministritë e posaçme të linjës adresojnë problemet e zhvillimit përmes një qasjeje plotësisht sektoriale, **dimensioni territorial**, i reflektuar në pabarazi midis qytetarëve dhe në efektet negative mbi burimet natyrore e njerëzore, **mungon në investimet sektoriale**. Për pasojë, ulët koordinimi dhe efikasiteti në përdorimin e fondeve kombëtare.

Qeveritë vendore kanë qasje territoriale, por nuk mund të adresojnë pabarazitë hapësinore/territoriale mes tyre, sepse **përqendrohen brenda territoreve përkatëse**.

Ndërkohë, zhvillimi rajonal, me politikën dhe fondin përkatës, ka qasje territoriale. Si i tillë, siguron që sektorët (ministritë e linjës) të mos veprojnë të izoluar në territor, por të bashkërendojnë dhe **sinkronizon nivelet vendimmarrëse, juridiksionet dhe aktorët** në procesin e **shpërndarjes së investimeve të qeverisë qendrore** në zona të ndryshme, **në përputhje me nevojat specifike** për zhvillim dhe kohezion.

2. Propozime për ndryshim

Shqipërisë i duhet zhvillim ekonomik dhe shoqëror harmonik, i ekuilibruar dhe i qëndrueshëm, që arrihet përmes politikës së zhvillimit rajonal. Kjo është **shpërndarje e veprimtarisë ekonomike, infrastrukturës dhe subvencioneve**, që ofron perspektivë për të gjitha komunitetet dhe territoret, e garanton cilësi të jetës dhe kapitalit njerëzor, **duke nxitur e mundësuar këdo** të përmbushë potencialin e vetë në cilëndo pjesë të vendit që dëshiron.

Për këtë, **burimet financiare duhet të përputhen me angazhim politik** dhe me ngritje të vazhdueshme të **kapaciteteve për çdo nivel qeverisës**, që do të marrë rol gjatë zbatimit.


Për eficiencë në investime, politika duhet të zbatohet përmes **strategjive kombëtare e rajonale**, që ndërtojnë mbi potenciale zhvillimi dhe rritin mundësinë për thithjen e fondeve. Konkretisht nevojitet:

- **ndërhyrje të forta publike**, që fuqizojnë rajonet zhvillimore mbi bazë **avantazhesh konkurruese** dhe potencialesh zhvillimi;
- kalim nga modeli i granteve afatshkurtra të shpërndara me orientim qendror drejt modelit të **investimeve afatgjata dhe të decentralizuara** që promovojnë të gjitha rajonet;
- **investim mbi bazën e partneriteteve të zhvillimit** ndërmjet njësive të vetëqeverisjes lokale dhe aktorëve social-ekonomikë me nevoja reciproke e të ndërruarura;

- prioritarizim i burimeve financiare publike, përmes **parimit të balancimit mes rajoneve** sipas zhvillimit aktual.

Përfshirja e aktorëve si akademja, komuniteti kërkimor, sektori privat, shoqëria civile etj., në partneritet zhvillimor mundëson **alokim fondesh të drejtë, me vendimmarrje nga poshtë-lart dhe territorial**. Kjo realizohet mbi bazë të **kornizës ligjore** - aktualisht në proces, dhe **kornizës së programimit** për shpërndarjen e investimeve në territor.

Në përfundim, në kushtet e hapjes së negociatave për anëtarësi në BE, **Shqipëria duhet të jetë gati për të hyrë, menaxhuar, thithur fondet në dispozicion** (aktualisht IPA e në vijim ato strukturore) dhe **bashkëfinancuar**, me kapacitet adekuat administrativ, bashkëpunim dhe partneritet, sipas politikës së kohezionit dhe **kapitullit 22 të *Acquis Communautaire***.



Qeverisja dhe demokratizimi

Funksionaliteti kushtetues, legjitimiteti, përfaqësimi dhe administrata publike

Z. Afrim Krasniqi / Instituti i Studimeve Politike

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Funksionaliteti kushtetues

Kushtetuta e RSH-së dhe sistemi qeverisës në Shqipëri kanë disa problematika për të cilat do të duhet të ketë rishikim. Disa prej elementeve të përmendura në vijim janë potencial për kriza të reja politike dhe konflikte institucionale, disa janë sugjerime në përputhje me standarde ndërkombëtare.

Periodha midis zgjedhjeve dhe krijimit të qeverisë **është shumë e gjatë (Maj-Shtator)**. Duhet të rishikohen disa çështje, si mundësia e zgjedhjes direkt të Presidentit; të **rishikohen/kufizohen mandatet kushtetuese**; të rishikohen **kriteret kushtetuese** për zgjedhjen në organet e reja të drejtësisë etj. Nga ana tjetër, **institucioni i qarkut ka ngelur fiktiv** dhe duhet të merren masa për heqjen e tij. Ndërkohë, ka paqartësi në përcaktimin e koalicionit dhe partive fituese, të cilat duhen saktësuar. Sigurisht, përveç këtyre, ka dhe shumë **ndryshime kushtetuese** që kërkohen si kusht për anëtarësim në BE.

Kushtetuta dhe ligjet organike **duhet të zgjerojnë konceptin konkurrues**: Aktualisht nga 15 institucione thelbësore në hierarkinë shtetërore, vetëm ILDKPKI kërkon dy kandidatë në garë, 14 janë "gara" formale me vetëm 1 kandidat dhe me 50 + 1% vota.

Legjitimiteti dhe përfaqësimi

Ka nevojë për reformim të thellë **të legjislacionit mbi partitë politike**, mbi financimin elektoral, mbi demokracinë direkte, mbi raportin mes partive e shtetit, mbi vetëingun në politikë, dhe mbi integrimin e diasporës në vendimmarrje. **Legjislacioni aktual ose mungon (referendumet), ose është jofunksional** dhe burim destabiliteti (financimi, partitë, dekriminalizimi, krimi elektoral), ose është burim delegjitimiteti (sistemi eksperimental zgjedhor, përjashtimi i diasporës, joproporcionaliteti në mandate, pjesëmarrja në votime etj.).

Administrata publike

22 vite pas miratimit të ligjit mbi nëpunësit civilë, administrata civile dhe publike vijon të **shfaqë paqëndrueshmëri, brishtësi në aspektin e integritetit, dobësi profesionale dhe shqetësim për nivelin e korrupsionit**, si dhe të ndihet e cenuar nga presionet dhe ndikimet politike. Raporti shtet-pushtet politik nuk është rregulluar në standardin që duhej të kishte një vend aspirant për anëtarësim në BE dhe **vijojnë eksperimentet në strukturën administrative të shtetit**.

Legjislacioni nuk është qartësisht garant i pavarësisë politike dhe parcelizimi i pushtetit është shoqëruar me sistem klientelist të ndarjes së posteve. **Proceset gjyqësore të shkarkimeve të paligjshme kanë kosto të lartë financiare.** Ndryshimet e vazhdueshme në administratë dobësojnë cilësinë e saj, ndërkohë që angazhimi direkt ose indirekt politik edhe ligjërisht e ka bërë **administratën civile e publike më politike sesa nevojat e vendit.** Pjesëmarrja e administratës civile dhe publike si të deleguar politikë në procese zgjedhore vjen në kontrast me statusin ligjor të tyre.

2. Propozime strategjike për ndryshim

- **Kushtetuta:** Ndryshime kushtetuese konsensuale dhe afatgjata, si reflektim i problematikave në sistemin qeverisës; reformim i hierarkisë kushtetuese, ndryshime mbështetëse përmirësuese për Shqipërinë në BE.
- **Partitë:** Jetësimi i plotë i nenit 9 të Kushtetutës së RSH-së (partitë, legjitimiteti, transparenca, llogaridhënia, strukturimi, demokracia e brendshme).
- **Reforma strukturore:** Disa akte politike që mund të ndikojnë në forcimin e legjitimitetit të institucioneve dhe stabilitetit afatgjatë të tyre janë: zgjedhja direkt e presidentit; ulja e numrit të deputetëve; zgjedhja e drejtuesve të institucioneve mbi shumicë të cilësuar dhe mbi bazën e meritës/konkurritimit dhe jo delegimit politik; forcimi i mekanizmave llogaridhënës.
- **Vetingu në politikë:** Në procesin antikorruption është nevojë dhe i pashmangshëm për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të ndjekur vetingun në drejtësi dhe formalizimin e ekonomisë.
- **Reforma në përfaqësim:** Depolitizimi i administrimit zgjedhor; kalimi në 100% listë të hapur kandidimi në zgjedhje; dekriminalizimi i partive dhe proceseve zgjedhore; rishikimi i mundësisë për votë të detyrueshme në zgjedhje. Këto propozime ndikojnë në rritjen e besueshmërisë të procesi zgjedhor dhe produkti i tyre institucional.
- **Administrata civile:** Forcimi i legjislacionit që garanton pavarësi dhe meritokraci, transparenca dhe konkurrencë; **dyfishimi i numrit të zyrtarëve me status të nëpunësit civil** në tërësi; përgjegjësi administrative dhe financiare për zyrtarët përgjegjës që me shkarkime i shkaktojnë dëme financiare shtetit; rivlerësim

i sistemit të pagës; zgjerim i kategorive të zyrtarëve në ente publike që duhen zgjedhur përmes një **gare meritokracie**, jo përmes sistemit aktual të emërimit.

Shoqëria civile

Znj. Juliana Hoxha / Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim / Burimi Kombëtar për Shoqërinë civile në Shqipëri

1. Nevoja dhe propozime për ndryshim

Është e rëndësishme, që në krye të radhës, të përcaktohet koncepti i shoqërisë civile si një hapësirë e aksionit kolektiv, që bazohet në interesa, qëllime dhe vlera të përbashkëta, dhe që ndodh i pavarur nga shteti dhe sektori i biznesit, ku organizatat e shoqërisë civile janë vetëm një prej aktorëve. Në këtë parashtrim, fokusi kryesor ka të bëjë me këtë pjesë të shoqërisë civile që ligjërisht njihen si organizata jofitimprurëse (OJF) dhe rolit të drejtpërdrejtë që ato luajnë në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesit të grupeve që përfaqësojnë, nxitjes së pjesëmarrjes dhe influencimit të politikave, rritjes së llogaridhënies nga ana e institucioneve, ofrimit të shërbimeve direkte, sidomos për ato grupe shoqërore që janë jashtë fokusit dhe interesit të sektorit komercial.

Organizatat jofitimprurëse, pikërisht për hatër të këtij fokusi dhe rolit që luajnë, ndikohen drejtpërdrejtë nga mjedisi ligjor e praktik ku operojnë, përfshirë këtu edhe nivelin e decentralizimit të institucioneve dhe besimin publik në to.

Në këtë kuadër, më poshtë janë disa nga **çështjet më të mprehta** me të cilat OJF-të ballafaqohen, adresimi i të cilave do të fuqizonte rolin dhe impaktin e tyre në zhvillimin demokratik, shoqëror dhe ekonomik të vendit.

1. Ekzistenca e një **klime mosbesimi** reciprok midis OJF-ve dhe institucioneve shtetërore në tërësi, rrjedhë e mungesës së gjatë të dialogut të hapur dhe të një marrëdhënie që ndër vite ka shkuar nga konfliktuale në injoruese. Matja e perceptimit publik në vitin 2019, lidhur me besimin në institucione, tregoi rritje për sa i përket besimit në organizatat e shoqërisë civile (56,3%), me një diferencë të konsiderueshme përkundrejt besimit në qeverisjen vendore (42%), qeverinë qendrore (41,3%) apo parlamentin (28,4%).¹

Kuadri ligjor ka shënuar avancim të dukshëm për sa u përket të drejtës dhe hapësirës më të madhe për OJF-të dhe publikun në përgjithësi për të qenë pjesë e **proceseve konsultuese**. Megjithatë, kjo nuk është përkthyer ende gjerësisht në një proces konsultimi domethënës, që plotëson kriteret e përfshirjes duke filluar nga momenti i marrjes në konsideratë të nevojës për iniciativë të reja ligjore, në njoftimin në kohë të konsultimeve, sigurimin e mundësive alternative të pjesëmarrjes për një përfshirje sa më të gjerë, e deri në llogaridhënien nga ana e institucioneve për atë çfarë është marrë në konsideratë dhe nëse jo, arsyet përse.

Konstatohet **mosnjohje dhe mungesë kapacitetesh** si nga ana e OJF-ve, ashtu edhe nga ana e administratës publike në të gjitha nivelet, për të vënë në zbatim efektiv

¹ Opinion Poll, 2019, IDM, f. 30

këtë kuadër ligjor. Kuptimi i drejtë mbi vlerën e kontributit të OJF-ve dhe mënyrave të përfshirjes së tyre në dialogun mbi politikat dhe zbatimin e tyre, do të siguronte politika e ligje më të mira dhe zbatim efektiv të tyre. Qëndrimet kritike të OJF-ve jo rrallë herë etiketohen si politike, qëllimisht dashakeqëse, apo injorohen, duke cenuar legjitimitetin e shqetësimeve apo propozimeve të grupeve të interesit.

Një investim afatgjatë në këtë drejtim do të ishte përfshirja e këtyre **çështjeve si pjesë e paketës trajnuese** për nëpunësit civilë nga ana e **ASPA-s**.

2. Sa i përket dialogut të strukturuar midis OJF-ve dhe institucioneve, ekzistojnë disa mekanizma siç janë Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile, Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian, përkrah Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, dhe Udhërrëfyesi për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile. Por, që nga ngritja dhe aprovimi i tyre, **këta mekanizma nuk kanë arritur të kenë asnjë lloj produkti apo kontribut konkret në avancimin e dialogut**, në funksion të qëllimit për të cilin janë ngritur.

Ka nevojë të menjëhershme për të rikonsideruar rolin e sektorit të OJF-ve në këto struktura, duke i dhënë hapësirë reale OJF-ve në pjesëmarrje, që nga momenti i vendosjes së prioriteteve, hartimit të rendit të ditës e deri në respektimin e detyrimit ligjor për takime të rregullta. Duke qenë struktura me përfaqësim të përzier, si nga sektori i OJF-ve dhe nga ekzekutivi apo legjislativi dhe që drejtohen nga këto të fundit, mungesa e vullnetit politik ka qenë faktori kyç pengues në mbarëvajtjen e tyre.

3. **Trajtimi fiskal** i sektorit të OJF-ve si një sektor me qëllim jofitimprurës, ka qenë dhe mbetet thellësisht i njëjtë me atë të sektorit privat, fitimprurës. Madje, në disa aspekte, ai është edhe më **penalizues me moskualifikimin e sektorit për rimbursimin e TVSH-së**. Mosrimbursimi i TVSH-së nga asnjë qeveri në vend të financimeve të ndihmës së huaj, përbën jo vetëm një **shkelje të detyrimit që shteti ka si pjesë e marrëveshjeve bilaterale**, por edhe një **barrë të shtuar financiare për sektorin**. Kjo e vë sektorin në Shqipëri në **pozita diskriminuese** krahasuar me atë në Evropë dhe në Ballkan, duke cenuar **bashkëpunimit rajonal**.

Barra tatimore që sektori mbart për sa u përket taksave dhe tarifave vendore e atyre kombëtare është **baras me atë të biznesit të madh**. Kjo ka ndikuar **negativisht mundësinë zbatuese dhe qëndrueshmërinë** e aktivitetit të sektorit.

Pas udhëzimit të dhjetorit 2014 të ministrit të Financave dhe Ekonomisë për rimbursimin e TVSH-së për fondet e BE-së, i cili nuk u zbatua kurrë dhe nuk rezultoi në asnjë rimbursim, në vitin 2019 doli udhëzimi i ri, i cili kualifikon për rimbursim të gjitha financimet e ndihmës së huaj, pjesë e marrëveshjeve bilaterale dhe shumëpalëshe të ratifikuara nga Parlamenti shqiptar, ose marrëveshjeve për fonde të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Pavarësisht përmirësimit të trajtimit duke rritur numrin e financimeve të huaja që mund të marrin rimbursim apo qartësisë në procedurë, **ende nuk është kryer asnjë rimbursim.**

4. Shteti **nuk ka arritur të ofrojë mbështetjen e nevojshme financiare** për sektorin për një seri funksionesh dhe shërbimesh që ky ofron. I vetmi mekanizëm që shteti ka për mbështetjen e sektorit është Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, buxheti i të cilës shkon rreth 800 mijë euro në vit, fond ky tepër i vogël, duke pasur parasysh shërbimet e shumta që sektori ofron dhe që janë të rëndësishme në sigurimin e standardeve demokratike në vend.

Sot, OJF-të luajnë një rol të pazëvendësueshëm në ofrimin e shërbimeve për individët, familjet dhe grupet në nevojë e rrezik apo të marginalizuara, që nga kujdesi psiko-social, shërbimet e rehabilitimit, ndihma ligjore falas, integrimi në punë etj. Një shembull ilustrues për këtë është fakti që në shërbimet e kujdesit shoqëror në nivel të pushtetit vendor, OJF-të përbëjnë gati dyfishin e numrit të ofruesve të shërbimeve, krahasuar me ofruesit publikë.

Një ndër **skemat mbështetëse të shtetit** në këtë drejtim është Fondi Social, i cili u shpall për herë të parë në vitin 2019. Kjo mundësi **ka nevojë të zhvillohet e të fuqizohet më tej për të siguruar mbështetje më të madhe dhe të vazhdueshme,** me terma të qartë dhe transparentë konkurrimi.

5. **Ligji i ri i prokurimit publik,** aprovuar në vitin 2020, konsiderohet një zhvillim pozitiv që krijon mundësi më të mëdha për OJF-të në fushën e shërbimeve dhe pritjet të sigurojë një trajtim më të drejtë në tenderimet publike për disa kategori shërbimesh. Por, mbetet **urgjente nevoja e plotësimit të akteve nënligjore** që do ta bënin efektive këtë mundësi, duke marrë në konsideratë së pari impaktin dhe standardin e shërbimit, përkundrejt çmimit të ofertimit (prokurimi social).
6. Prej më se një dekade, sipërmarrja sociale² konsiderohet dhe trajtohet në BE si kontributore në krijimin e vendeve të punës, inovacionit dhe zhvillimit ekonomik të drejtë dhe të ndershëm. Sot, në BE ekzistojnë më shumë se 2 milionë sipërmarrje sociale (SS),

² Sipërmarrja sociale nënkupton një operator në ekonominë sociale, qëllimi kryesor i së cilës është të ketë impakt social përkundrejt sigurimit të fitimit për zotëruesit apo kontributorët e saj.

që përbëjnë 10% të gjithë bizneseve në Bashkimin Evropian, me rreth 13,6 milionë të punësuar.

Me shpalljen e planit të masave për **një mjedis mundësues për sipërmarrjen sociale**³ nga Komisioni Evropian në 2011-ën, edhe Shqipëria u përfshi nga disa zhvillime të rëndësishme si në drejtim të kuadrit ligjor, ashtu edhe të zgjerimit të numrit dhe diversitetit në shërbime nga SS. Në Shqipëri, sektorët ku SS operon, janë kryesisht shërbimet sociale, edukative dhe shëndetësore, bujqësi, turizëm, prodhime artizanale, trajnim profesional.

Kuadri ligjor që rregullon SS në vend, vlerësohet në mënyrë kritike për qartësisë në përcaktimin ligjor të këtyre subjekteve dhe funksioneve që ato luajnë si për sa i përket integritetit në punë, ashtu edhe ofrimit të shërbimeve. Vlerësohet se **ka nevojë urgjente për ndryshime të mëtijshme në kuadrin rregullator**, të cilat do të **zgjerin gamën e subjekteve** që kualifikohen për marrjen e statusit të sipërmarrjes sociale, që sipas modelit evropian përfshin kompanitë, kooperativat, shoqatat e kursim-kredisë përkrah OJF-ve, siç është momentalisht në Shqipëri.

Gjithashtu, ka nevojë për **qartësi në kriteret e dhënies së statusit të SS si dhe procedura të sakta dhe transparente për financimet shtetërore në këtë drejtim**. Vendimi Nr. 789/2018, "Për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale", nuk ka arritur të mbështesë asnjë SS deri më sot, ndërkohë që **i ka dhënë statusin vetëm 6 sipërmarrjeve në vend**.

Në të njëjtën kohë, sipas praktikës evropiane, dhënia e më shumë lirive SS në ripërdorimin dhe investimin e të ardhurave të veta, do të sillte një zhvillim të qëndrueshëm të tyre dhe zgjerim të aktivitetit të vet. Kjo do të siguronte përfitim të drejtpërdrejtë për grupet e marginalizuara, për të cilat shteti ka detyrim, por s'ka kapacitet për t'i arritur.

7. Pilotimi për herë të parë në nivel ballkanik nga ana e OJF-ve shqiptare i **përdorimit të pronave të konfiskuara nga aktiviteti kriminal dhe kthimi i tyre në sipërmarrje sociale**, është një risi që duhet të marrë vëmendje dhe mbështetje më të madhe nga ana e shtetit.

Aktiviteti ekonomik dhe social që SS kryejnë në këto prona, me qëllim punësimin dhe ofrimin e shërbimeve për grupe të marginalizuara apo në risk, mbart përfitime të shumëfishta

³ Social Business Initiative, Komisioni Evropian, 2011

shumëfishta si për sa i përket aspektit të fuqizimit ekonomik dhe social, ashtu edhe atij të shtetit të së drejtës.

Për këtë arsye, do të shihej me vlerë dhënia përparësi nga ana e shtetit për t'ua vënë në dispozicion këto prona sipërmarrjeve **sociale**, përkundrajt shitjes që nuk ka rezultuar e efektshme dhe që mbart riskun e kthimit në mënyrë të tërthortë ish-pronarëve.

8. **Dhurimi filantropik**, që në një pjesë të madhe shkon në mbështetje të drejtpërdrejtë të kauzave dhe shërbimeve që OJF-të ofrojnë, **nuk është ende i njohur si një aktivitet i veçantë** që mbart vlera të mëdha qytetare dhe zhvillimore në të njëjtën kohë. Kuptimi dhe trajtimi i dhurimit filantropik si aktivitet sponsorizimi, komprometon qëllimin dhe vlerën e tij dhe e kufizon atë vetëm në një aktivitet që kryhet nga sektori privat për arsye komerciale, dhe përjashton dhurimin individual nga qytetari i thjeshtë.

Adresimi i duhur ligjor që do të përfshinte **rregullimin, raportimin, matjen në vlerë dhe stimulimin e tij, do të sillte efekte pozitive të shumëfishta**. Ai do të rriste angazhimin qytetar, llogaridhënien dhe lidhjen më të fortë të OJF-ve me publikun, si dhe do të **stimulonte një sektor privat me përgjegjshmëri të lartë sociale**, duke çliruar burime njerëzore dhe financiare për kauza të rëndësishme sociale dhe ekonomike.

9. Duke vlerësuar rolin që OJF-të kanë në mobilizimin dhe orientimin e vullnetarizmit në funksion të së mirës shoqërore, **pritej që pas katër** vitesh pas miratimit të Ligjit 45/2016, "Për Vullnetarizmin", **klima e vullnetarizmit në vend të ishte më shumë mundësuese**.

Por sot, njohja, kuptimi dhe zbatimi i ligjit, si nga ana e organizatave të shoqërisë civile, ashtu dhe e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tij, **mbetet ende problematike**. Me gjithë qëllimin e mirë për njohjen si aktivitet dhe rregullimin e tij, **kuadri ligjor për vullnetarizmin nuk është i plotë dhe mundësues** për OJF-të që punojnë me vullnetarë dhe programe vullnetarizmi.

Ligji aktual ka nevojë të qartësojë konceptin e vullnetarizmit, duke e dalluar atë qartazi nga punësimi apo ofrimi i shërbimeve. Njëkohësisht, ligji duhet **të krijojë mundësinë e angazhimit vullnetar të pakushtëzuar me nevojën e regjistrimit, duke e lehtësuar atë nga një seri procedurash burokratike dhe fiskale**.

Në vlerësim të potencialit zhvillues dhe edukues që ky aktivitet mbart, është tepër e rëndësishme **përkrahja dhe stimulimi nga ana e shtetit, qoftë në përfshirjen e praktikave shkollore, ashtu edhe të skemave financiare mbështetëse**.

Decentralizimi dhe qeverisja vendore

Znj. Adelina Farrici / Shoqata për Autonomi Vendore

1. Nevoja dhe propozime për ndryshim

Fjalë kyçe: Autonomi fiskale, autonomi financiare, demokraci lokale, shërbime të standardizuara, cilësi jetese, qeverisje lokale, decentralizimi.

Demokracia në nivel lokal ka rëndësi parësore. Liria më e madhe është një nevojë që ndihet jo vetëm nga cilido individ, por edhe nga gjithë shoqëria e marrë si një e tërë. Vetëqeverisja lokale duhet të përmbushë nevojat e të gjithë komunitetit në qytete dhe fshatra, zona qendrore dhe periferike. Ndonëse Shqipëria ka ndërmarrë hapa madhorë në funksion të autonomisë vendore, siç spikat reforma administrativo-territoriale, vlerësohet se ka ende shumë punë për të bërë në këtë drejtim. **Pushteti vendor ka ende shumë sfida përpara në drejtim të demokracisë lokale dhe autonomisë vendore.**

Autonomia vendore, cilësia e shërbimeve si dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së komuniteteve vendore është e lidhur drejtpërdrejt **me financat lokale**. Një burim i të ardhurave vendore janë taksat e ndara, ku pushteti lokal merr një pjesë të taksës kombëtare. Taksat e ndara kanë prodhuar diskutime të vazhdueshme **mbi mënyrën e ndarjes si dhe mbi masën e përqindjes që i kalon pushtetit lokal**. Në këtë aspekt, Shoqata për Autonomi Vendore, prej disa vitesh punon fortë që të drejtat e bashkive dhe komunitetit lokal të jenë më të mëdha e të përfaqësuara në funksion të autonomisë vendore, si një parakusht për proceset demokratike të shtetit të së drejtës. Problematikat e mëposhtme janë një ekstrakt i përmbledhur nga konsultime dhe dëgjesa të kryera nga SHAV me bashkitë dhe komunitetin.

Së pari, një problematikë e hasur është e lidhur me metodologjinë e ndarjes së përfitimit lokal nga kalimi i TAP-it në disa njësi vendore. Konstatohet se kjo metodologji ndarjeje e mbështetur në Ligjin 68, datë 27.04.2017, neni 25, pika 2, germa ç, e cila thotë se “20% e TAP-it i kalon qeverisjes lokale” **nuk është konform ligjit** dhe se ndarja mbështetet mbi numrin e popullsisë së çdo bashkie, duke cenuar shpërndarjen e drejtë.

Së dyti, është çështja e Emergjencave Civile, sipas Ligjit 45/2019, ku problematika që vihet re është pamjaftueshmëria financiare dhe administrative e bashkive për përballimin e EC. **Në ligj përcaktohet** që bashkitë duhet të dedikojnë një buxhet minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre për EC, që sigurohet nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Për **vitin 2020 nuk është krijuar ende një zë i veçantë për këtë fond** dhe për vitin 2021 është parashikuar një fond prej 500 milionë ALL për të gjitha bashkitë, i cili është larg vlerës 4% në nivel vendor.

Së treti, pabarazia e shpërndarjes së rentës minerare. Sot, kemi rreth **15 bashki të pasura me burime natyrore**, por fatkeqësisht rezulton se këto janë bashkitë **më të varfra ekonomikisht** dhe me probleme të mprehta sociale. Kjo padrejtësi duhet të zgjidhet menjëherë.

2. Propozime për ndryshim

SHVSH-ja vlerëson **bashkëpunimin me partnerët dhe aktorët kryesorë të pushtetit lokal**, për të vijuar zhvillimin në kuadër të reformës administrative-territoriale, duke bërë që autonomia vendore dhe ajo fiskale, administrimi lokal dhe vetëmenaxhimi i aseteve dhe politikat vendore të jetë në linjë me demokracinë lokale të adaptuar sot brenda hapësirave të Bashkimit Evropian. Në këto kushte, rekomandohen propozimet e mëposhtme:

- **Në lidhje me TAP-in:**

Të përcaktohet një metodologji **që e bazon shpërndarjen nga tatimi i të ardhurave personale** sipas juridiksionit të punonjësve ku mblidhet tatimi.

- **Në lidhje me Emergjencat civile:**

Kalimi i fondit 4% të buxhetit të çdo bashkie dhe mbartja e këtij fondi në vitin pasardhës.

- **Në lidhje me rentën minerare:**

Rritja e përqindjes së rentës nga 5% në 25-30%.

SHAV mbetet optimiste se përvoja e saj në drejtim të njohjes së pushtetit lokal dhe bashkëpunimi me pushtetin qendror janë një aset për arritjen e objektivave strategjike për zhvillimin lokal. **Përfshirja e qytetarëve** në vendimmarrjen lokale dhe **unifikimi i zërit dhe qëndrimin të të gjithë aktorëve të rëndësishëm** vendor jo vetëm do të ketë efikasitet, por do ta bëjë të gjithë procesin të jetë më transparent dhe llogaridhënës, si një nevojë e patjetërsueshme në funksion të demokratizimit e politikëbërjes në favor të interesit lokal dhe kombëtar.

Decentralizimin “e fjetur apo të munguar” ta bëjmë funksional

Z. Agron Haxhimali / Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

1. Nevoja dhe propozime për ndryshim

Qytetarët, edhe sot, pas 5 vitesh reformë territoriale, nuk po ndiejnë efektet e pritura. Raportet dhe informacionet dëshmojnë se shërbimet nuk janë përmirësuar si dhe sa duhet, qeverisja është larguar nga qytetari dhe llogaridhënia, pjesëmarrja qytetare nuk është e mjaftueshme.

“Reforma” aktuale e decentralizimit është përgjithësisht e kufizuar, me kompetenca të transferuara në pushtetin vendor, pa i shoqëruar si duhet ato me mjete financiare dhe me kuadrin e nevojshëm ligjor, rregullator, funksional dhe organizativ.

A e kemi sot decentralizimin funksional? Pyetja nuk shtrohet nëse decentralizimi është i mirë apo i keq në vetvete, por nëse rezultatet e decentralizimit, që presim të gjithë ne, janë aty ku duhet.

Jofunksionaliteti i decentralizimit lidhet me historinë e krizave të demokracisë sonë dhe konflikteve politike, por është e rëndësishme të gjejmë mënyra për ta bërë decentralizimin më efektiv.

Dy teza ngrihen për diskutim për publikun dhe aktorët politikë, (por jo vetëm):

*Teza 1. **Bashki të mëdha me njësi administrative të pafuqishme***

Bashkitë duhet të decentralizojnë veten dhe të bëjnë funksional decentralizimin aktual. Një sërë shërbimesh publike nuk marrin vëmendjen e duhur nga qeveria, por edhe nga vetë bashkitë. Për shembull, menaxhimi i mbetjeve në zona rurale – sipas INSTAT-it, për vitin 2019, zona e mbulimit me shërbim është zvogëluar. Po ashtu, sistemi i vaditjes rezulton me problem. Shërbimet bazike të natyrës rurale, si rrugë fshati, kanalizime, shembje e bllokim rrugësh etj., nuk kryhen edhe për arsye se vetë njësitë administrative nuk kanë asnjë kompetencë për të ndërhyrë. Duhet të ndërhyjë bashkia-qendër. Pra, në mënyrë të pakuptimtë, njësitë administrative duhet të telefonojnë bashkinë për të dërguar një ekskavator për të hapur rrugën apo një motosharrë për të prerë pemët e rëna në një rrugë të bllokuar.

*Teza 2. **Decentralizim real apo sektorial***

Transfertat e pakushtëzuara sektoriale, si (1) mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi, (2) administrimi i pyjeve, (3) ujitja dhe kullimi, (4) arsimi parashkollor, janë funksione të decentralizuara që në vitin 2016, por vazhdojnë të mbështeten çdo vit me fonde buxhetore. Edhe pse ka pasur

një tendencë pozitive në këtë drejtim, sërish problemi mbetet ai që ishte edhe para reformës, kur këta sektorë ishin nën kontrollin e qeverisë. Çka vëmë re sot, është se edhe në këta sektorë, shërbimi publik ka probleme në administrim, në kuadrin ligjor e financiar, si dhe në atë organizativ.

2. Propozime për ndryshim

Lidhur me tezën e parë: Shumë mirë që kemi bashki të “mëdha” dhe të “fuqishme”. Por, duhet bërë kujdes dhe duhet minimizuar rreziku i humbjes së kontrollit mbi territorin dhe shpërndarjen e balancuar të shërbimeve urbane, ndërrurbane dhe rurale. Ndaj, rekomandoj fort një decentralizim të vetë bashkisë, që do të thotë një riorganizim të shërbimeve, por edhe të njësive administrative, pa ndryshim kufijsh.

Disa njësi administrative në bashki mund të grupohen sipas specifikave, natyrës së problematikave dhe shërbimeve. Pra, bashkia duhet të organizojë shërbime të natyrës rurale brenda organizimit të vet. Me këtë mënyrë organizimi të brendshëm, **rritet fuqia e njësive administrative për të kryer shërbime bazike** të jetës së përditshme të komunitetit; dhe kjo është në harmoni me parimin e subsidiaritetit.

Për më tepër, vetë bashkia-qendër me këtë decentralizim të thelluar, të brendshëm, delegon pushtet dhe rrit shërbimet pranë qytetarëve gjeografikisht larg, ndërkohë që përqendrohet më shumë në politika dhe veprime më strategjike për ekonomi dhe **zhvillim urban të qëndrueshëm e të integruar me zhvillimin rural**. Sigurisht, është një sfidë, por kjo na siguron decentralizim të menjëhershëm. Nevojiten disa ndryshime ligjore, por përcaktues është vetë vullneti i kryetarit dhe Këshillit Bashkiak.

Lidhur me tezën e dytë: Sa u përket shërbimeve sektoriale, edhe me progresin e bërë, pas 4 vitesh duhet:

- a) ose të bëhen pjesë integrale e kompetencave bashkiake, dhe buxheti për këto të mos jepet i ndarë, por në bllok, dhe vetë bashkia të bëjë ndarje sipas nevojave;
- b) ose të shkojmë drejt qasjes tjetër, ku, si në vendet e zhvilluara, për të siguruar shërbime me efektivitet, efikasitet dhe ekonomi shkalle, të kalohet drejt **shërbimeve të rajonalizuara dhe decentralizimit asimetrik**. Kjo qasje i përket decentralizimit indirekt. A përbën kjo një “valë” të re të decentralizimit real për pushtetin vendor në Shqipëri? Po, dhe duhet të ndodhë.

Në strategjinë e decentralizimit vendor, në planin për vitet 2020–'22 është parashikuar decentralizmi sektorial, si për shembull në sektorin e ujit dhe kanalizimeve etj. Ky reformim kërkon ndërhyrje ligjore të forta. Kërkon analizë të gjerë faktorësh institucionalë, financiarë, dhe administrativë. Por, për cilësi dhe sasi shërbimesh ndaj qytetarëve, çdo qasje duhet rikonsidreruar dhe vlerësuar.

Me rëndësi tani para zgjedhjeve është **qasja politike e maxhorancës dhe opozitës lidhur me reformimin territorial dhe administrativ**. Forcat politike duhet t'u prezantojnë qytetarëve agjendën e tyre për zhvillimin e pushtetit vendor. Ato duhet t'u thonë qytetarëve se si e shikojnë.

Në mbyllje, është me shumë rëndësi, **madje urgjente për demokracinë, që politika t'i hapë rrugë referendumeve**.

Në çdo rast, decentralizimin nuk duhet ta lemë në gjumë, duhet ta bëjmë funksional!

Prokurimet publike dhe kontraktimet, rekomandime për reformë në prokurime publike

Aranita Brahaj / Organizata AIS / OpenDataAlbania

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Rreth 30% e tenderimeve në sektorë si shëndetësi, infrastrukturë kombëtare dhe njësi të qeverisjes vendore, 3 deri në 5 vitet e fundit, rezultojnë me risk të lartë për parregullsi në procedurë. Mungesa e garës, mungesa e konkurrencës, skualifikimi i operatorëve ekonomikë me oferta të leverdishme e në fund anulimet e shpeshta të procedurave, janë shenja që shfaqin hapësira të mëdha për klientelizëm dhe abuzim me fondet që prokurohen.

Situata rezulton edhe më kritike, sa i takon aplikimit të kontraktimeve përmes ligjeve speciale pa prokurim dhe tenderim, apo kontraktimeve sekrete.

Një tjetër defekt madhor i prokurimeve në vend, me pasoja të rënda sa u takon kontraktimeve dhe tenderimeve publike, është kontrolli i munguar i integritetit të kontraktorit publik, në rastin kur ky kontraktor është një biznes për të cilin origjina e kapitalit, apo origjina e paketës kontrolluese të kapitalit, është në një vend me regjistër tregtar guaskë *shell*, regjistër ku nuk deklarohet zotëruesi-individ dhe ruhet konfidencialiteti.

Në raste të tilla, përveç parregullsive tipike, jemi përpara riskut për kontraktim të shoqërive që janë në konflikt interesi apo subjekt i pastrimit të parave të krimit apo korrupsionit.¹

2. Propozime për ndryshim

Sa më lart, vendi ka nevojë për Reformë të menjëhershme në Prokurime Publike. Kjo reformë nuk është thjesht e karakterit ligjor, madje shpesh ndryshimet ligjore nuk sjellin rezultat. Shumë ndryshime për sektorin e prokurimeve do të duhet të bëhen në ligje të tjera. Reforma në Prokurime duhet të fillojë me elementë si:

1. Ndalimi me ligj i kontraktimeve përmes ligjeve speciale. Po njësoj, edhe i ndryshimeve kontraktore me ligj special. Ndryshe njihen si Ligje AdHoc, Ligje speciale, Ligje të përdorura në një rast kontraktor, Kontraktime me Vendimmarrje Politike.
2. Kuadri ligjor që garanton kontrollin e integritetit të kontraktorit publik dhe paketës zotëruese të kapitalit. Ligji për “Deklarimin e Pronarit Përfundimtar” duhet të hyjë menjëherë në fuqi dhe duhet zbatuar me rigorozitet, sidomos për kontraktorë apo nënkontraktorë të kontratave publike (asete dhe fonde publike).


¹ Pasqyra më lart bazohet dhe ilustrhet me të dhëna të: Prokurimeve Publike dhe Algoritmit të Vlerësimit të Riskut OpenProcurement.al¹ (<http://openprocurement.al/en/index/index>); OpenCorporates.al Shoqëri biznesi kontraktore në tenderim (<http://opencorporates.al/sq/company>) , PPP (<http://opencorporates.al/sq/concession>), apo Programi “Shqipëria 1 Euro” (<http://opencorporates.al/sq/oneeurocompany>)

3. Monitorimi publik, *Integrity Pact*, ose fuqizim i mekanizmave të monitorimit të pavarur dhe auditimit social në procesin e prokurimeve. Shumë vende që kanë ndërmarrë reforma në sistemin e prokurimeve publike, kanë punuar në partneritet me organizatat e specializuara në antikorrupsion. Sistemi i vlerësimit të jashtëm të riskut, auditimi i pavarur i kriterëve dhe angazhimi përmes standardeve dhe parimeve *Open Contracting*. Në çdo procedurë auditohen kriteret nga entitete të pavarura, të specializuara, pastaj shpallet gara.
4. Aplikimi *Short List* dhe verifikimi periodik i kapaciteteve të operatorëve ekonomikë. Nëse një operator vlerësohet periodikisht, nuk ka arsye të vlerësohet dhe skualifikohet rast pas rasti. Skualifikimi i operatorit me ofertë më të lartë për kriterë bazë, shoqëruar me mosankimim, shpesh është indikator i fiktivitetit dhe marrëveshjes mes bizneseve konkurruese. Ky lloj skualifikimi haset shpesh tek tenderat në infrastrukturë kombëtare, Fondi i Zhvillimit, dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar, që janë edhe institucione me portofol të lartë për tenderime.
5. Transparencë: asnjë kontratë nuk duhet të hyjë në fuqi pa qenë e publikuar. I njëjti parim duhet zbatuar për çdo etapë të procesit të kontraktimit, nga planifikimi i kontratës deri te realizimi final.
6. Aplikimi i parimeve dhe standardeve të *Open Contracting Partnership*² dhe aplikimi i algoritmeve për sinjalizim risku³ nga vetë institucionet.

Strategjia Kombëtare për Antikorrupsionin duhet të referojë në një kapitull të veçantë “Antikorrupsioni në Sektorin Publik”.

² <https://www.open-contracting.org/>

³ <http://openprocurement.al/en/redflag/index>



QEVERISJE PËR NDRYSHIM

EKONOMIA,
QEVERISJA,
MJEDISI,
INFORMACIONI
DHE EDUKIMI



Forumi i
Pavarur i
Rektorëve



Këshilli Shqiptar i Medias

Edukimi, kërkimi shkencor, dhe media

Arsimi i lartë: Sfida dhe perspektiva

Prof. Dr. Artan Hoxha / Konferenca e Rektorëve

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

1. **Mbështetja e pamjaftueshme buxhetore për arsimin e lartë** ka ndikuar në zhvillimin e infrastrukturës së institucioneve të arsimit të lartë dhe në nivelin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në raport me standardet ndërkombëtare. Pandemia tregoi se institucionet e arsimit të lartë në vend, të bazuara te pedagogjia tradicionale, u gjendën papritmas përballë kërkesës për të zhvilluar mësim në distancë, duke përdorur teknologjinë digjitale. Kjo dëshmoi se infrastruktura universitare nuk e mbështeste dot mësimin online dhe se kompetenca digjitale e pedagogëve dhe e studentëve ishte e pamjaftueshme. Për disa vite rresht nuk ka patur një vlerësim financiar për personelin akademik. Pagesa e tij nuk është rishikuar sipas zhvillimeve ekonomike e taksave të vendosura këto vite.
2. Fryma e ligjit të arsimit të lartë, e cila shkon për shtat me tendencat aktuale të riorganizimit të institucioneve të arsimit të lartë edhe në rang ndërkombëtar, kërkon **fuqizimin e tyre** në vend. Aktualisht, në Shqipëri funksionojnë 41 institucione të arsimit të lartë, prej të cilave 12 publike dhe 29 jopublike për 2 845 955 banorë (INSTAT, 1 janar 2020). Vërehet një numër i madh i tyre në raport me numrin e popullsisë dhe shpërndarjen e saj gjeografike, si dhe një ofertë akademike e ngjashme në pjesën më të madhe të tyre, gjë që ka sjellë një orientim jo të qëndrueshëm të programeve të studimit në lidhje me kërkesat dhe fushat e tregut për punësim. Lëvizja demografike e popullsisë drejt qyteteve më të mëdha, lëvizja e të rinjve me mundësi më të mëdha studimi jashtë vendit, specifikat karakteristike të qyteteve të caktuara drejt zhvillimit turistik, agrar apo industrial, prirja në botë për megauniversitete, do të kërkonte një rikonceptim të vizionit të arsimit të lartë dhe një diversifikim të misionëve të IAL-ve publike dhe jopublike, dhe një ristrukturim që do ta bënte arsimin e lartë më eficient, që do t'i përgjigjej më mirë strategjisë së zhvillimit të vendit dhe shoqërisë globale. Në ditët e sotme, të rinjtë presin edhe më shumë: ata kërkojnë nga institucioni i arsimit të lartë një zhdërvjelltësi, një fleksibilitet, një hapje e cila u mundëson studentëve të shprehin potencialin e tyre të plotë. Të rinjtë presin që universitetet t'u japin atyre mundësinë për të përmbushur ambiciet, ëndrrat, për të zhvilluar të gjitha talentet e veta, pavarësisht nga larmia e tyre.
3. Nën shembullin e disa shteteve të zhvilluara, qeveria do të duhej të përcaktonte **numrin e universiteteve që** do të mbështesë për t'i dhënë statusin e universiteteve kërkimore dhe të universiteteve të klasit ndërkombëtar dhe të ofronte një mbështetje financiare për këtë qëllim.

4. **Mungesa e një strategjie afatgjatë dhe novatore për arsimin e lartë** ka bërë që IAL-të të jenë më të mbyllura në vetvete dhe të mos kenë një projeksion të mirëpërcaktuar që do të shërbente për të vendosur objektiva të qartë dhe të matshëm në funksion të zhvillimit të shoqërisë, ekonomisë, si edhe për t'i paraprirë ndryshimeve apo fenomeneve të mundshme në shoqërinë shqiptare dhe atë globale. Pandemia tregoi nevojën për të rishikuar rolin e universiteteve në shoqëri.

2. Propozime për ndryshim

1. Të parashikohet mbështetje më e madhe financiare në platformat elektorale të partive politike për sektorin e arsimit, duke përmbushur premtimet që kjo mbështetje të jetë në nivelin e 5% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). Përvoja në vendet e rajonit tregon se kjo përqindje shkon në nivelin e 4-4,5% të **PBB-së**. Aktualisht, për vitin 2021, mbështetja për sektorin e arsimit është parashikuar të jetë 3,8 e PBB-së dhe shpenzimet për arsimin e lartë zënë prej vitesh rreth 0,7-0,8% të PBB-së. Kjo do të përmirësonte infrastrukturën fizike, didaktike, kërkimore si edhe cilësinë e arsimit të lartë. Digjitalizimi dhe përshtatja e IAL-ve me sfidat globale të zhvillimit ekonomik dhe mjedisor kërkon domosdoshmërisht vëmendje më të madhe financiare nga buxheti i shtetit. Nevojitet një vlerësim i qëndrueshëm financiar për personelin akademik, duke parë mundësinë e rritjes së pagës me rreth 20% në vit për t'ju afruar trajtimit financiar të tyre me vende si Kosova dhe Maqedonia e Veriut.
2. Ristrukturimi i institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri, duke marrë parasysh shpërndarjen gjeografike të tyre dhe profilizimin në programe në të cilat këto universitete kanë pasur një traditë të hershme. Vitet fundit, e shumica e IAL-ve nëpër rrethe po përballen me një tkurrje të konsiderueshme të numrit të studentëve në programet që këto universitete ofrojnë. Ky tregues është më se i qartë për nevojën e domosdoshme të riorganizimit dhe specializimit të këtyre IAL-ve, duke u përshtatur me zhvillimet ekonomike, sociale, demografike dhe të teknologjisë së informacionit. Numri i lartë i IAL-ve për banor, i cili ndikon negativisht në cilësi dhe në efekte financiare, kërkon diskutim në zhvillimin e strategjisë së arsimit të lartë, duke parë mundësinë e riorganizimit të këtyre institucioneve me qëllim zvogëlimin e kostove administrative, rritjen e përfitimeve si pasojë e sinergjive që do të krijohen. Përpos kësaj, krijimi i kampusit të ri për Universitetin e Tiranës me

një plan të menjëhershëm dhe të shpejtë ndërtimi, do të krijonte garanci për një arsim universitar bashkëkohor.

3. Mbështetja e veçantë e qeverisë për 2-3 universitete, për t'i shndërruar në **universitete kërkimore dhe me status ndërkombëtar**, duke vlerësuar mundësinë e ribashkimit të Universitetit të Tiranës dhe përqendrimit të interesit publik në krijimin e një institucioni elitar. Bazuar në kontributin e Universitetit të Tiranës që prej themelimit të tij, kapacitetin intelektual që ai zotëron, ky universitet do të duhej të kishte mbështetjen e veçantë financiare të qeverisë, duke investuar për të ndërtuar një kampus modern, për teknologjinë moderne, për zhvillimin profesional të personelit akademik dhe ndërkombëtarizimin, të cilat do ta bënin atë një institucion modern që do të prodhonte specialistë të nivelit bashkëkohor, do të tërhiqte studentët që synojnë studimet jashtë vendit dhe do t'i jepte statusin e universitetit lider ndërmjet universiteteve në rajon, që ofrojnë programe të studimit në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj.
4. Bashkëpunim i ngushtë i shtetit me IAL-të për të përcaktuar një **strategji afatgjatë** për arsimin e lartë shqiptar të shekullit XXI. Nevojitet konceptimi i një strategjie të arsimit universitar bazuar në një studim, diskutime, analiza dhe rezultate të problematikave që has universiteti sot, përvojave të tij më të mira, sfidave botërore dhe si ndikojnë ato në universitet dhe në fund, rekomandime dhe përparësi që mund të drejtojnë veprimin e të gjithë aktorëve të IAL-ve të Shqipërisë, nga komunitetet universitare te autoritetet qeveritare, shoqëria civile, etj., për një periudhë 10-15-vjeçare. Nëpërmjet kësaj strategjie, institucioni universitar përmbush misionin e tij tradicional që t'i shërbejë vendit dhe shoqërisë përmes veprimit që merr në kohën e sfidave të mëdha. Hartimi i një dokumenti të zhvillimit strategjik do të shoqërohet edhe me bazën ligjore përkatëse.

Edukim, Kërkim, Inovacion

Dr. Elona Karafili/ Universiteti POLIS
Forumi i Pavarur i Rektorëve

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Nevoja për ndryshim dhe progres në zhvillimin e arsimit të lartë artikullohet në katër çështje themelore si në vijim:

1. **Nevoja për të garantuar autonominë e Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL)** nga njëra anë, por edhe për të rritur përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe transparencën e tyre, nga ana tjetër.

Ndërkohë që ligji në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-e (80/2015) sanksionon qartë autonominë organizative dhe financiare të IAL-eve, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij e kanë ngurtësuar së tepërmi kuadrin ligjor, duke lënë pak hapësirë për IAL-et, që ato të mund ta ushtrojnë këtë autonomi.

2. **Rritja e buxhetit për arsimin e lartë** (sidomos zëri për kërkim dhe inovacion)

Për 2020-ën, projekt-buxheti për arsimin e lartë parashikonte 0,54% të PBB-së, kurse ai për kërkim e inovacion ishte në nivele gati inekzistuese (0,036%).

3. **Forcimi i marrëdhënies së universiteteve me bizneset**

Ka një mospërputhje të ndjeshme mes aftësive me të cilat studentët pajisen gjatë arsimit të lartë dhe nevojave të tregut (reflektuar në një nivel shumë të lartë të papunësisë mes të rinjve – diku te 30% ose dyfishi i mesatares së BE-së), gjë që vjen edhe si pasojë e një marrëdhënieje shumë të kufizuar mes universiteteve dhe bizneseve (Bartlett, 2016; Civici, 2017).

4. **Të mësuarit gjatë gjithë jetës**

Sipas OECD-së, përqindja e të rriturve që marrin pjesë në edukim dhe trajnim (formal ose informal) në Shqipëri është shumë e ulët (as 10% në total, ku vetëm 1% në edukim formal), gjë që tregon se ka ende një potencial të madh për të rritur produktivitetin e forcës së punës.

2. Propozime për ndryshim

Për të adresuar nevojat e identifikuara si më sipër, ofrohen katër objektiva konkretë:

- Aspekte të ndryshme si **transferimi i studentëve, hapja/riorganizimi i programeve të reja** dhe së fundmi edhe **projekt-udhëzuesi** “Mbi aplikimin për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, për fitimin e gradës shkencore

“Doktor”. Këto çështje janë urgjente për t’u adresuar, në mënyrë që të lehtësohet puna e IAL-ve dhe të rriten rezultatet e tyre.

- Sigurisht që një vend me buxhet të kufizuar duhet të prioritarizojë politikat dhe investimet, por duke mos e vendosur sistematikisht arsimin dhe shkencën si pjesë të prioritetëve, vendi do të vazhdojë të zhytet në rrethin vicioz të konkurueshmërisë së ulët dhe humbjes së kapitalit njerëzor. Propozojmë që **buxheti** të shkojë në nivelet e synuara, **minimalisht 2% për arsimin e lartë dhe 1% për kërkimin dhe inovacionin**.
- **Promovimi** i koncepteve si ***Entrepreneurial University dhe Dual Education*** mund të forcojnë marrëdhënien mes universiteteve dhe bizneseve. Këtu, adaptimi i një **qasjeje në nivel rajonal** (Ballkanin Perëndimor) do të ndihmonte në arritjen e një mase kritike, që e bën më të realizueshëm këtë objektiv.
- Nxitja e ofrimit të **kurseve të formimit të vazhdueshëm dhe trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve** të stafit të IAL-eve. DAP-i e ofron prej vitesh këtë shërbim për administratën publike, por duhet lehtësuar organizimi dhe ofrimi i një programi të tillë nga IAL-et, që të diversifikohet dhe përmirësohet kualifikimi i të rriturve.

Jo më: “Hyp këtu, të shoq Stambollin!”

Prof. Dr. Artan Fuga

Pas 8 vjetësh, sot, pas praktikave për Reformën e Arsimit të Lartë, nuk kemi ende asnjë studim qeveritar për atë se cilat janë rezultatet e saj, veç disa fjalëve propagandistike në mitingje periferike për fushatë elektorale.

Janë ndryshuar disa ministra dhe zëvendësministra e askush nuk e di më se e kujt është përgjegjësia. Njeri bëhet kryetar bashkë diku, një tjetër riemigron, tjetra rikthehet nga erdhi, dikush merret me ndërtimet në Tiranë, tjetri i papunë etj. Ndër deputetët e komisionit të arsimit dhe shkencës, dy a tre prej tyre e njohin sistemin shkencor dhe arsimor nga brenda. E, megjithëkëtë, ata bëjnë ligjin. Është e qartë se **sistemi arsimor dhe shkencor ka nevojë për vetërregullim dhe autonomi të shkallës së lartë të sistemit të arsimit të lartë dhe shkencës.**

Kemi një ligj për Akademinë e Shkencave që bie ndesh, siç është pranuar nga vetë ligjvënësit, me ligjin për arsimin e lartë dhe një ligj për arsimin e lartë, që ndalon veprimtari për të cilat Akademia e Shkencave kryen aktivitete dhe merr financime nga qeveria. Kemi financime qeveritare arbitrare dhe pa konkurrim publik, për studime që priren të vërtetojnë krijimin absurd të “imunitetit të tufës”, në një kohë kur pandemia e Covid-19 ka arritur pikun e saj, sa u përket vdekjeve.

Kemi mijëra të rinj që zgjedhin të ikin për studime jashtë vendit. Anë e mbanë mbyllen profile studimesh për mosregjistrim studentësh, pra, jo si rezultat i një strategjie transformimi të tyre nën drejtimin e Ministrisë së Arsimit, por si dështime.

Dy vjet më parë, studentët dolën në rrugë për të dëshmuar varfërinë dhe pakënaqësinë e tyre, dhe si përgjigje morën fjalë pa asnjë rezultat. Për të mos folur për tezën e letërsisë, atë të maturës, me në qendër hallet e Turit, një personazh tuhaf hilarizues, i ngjashëm me Din Pakun, që duket më tepër një hallakatjeje psikopatologjike, çka reflekton kaosin e cilësisë të arsimit parauniversitar. Kjo çoi në të parën demonstratë nxënësish në historinë e njerëzimit, ku nxënësi kritikonte mësuesin!

Dhe tani, pas 8 vjetësh, ajo që premtohet, është se qeveria do të sjellë në Fier Universitetin Politeknik të Stambollit, që s’është as më pak e as më shumë veçse një dështim i pranuar i reformës. Po të përdorja një fjalë të urtë popullore shqiptare, është: “Hyp këtu, të shoq Stambollin!”.

Nga ana tjetër, një reformë e vërtetë e arsimit universitar nuk mund të konceptohet nga tre ose katër persona politikë, që nuk ka sesi ta njohin sistemin universitar pa studime dhe pa konsultime me komunitetin e gjerë universitar. Mbi të gjitha, kërkohet të përcaktohen të gjitha degëzimet dhe hallkat sistematike ku duhen bërë korrigjimet, ndërhyrjet, si edhe nivelet administrative, financiare, shkencore, të të drejtave të studentëve, që sot janë në nivel vetëm të të drejtave kolektive, të orientimit me tregun apo edhe në sistemet e drejtimit të arsimit të lartë.

Po ashtu, **në planin strategjik, duhen përcaktuar vlerat që do të udhëheqin këtë reformë.** Nuk vlen një program reforme, nëse nuk paraqitet fillimisht strategjia, ana financiare, qëllimet, objektivat, parametrat e matjes të arritjeve të pritshme të saj etj., pra, nëse kalohet në mënyrë amatoreske drejt e në propozime heteroklite, dhe pa lidhje me njëri-tjetrin.

Reforma arsimore nuk duhet konfunduar as thjesht me reformën ekonomike të mbështetjes të studentëve apo të politikave sociale për ta. Kështu, sado e rëndësishme të jetë ana ekonomike në financimin e studimeve, nuk duhet të na çojë në një temë tjetër. Problemi nuk është thjesht se studenti ka vështirësi ekonomike, por se pas viteve të gjata të studimeve, pas tërë atyre sakrificave, ai ka në dorë një diplomë që nuk është aspak siç e ëndërronte, gjeneruese vlerash monetare dhe sociale për të.

Mbi të gjitha, na **duhet të ndajmë mirë dhe qartë profilet e studimeve** që:

- a) bëhen thjesht për të rritur nivelin kulturor të qytetarit;
- b) diplomojnë specialistë të lartë për fusha të ndryshme të shoqërisë;
- c) çojnë në profesione praktike, të cilat duhet ta rrisin peshën e tyre;
- d) studime ekselence që diplomojnë elita teknokratësh dhe administratorësh të talentuar. Të gjitha këto, tani janë përzier në një nebulozë amorfe.

Jam për **një arsim të lartë, të bazuar në përgjegjshmërinë e pedagogut dhe studentit** për të marrë përsipër iniciativën e formimit të të diplomuarve, jo për një student dhe pedagog pa iniciativë dhe thjesht pasues urdhrash administrativë vertikalë nga agjenci dhe institucione të politizuara.

Jam për **universitete private dhe publike që bashkojnë realisht burime financiare të diversifikuara, të menaxhuara afatgjatë**, që nxisin përgjegjësinë për cilësi nga ana e stafëve dhe nuk e shtojnë personelin e tyre pa asnjë llogari financiare bazuar tek arritja e optimumit: financim-rezultate, pra, kthim i investimit të bërë për burimet njerëzore ose infrastrukturore.

Jam për një **arsim të lartë të bazuar në kërkimin shkencor** dhe jo në dogma apriorike, në të cilat kanë prirje të kthehen të gjitha dijet e ngurtësuara në stereotipa.

Jam për **arsim të lartë që hap perspektiva pune dhe integrimi për të diplomuarit në tregun e punës**, jo të bazuar në fakultete që bëjnë pranime masive studentësh, pa kriterë funksionale pranimesh, ndonëse anë e mbanë vendit, punësimi i studentëve të diplomuar nga këto fakultete, është zero për qind.

Jam për një **integrim të kulturës, shkencës, ekonomisë dhe administratës publike** në kuptimin që në këtë të fundit, të vërshojnë më të mirët dhe jo militantët.

Jam për **hapje të departamenteve, fakulteteve dhe tregut universitar shqiptar** dhe jo për ndërtimin e tyre si kazerma të ndara me thikë dhe administrativisht.

Nuk mund të preken të gjitha, por po ndalem vetëm në disa këndvështrime makrouniversitare, pa pasur as kohën e duke mos qenë as vendi për t'i zhvilluar imtësisht idetë. Megjithatë, nuk janë pjesë e utopisë, pavarësisht se është një ëndërr. Mjafton të hedhësh sytë në Evropë dhe kupton se arsimi dhe shkenca te ne janë nën frenat e politikës, administratës shtetërore vertikale dhe të politizuara, pavarësisht se ky vertikalitet merr emrin "agjenci", si edhe nën presionin e interesave të disa shtresave të privilegjuara, të lidërshit dhe shtresave të privilegjuara lokale ose kombëtare. Për ta përmbledhur: Politika te ne privon dhe mban nën zinxhirë shkencën, arsimin universitar dhe edukimin. **Pyetja ime sot është: A do politika një qytetar të formuar apo jo? Apo do votues të paditur që manipulohet lehtësisht?**

Konstatoj se në historinë e Shqipërisë, të shqiptarëve, edhe kur Shqipëria nuk ishte shtet më vete, sot diferencat mes nivelit të dijeve të rinisë së vendit dhe nivelit të të rinjve evropianë janë më të mëdha se kurrë ndonjëherë më parë, edhe në krahasim me epokën kur latimin me daltën me gur e përdorte greku dhe latimin me gur përdorte edhe iliriani; lopën ushqente italianin apo Gjermanin lopën mirëmbante edhe arbri. Sot, kohët janë të tjera. Hendeku është thelluar së tepërmi.

- Tregu shqiptar i arsimit të lartë ka **nevojë të hapet gjerësisht** jo vetëm ndaj shqiptarofolësve të Ballkanit, por ndaj gjithë të rinjve të Ballkanit e më gjerë. Politikës së kuotave që kalojnë nga Ministria e Arsimit i ka ardhur koha të tregojë se ato janë si vrima gjilpëre ku nuk kalon dot qarkullimi i studentëve dhe i pedagogëve.
- Maturantët shqiptarë nuk kanë pikën e arsyes të mos **shkojnë lirisht të konkurrojnë drejtpërdrejt** për një vend studimi në universitetet të gjithë vendit, atje ku ata dëshirojnë, por të detyrojnë të kalojnë nën kontrollin e agjencive të ministrisë për t'i shpërndarë ata atje ku asaj i teket.
- Provimet e maturës duhet të shpëputen nga “thonjtë” e stafeve të shkollave të mesme, ku bëjnë favorizimet dhe privilegjet për militantët dhe presionet ndaj mësuesve, duke u **organizuar në nivel qendra qarqesh**, në salla dhe stadione të mëdha.
- Kriteret e **ekselencës**, nën kontroll të fortë publik, më mirë se kushdo **i vendosin dhe i matin universitetet** përkatëse.
- Ka ardhur koha t'i jepet fund klonimit dhe mbivendosjes së katedrave të ndryshme, që titullohen me fusha studimesh uniforme dhe homogjene, por të kërkohet që **çdo profil i ri studimesh që identifikon një njësi bazë, të ketë specifikat e veta** të dallueshme prej të tjerave.
- Nuk mundet që peizazhi universitar shqiptar të jetë ende nën paragjykimin e hierarkisë në vlera midis universiteteve në Tiranë dhe atyre dytësore në rrethe, ku e vërteta është se nuk dihet shumë se ç'bëhet. Krijimi i **katedrave të ekselencës në universitete të ndryshme**, pa përsëritur njëra-tjetrën, mund të ishte hapi i parë i profilimit të ndjeshëm të universiteteve shqiptare, çka do të gjallëronte periferinë e vendit dhe do të ndihnte decentralizimin real të dinamikave urbane. Të shkoj, ta zëmë, në Universitetin e Gjirokastrës se atje, ta zëmë, do të kishte një fakultet Gjuhë dhe Letërsie, ndër më të mirët në vend, jo ngaqë jam me banim në Memaliaj dhe nuk më doli e drejta e studimeve në Universitetin e Tiranës.
- Nuk ka më arsye që studenti në një universitet publik a privat të mos **regjistrohet në më shumë se një profil studimesh njëherësh** ose brenda një afati të caktuar disi më të gjatë kohe. Nuk ka përse të vazhdohet me mendësi të viteve '70: *një njeri, një bursë studimesh gjatë gjithë jetës*.

- Tregu shqiptar i arsimit të lartë ka **nevojë të hapet gjerësisht** jo vetëm ndaj shqiptarofolësve të Ballkanit, por ndaj gjithë të rinjve të Ballkanit e më gjerë. Politikës së kuotave që kalojnë nga Ministria e Arsimit i ka ardhur koha të tregojë se ato janë si vrima gjilpëre ku nuk kalon dot qarkullimi i studentëve dhe i pedagogëve.
- Maturantët shqiptarë nuk kanë pikën e arsyes të mos **shkojnë lirisht dhe drejtpërdrejt të konkurrojnë** për një vend studimi në universitetet të gjithë vendit, atje ku ata dëshirojnë, por të detyrojnë të kalojnë nën kontrollin e agjencive të ministrisë për t'i shpërndarë ata atje ku asaj i teket.
- Provimet e maturës duhet të shkëputen nga “thonjtë” e stafeve të shkollave të mesme, ku bëjnë favorizimet dhe privilegjet për militantët dhe presionet ndaj mësuesve, duke u **organizuar në nivel qendra qarqesh**, në salla dhe stadione të mëdha.
- Kriteret e **ekselencës**, nën kontroll të fortë publik, më mirë se kushdo **i vendosin dhe i matin universitetet** përkatëse.
- Ka ardhur koha t'i jepet fund klonimit dhe mbivendosjes së katedrave të ndryshme, që titullohen me fusha studimesh uniforme dhe homogjene, por të kërkohet që **çdo profil i ri studimesh që identifikon një njësi bazë, të ketë specifikat e veta** të dallueshme prej të tjerave.
- Nuk mundet që peizazhi universitar shqiptar të jetë ende nën paragjykimin e hierarkisë në vlera midis universiteteve në Tiranë dhe atyre dytësore në rrethe, ku e vërteta është se nuk dihet shumë se ç'bëhet. Krijimi i **katedrave të ekselencës në universitete të ndryshme**, pa përsëritur njëra-tjetrën, mund të ishte hapi i parë i profilimit të ndjeshëm të universiteteve shqiptare, çka do të gjallëronte periferinë e vendit dhe do të ndihnte decentralizimin real të dinamikave urbane. Të shkoj, ta zëmë, në Universitetin e Gjirokastrës se atje, ta zëmë, do të kishte një fakultet Gjuhë dhe Letërsie, ndër më të mirët në vend, jo ngaqë jam me banim në Memaliaj dhe nuk më doli e drejta e studimeve në Universitetin e Tiranës.
- Nuk ka më arsye që studenti në një universitet publik a privat të mos **regjistrohet në më shumë se një profil studimesh njëherësh** ose brenda një afati të caktuar disi më të gjatë kohe. Nuk ka përse të vazhdohet me mendësi të viteve '70: *një njeri, një bursë studimesh gjatë gjithë jetës*.

- Nuk ka asnjë arsye që studenti të mos bëhet **bashkëhartues i programit të studimeve** dhe ta zgjedhë vetë pistën e diplomimit, nisur nga një listë e gjatë propozimesh lëndësh të bëra nga personeli.
- Tirana ka nevojë për ëndrrën e një qendre dokumentacioni dhe biblioteke qendrore universitare me rrezatim kombëtar, sikurse e ka çdo universitet i madh në Evropë, ku unë shoh një kullë, të vetmen kullë që gjeneron dritë dhe jo shkatërrim, me disa kate mbi tokë dhe po atë nën tokë, pajisur me librat dhe dokumentet për studime bashkëkohore, me mijëra vende studimi për universitarët.
- Ëndërroj që **vlerësimet e diplomave të çojnë në një diferencim të njohur normativisht** të tyre, në varësi të cilësisë së universitetit që i ka dhënë ato. Diploma me nivele të ndryshme sipas niveleve të universiteteve në kohën e dhënies së tyre, në vend të “shpatës” politike mbi aktorët universitarë me rrezikun e moscertifikimit në çdo katër vjet.
- Ka nevojë që njësitë publike, pse jo edhe ato private, të kthehen në asete ku bashkëpjesëmarrës në aksione mund të jenë shteti, vetë universiteti, pse jo personeli pedagogjik, si edhe biznese të ndryshme të interesuara. Financat universitare, sikundër të gjithë financat, ka vend **t’i administrojë ai që jep paratë**. Jo me borde inkompetente të zgjedhurish, pasuar me individë që futen aty thjesht si militantë partiakë a të njohur ministrash, pa asnjë afatgjatësi strategjike në vizionin e tyre. Vijnë e ikin çdo katër vite.
- Nuk **matet cilësia e universiteteve** kryesisht me *input*-et, siç ka ndodhur deri më sot, por me *output*-et, pra: me atë se **çfarë japin si rezultat**, jo me ato që kanë si kushte paraprake. Askush nuk e mat në këtë mënyrë rezultatin e punës. Kriteret bazë të vlerësimit të universiteteve janë arritjet në punën shkencore, niveli i dijeve, i matur edhe nga provime kombëtare për lëndë bazë, si dhe nga aftësia për të ndërtuar programe studimesh që punësojnë dhe i japin impulse zhvillimit kombëtar.
- Sistemi i **notave ka nevojë të kalojë me 20 ose 30 pikë**, që të dallojë mirë cilësinë e përgatitjes studentore.
- Mbi këto kritere të vijnë edhe **financimet buxhetore publike, që atje ku duhet me konkurrim publik, të çelin fonde për profile studimesh ekselente**, pa mbajtur parasysh nëse universiteti është privat apo publik. Krejt të tjera ka nevojë

të jenë parametrat e matjes së nivelit të kërkimit shkencor. Sot, ne kemi parametra shpesh korruptivë që matin aftësinë botuese të dikujt, por jo vlerën sociale të kërkimeve shkencore.

- Mbi të gjitha, vendi ka nevojë për një diversitet **qendrash shkencore** dhe jo për prirje si ato të Akademisë së Shkencave, ndërtuar në formë staliniste, që kërkon, në kundërshtim me vetë ligjin në fuqi, të monopolizojë drejtimin e kërkimit shkencor të vendit, pa pasur asnjë potencial për këtë. Kombi duhet të ketë prioritetet e kërkimit shkencor në çdo fushë, që të jenë pista kërkimesh dhe kualifikimesh shkencore.

Nuk po zgjatem më tej, por **një reformë e arsimit të lartë nuk është një program elektoral për vota: është përpjekja, pa kompromis, për ta bërë kombin më të mençur.** Jemi larg! Përndryshe do të kënaqemi me shprehjen: “Hyp këtu, të shoq Stambollin!”.

Modernizimi i arsimit profesional në Shqipëri

Z. Fation Dragoshi / Swisscontact Albania

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Arsimi i mesëm profesional (publik ose jopublik) mbetet një **zgjedhje e dorës së dytë** për të rinjtë në Shqipëri. Mes 16% dhe 18% e nxënësve kanë zgjedhur shkollat profesionale në vend, krahasuar me 82%-84% që shkojnë në gjimnaze apo shkolla të mesme social-kulturore¹. Në vendet e Ballkanit Perëndimor, kjo shifër varion mes 60 dhe 75%. Ndërkaq, në ekonomitë e zhvilluara në Evropë, përqindja e nxënësve që zgjedhin arsim profesional është mes 55% dhe 75% të totalit². Kjo tregon për një tendencë në shoqërinë shqiptare për të **mos aplikuar “mësimin përgjatë gjithë jetës”**, po për “të mësuar gjatë në pjesën e parë të jetës”. Kjo gjë e dëmton shumë potencialin rinor në vend. Për të adresuar këtë, nuk mjafton ligji i radhës, por duhet të ndryshojë qasja në nivel kulturor shoqëror. Studimet ndërkombëtare sugjerojnë se studentët që do të hyjnë në treg këto vite, do të ndryshojnë rreth njëzet vende punë në të ardhmen, në 4-5 sektorë të ndryshëm. Arsimi duhet medoemos t'i përshtatet kësaj tendence.

Figura 1. Numri i nxënësve që zgjedhin arsimin profesional ndaj totalit në Shqipëri




Burimi: INSTAT, 2021

¹ INSTAT, 2021

² Eurostat, 2016


Figura 2. Përqindja e nxënësve që zgjedhin shkollim të mesëm profesional në Evropë (2016)



Burimi: Eurostat, 2016

Ndërkaq, **norma e diplomimit** (*Output Rate*) në Shqipëri për arsimin profesional është në vlerën $\pm 60\%$. Arsye kryesore për këtë mbetet **largimi i të rinjve jashtë vendit**. Përqindja e atyre që janë në punë 1 vit pas diplomimit në Shqipëri është $\pm 45\%$, shumë më e ulët krahasuar me vendet e OECD (rreth 60%). Nga këta, **vetëm 56% punojnë në profesione që kanë lidhje me studimet e kryera**. Nxënësit “e mirë” vijojnë studimet universitare e më tej. Nga 100 të rinj që e fillojnë arsimin profesional në klasën e 10-të, vetëm 15 do të kontribuojnë si specialistë të mesëm në kompani të cilat janë të lidhura me sektorin e specializimit të tyre. Jo të gjithë nga këta punojnë në kompani në Shqipëri. Ky është një problem serioz i mungesës së eficiencës.

Figura 3. Situata e punësimit 1 vit pas diplomimit, për nxënësit e shkollave profesionale në Shqipëri



Burimi: autori


Figura 4. Statistika të diplomimit në një shkollë profesionale dhe të punësimit të mëtijshëm në Shqipëri

Rregjistrohen	Diplomohen	Në Punë	Punë Relevante
100	60%	45%	56%
100	60	27	15

Burimi: Autori

Kohët e fundit, **kompanitë** kanë filluar të përfshihen në ndërtimin e kurrikulave dhe **ofrimin e arsimit profesional** përmes praktikave. Gjithsesi, numri i këtyre kompanive është shumë i vogël (rreth 2000) dhe shumica e tyre janë mikrokompani me 1-4 punonjës. Kompanitë nuk kanë specialistë të lexojnë/kuptojnë kurrikulat dhe, për më tepër, organizatat e biznesit nuk kanë kapacitete për të kontribuar në përditësimin e skelet-kurrikulave. Për rrjedhojë, pavarësisht përpjekjeve për të përmirësuar sistemin, **oferta vijon të mbetet supply-driven**, nuk azhurnohet me profesione të reja dhe bëhet edhe më pak tërheqëse për të rinjtë. Të pasigurt mbi aftësinë e kompanive për të ofruar praktikë profesionale cilësore, autoritetet e limitojnë kohën e parashikuar në kurrikula për mësim pranë kompanive. Mesatarisht, kjo kohë varion nga 2,5 deri në 6 orë në javë.

Figura 5. Përqindja që zënë orët e praktikave profesionale në kurrikulat e përgjithshme, klasa X-XIII



Burimi: Autori


Së fundi, një problematikë tjetër lidhet me **nivelin e 5-të të kualifikimeve**, pra, ciklin pas shkollës së mesme dhe para atij universitar. Ky shërbim po ofrohet në 3 vitet e fundit nga një numër i madh institucionesh të arsimit të lartë (publike dhe jopublike). Gjithsesi, vërehet që vendimet mbi programet dhe kurrikulat nuk merren në bazë të studimeve të tregut. Qasja e ofrimit është **e ngjashme me programet akademike**, gjë që i shërben pak nevojës dhe aspiratës së studentëve frekuentues të tyre.

Figura 6. Ofruesit e arsimit profesional të lartë




Burimi: Autori

Figura 7. Programet profesionale universitare shtetërore dhe private



Burimi: Autori

Figura 8. Studentët që frekuentojnë programe profesionale 2-vjeçare



Burimi: Autori

2. Propozime për ndryshim

Propozohen tri drejtime kryesore për ndërhyrje:

1. Ngritja e mekanizmave mundësues për **kapacitimin e kompanive** për të kontribuar në sistemin e zhvillimit të aftësive me shkollat profesionale; me ofruesit e arsimit të lartë profesional, dhe qendrat e formimit (publike dhe jopublike). Kjo mund të mbështetet përmes Organizatave të Industrive apo Dhomave të Tregtisë etj. Baza ligjore ekzistuese është mundësuese/incentivuese për kompanitë për t'u përfshirë në proceset e përditësimit të kurrikulave, ofrimit të moduleve të praktikës profesionale në vendin e punës. Më shumë vëmendje duhet t'i dedikohet **angazhimit konkret** të kompanive në këta mekanizma.
2. **Investime strategjike për digjitalizimin** e arsimit profesional në aspekt infrastrukturor, në pajisje, në trajnim të mësimeve në shkolla dhe kompani etj. Kjo mund të realizohet duke aplikuar modalitete të partneritetit publik-privat.
3. Integrimi në **kurrikulat** e aplikuar të arsimit profesional i **aftësive për jetën** (*Soft Skills*) dhe i **aftësive digjitale**.

Media

Z. Aleksandër Çipa / Unioni i Gazetarëve Shqiptarë

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Dua të sjell në vëmendje tri probleme të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me aktualitetin e sotëm të shoqërisë sonë, por në mënyrë specifike i adresohen komunitetit tonë profesional. Shqipëria ka një Kod bashkëkohor të Etikës së Gazetarit Shqiptar, të përditësuar në 2019-ën.

1. **Së pari, ne nuk mund ta tejkalojmë këtë realitet që ka shkaktuar pandemia.**

Komuniteti ynë është një komunitet në rrezik të madh, për shkak të raportimeve nga terreni dhe nga institucionet e shëndetit publik. Shumë prej reporterëve, më së shumti ata lokalë, kryesisht të mediave vizive, janë të gjendur në mjedis me rrezik të lartë, dhe si të tillë, në asnjë moment, në gjithë harkun kohor të një viti e më tepër nga institucionet e shëndetit publik dhe institucionet e Republikës së Shqipërisë, nuk ka një akt preventiv, i cili mund të marrë në konsideratë këtë rrezik të gazetarëve në terren.

2. **Së dyti, dua të sjell në vëmendjen tuaj nevojën për një qasje tjetër të proceseve vetërregulluese dhe proceseve që rregullojnë realitetin mediatik në Shqipëri.**

Dihet që në një hark kohor prej më shumë se 30 vitesh, në mjedisin e debatit publik ka pasur një referencë kundërshtuese të komunitetit të gazetarëve shqiptarë për nismat e ardhura nga pushteti politik, për rregullime të cilat janë përballur me qëndrime *end-bllok* të të gjithë spektrit të organizatave të gazetarëve dhe të komuniteti të mediave. Kjo ka bërë të mundur që të ketë një solidaritet të mishëruar në qëndrime institucionale dhe deklarata pasuese nga organizatat më prestigjioze të medias në hapësirën globale.

Ne nuk jemi një komunitet që refuzon dy nga aspektet që formëzojnë një medalje me dy anë, që është kriza e rregullimit dhe e vetërregullimit në mjedisin tonë profesional. Por, prevalimi i proceseve vetërregulluese, solidariteti për ngritjen e institucioneve vetërregulluese e kryesisht për ato institucione ekzekutive vetërregulluese dhe këtu Unioni i gazetarëve shqiptarë ndan një optikë vetjake, duke i mëshuar faktit që këto institucione vetërregulluese do të mundësojnë krijimin e një mjedisi më të pastër pa ndotje kaq të lartë etike dhe, natyrisht, duke marrë në konsideratë atë kaos të shkaktuar prej vërshimit dhe mundësisë së përdorimit të infrastrukturës virtuale në mjedisin shoqëror, sidomos në atë hapësirë ndërkombëtare të internetit. Këto qasje do të bëjnë të mundur të krijohet një diferencë kualitative midis komunitetit profesional dhe qytetarit-gazetar.

3. Së treti, dua të sjell në vëmendjen tuaj krizën e gangrenizuar të informalitetit në median shqiptare.

Këtu i referohem aspektit më të investuar si reagim dhe qëndrim. Si një proces periodik të ruajtur në artikullimin dhe denoncimin e të vërtetës prej Unionit, kuotat e informalitetit të marrëdhënieve të punës dhe jo vetëm ato në skenën mediatike të vendit janë ndoshta nga më të lartat në rajonin e hapësirës së Ballkanit Perëndimor dhe fatkeqësisht edhe në kuadër të Evropës ish-Juglindore.

2. Propozime për ndryshim

1. Si rrjedhojë e pandemisë, duhet të nxirret një akt preventiv, i cili merr parasysh rrezikun e gazetarëve në terren.
2. Si pjesë e proceseve vetërregulluese dhe proceseve që rregullojnë realitetin mediatik në Shqipëri, mendojmë se një solidaritet i brendshëm i të gjitha strukturave tona vetërregulluese, të cilat fatkeqësisht janë të munguara, i organizatave që formësojnë një investim profesional në kohë dhe natyrisht edhe në terren, si edhe i editorit shqiptar; gjej rastin të bëj një apel për editorin shqiptar. Ka qenë një proces i munguar solidariteti dhe nismat e ardhura prej editorit shqiptar në gjithë spektrin multimedial të medias shqiptare. Nisma të tilla, në kushtet e një krize të shkaktuar, më së shumti prej prevalimit të *Fake News*, thashethemeve dhe ndotjes së madhe etike, do të bëjnë të mundur që të rikthejë edhe njëherë besueshmërinë e opinionit publik dhe audiencave tona ndaj mediave e ndaj artikullimit që bëjnë gazetarët përmes mediumeve.
3. Si pasojë e informalitetit të medias në Shqipëri dhe në kushtet kur në raportet e detyruara të BE-së për Shqipërinë, këtu u referohem raporteve institucionale që kondicionojnë çështjen e informalitetit të medias dhe raportin e rregullimit të medias në Shqipëri, është çasti që autoritetet institucionale, ligjbërëse dhe ligjzbatuese të risjellin një qasje tjetër të reagimit dhe veprimit, natyrisht pa cenuar as lirinë e medias, as të gazetarit.

Vetërregullimi dhe etika e medias

Z. Koloreto Cukali / Këshilli Shqiptar i Medias /
Aleanca Për Media Etike, mediat dhe gazetarët

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Shqipëria ka një bum të mediave online, të mbiquajtura “portale”. Numri i tyre mendohet se varion në disa qindra, ku përfshihen mediat e mirëfillta, blogjet individuale ose/dhe mediat qytetare. Në renditjen e Alexas (shtator 2019), **ndër 300 website-t më të klikuara në Shqipëri, vetëm 29 janë portale lajmesh**. Ndërkohë, nuk ka asnjë informacion të besueshëm për audiencën e mediave në rrjetet sociale.

Shqipëria ka një Kod bashkëkohor të Etikës së Gazetarit Shqiptar, të përditësuar në 2019-ën.

Në një monitorim të Këshillit Shqiptar të Medias, **30 portale të monitoruara bëjnë rreth 6 shkelje etike në ditë. Ndër shkeljet kryesore të kodit të etikës janë pavarësia editoriale, dallimi i faktit nga opinioni dhe prezumimi i pafajësisë**.

Ka një përkeqësim të perceptuar të cilësisë etike të raportimit në mediat shqiptare, i cili vjen **kryesisht për shkak të modelit (jofunksional) të biznesit të medias shqiptare**. Qoftë media tradicionale, qoftë ajo e re, nuk financohet më nga publiku. Financat vijnë kryesisht përmes:

- reklamave të korporatave/bizneseve;
- financimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga fondet publike;
- këmbimit të favoreve politike dhe ekonomike të pushtetit me pronarin e medias dhe bizneset e tjera të tij;
- financimeve të errëta nga biznese, politikanë të pasur, ose nga krimi.

Për sa kohë që ky model biznesi nuk ndryshon, **media do të jetë nën presionin e 4 grupeve të mësipërme, që sigurojnë financimet**. Asnjë nga këto grupe nuk ka në vëmendje interesin e publikut. Për rrjedhojë, media është gjithnjë e më pak në shërbim të publikut.

Prej 2 vitesh ka një tentativë për të përdorur pakënaqësinë e publikut ndaj performancës së dobët etike të medias shqiptare, **për të bërë një ligj kontrollues ndaj saj. Versionet e ndryshme të këtij projekt-ligji janë shumë problematike** dhe janë kundërshtuar fort nga BE-ja, Këshilli i Evropës, komuniteti i gazetarëve e i shoqërisë civile, si dhe nga organizatat më të mëdha ndërkombëtare të gazetarëve.

2. Propozime për ndryshim

Vetërregullimi është e vetmja formë e njohur në Evropë për të zgjidhur problemet etike.

Këshilli i Medias, bashkë me një grup prej 16 mediash e organizatash mediatike, ka iniciuar Aleancën për Median Etike, të vetmin mekanizëm vetërregullues në vend. Sot, numri i mediave që e mbështesin, ka shkuar në 23. **Ky mekanizëm ndërmjetëson ankesat mes qytetarëve e mediave, pa qenë nevoja për ndërhyrje nga shteti.**

Vetërregullimi ka nevojë për mbështetje dhe bashkëpunim nga komuniteti, institucionet shtetërore dhe nga biznesi. Një media etike, në plan afatgjatë, i shërben një shoqërie të shëndetshme.

Në planin ligjor:

- ka nevojë që **mekanizmi vetërregullues të njihet nga gjykata** si formë ndërmjetësimi mes qytetarëve që bëjnë ankimime dhe mediave që kanë bërë shkeljen;
- **nën shembullin e Kosovës**, mund të ishte me vlerë një **dispozitë ligjore**, e cila u kërkon qytetarëve që para se të iniciojnë një gjyq kundër një gazetari ose një medieje, **të jenë të detyruar të kryejnë një seancë ndërmjetësimi pranë mekanizmit vetërregullues.**

Në planin ekonomik:

- fondacionet, bizneset apo institucionet që subvencionojnë mediat, duhet t'u kërkojnë **mediave që financojnë, të jenë anëtarë të mekanizmit vetërregullues**; një media që nuk pranon të jetë pjesë e vetërregullimit, do të thotë që nuk ka asnjë përkushtim për cilësinë etike;
- përmes institucioneve evropiane dhe mekanizmave të ndihmës ekonomike, **mediat duhen ndihmuar të kalojnë në modele bashkëkohore financimi**, duke i shërbyer publikut.

Në planin politik:

- *Fake News*-i nuk zgjidhet me ligje. ***Fake News*-i luftohen me edukim mediatik.**
- palët duhet të jenë të qarta që **vetërregullimi është një projekt afatgjatë** në të mirë të pavarësisë së medias; çdo lloj tentative për ta rregulluar me ligj etikën, do të çojë në dëme të pariparueshme të medias;
- shumë nga problemet e medias vijnë nga ndërhyrja e pushtetit dhe përzierja okulte e ekonomisë me politikën e median.

Kompanitë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

Z. Dritan Mezini / Shoqata Shqiptare e TIK

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Ne jetojmë në një kohë pandemie të ndryshimeve të vazhdueshme dhe të brishta, ku pandemia shkaktoi panik jo vetëm për shëndetin dhe jetën e njeriut dhe të shoqërisë, por edhe për jetën e shëndetshme të shumë industrive e bizneseve.

Sipas një studimi të *Business Albania*, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Punës dhe BERZH, të organizuar në prill 2020, "Ndikimi i pandemisë Covid-19 te ndërmarrjet shqiptare", rezulton se shumica e kompanive, rreth 69%, u goditën plotësisht ose pjesërisht nga pandemia; rreth 83% e tyre ndryshuan mënyrën e ofrimit të operacioneve të biznesit. Frika që biznesi do të rikthehet në normalitet rezulton e lartë. Qasja shumë e ulët në financa: ku rreth 35% nuk kanë qasje në asnjë lloj finance, 27% kanë qasje në hua dhe grante, rreth 41% kanë larguar njerëz nga puna dhe rreth 68% e bizneseve provuan kërkesë të ulët për produkte dhe shërbime.

Turizmi, bujqësia, transporti, arsimi, shëndetësia ishin ndër sektorët që u goditën më rëndë gjatë pandemisë, ndërkohë që industria e TIK-ut tregoi qëndrueshmëri dhe rritje, kjo si në nivel lokal, ashtu edhe në atë global.

Disa mësimet të kohës së pandemisë tregojnë më së miri se kompanitë e teknologjisë, si dhe kompanitë që ishin më të digjitalizuara në proceset e tyre të brendshme, e kaluan më lehtë sfidën dhe iu përshtatën më mirë kushteve të reja.

Për t'u përshtatur në këtë realitet të ri, kompanitë dhe organizatat kanë nevojë të përdorin teknologjinë për të përqafuar inovacionin, për të rimenduar dhe ripërpunuar proceset e biznesit dhe për të garantuar qëndrueshmëri e rritje.

2. Propozime për ndryshim

Transformimi digjital – prioritet i biznesit privat

- Krijimi i nxitësve për të mbështetur shkallën e transformimit digjital brenda kompanive dhe organizatave.
- Buxhete të dedikuara për transformimin digjital, planifikime strategjike të zhvillimit, edukim i personelit, mbështetje për investimet në TIK; mbështetje për inovacion dhe *Start-Up* etj.

Këtu mund t'i referohemi dhe eksperiencës së institucioneve të huaja, si dhe eksperiencës në vende të tjera, për financim të projekteve për digjitalizim, duke kontraktuar konsulentë dhe kompani të TIK-ut, që t'i kryejnë këto procese.

- Mbështetje nga qeveria e shoqatave të biznesit që përqafojnë këtë nismë.

Digjitalizimi – prioritet kryesor i qeverisë shqiptare

Siç është shëndeti për popullsinë, si prioritet kryesor, ashtu është edhe digjitalizimi i rëndësishëm për shëndetin e shoqërisë.

- Krijimi i një Këshilli Kombëtar të Digjitalizimit me përfaqësues nga aktorët kryesorë të ekosistemit; rritja e buxhetit për digjitalizimin; mbështetje për inovacionin; mbështetje për investimet në përdorimin e teknologjive të reja; edukimi i TIK-ut në të gjitha nivelet; si dhe vazhdimi i zhvillimit të shërbimeve tek e-albania, por edhe formulimi i kërkesave ligjore që të detyrojnë të përdoren këto shërbime.

Rritja e cilësisë së burimeve njerëzore në fushën e TIK-ut është e rëndësishme për të forcuar pozicionin e kompanive tona në tregun lokal dhe global. Si rrjedhojë, kërkohet reformimi dhe orientimi i edukimit formal dhe joformal drejt kurrikulave të teknologjisë dhe inovacionit, si dhe ndërtimi i marrëdhënieve më të qëndrueshme reciproke të institucioneve të edukimit me biznesin. Në veçanti, vlen të përmendet mbështetja për edukimin profesional, që është një rrugë e shkurtër por e sigurt e futjes në tregun e punës.

- Duhet adresuar dhe mbrojtur fenomeni i *brain drain*, duke krijuar lehtësira fiskale për “talentet”, të cilët janë lehtësisht të rekrutuar nga tregu i huaj.

Aplikimi i këtyre masave forcon biznesin, rrit konkurrueshmërinë e kompanive tona në nivel lokal, rajonal dhe global, si dhe promovon Shqipërinë si një vend të mundshëm *outsourcing* në një të ardhme të afërt.



Mjedisi, energjia dhe ndryshimet klimatike

Mjedis, klima, biodiversiteti, ekonomia qarkulluese, zvogëlimi i riskut të fatkeqësive

Z. Mihallaq Qirjo / Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri (REC Albania)

Nevoja, argumente dhe propozime për ndryshim

Problematika e mjedisit shqiptar është thelluar dhe rënduar prej presionit të shtuar ekonomik dhe social mbi mjedisin. Mjedisi shihet si burim dhe mundësi për të gjeneruar zhvillimin ekonomik të vendit përmes sektorëve si energjia, turizmi etj., por edhe si barrë me kosto të papërbalueshme, si për shembull menaxhimi i mbetjeve, përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, ruajtja cilësisë së ajrit, trajtimi i ujërave të ndotura etj.

Nëse çështja e mjedisit në Shqipëri do të duhej të përkufizohej me një fjali, ajo çka mund të thuhet është: **“Të injorosh problemet mjedisore sot, do të thotë të humbasësh shansin për t’i ndryshuar ato”**.

Raporti i Komisionit Evropian i vitit 2020 për Shqipërinë vazhdon të shprehë shqetësimet në sektorin e mjedisit:

*“Shqipëria tregon **njëfarë niveli të përgatitjes** në këtë fushë. **Progres i kufizuar** është bërë në përafrimin e mëtejshëm të politikave dhe legjislacionit me “acquis”, në fusha të tilla si menaxhimi i mbetjeve dhe ujit, krimi mjedisor dhe mbrojtja civile. Sidoqoftë, përpjekje të konsiderueshme janë ende të nevojshme për **zbatimin, veçanërisht në menaxhimin e mbetjeve, cilësinë e ujit dhe ajrit dhe ndryshimin e klimës**” (f. 104, përkthim i autorit).*

Mbetjet: Edhe pse Shqipëria ka përmirësuar legjislacionin e saj dhe shumica e tij është e përafruar me legjislacionin e BE-së, **sektori i menaxhimit të mbetjeve** mbetet një sfidë.

Problemet lidhen kryesisht me shtrirjen e pjesshme të mbulimit të shërbimeve, nivelin e pamjaftueshëm të grumbullimit dhe asgjësimit të mbetjeve, sasinë e kufizuar që depozitohet dhe trajtohet në venddepozitime, praninë e një numri të madh të venddepozitimeve (të lejuara dhe të paautorizuara), të cilat janë jashtë standardeve sanitare dhe inxhinierike, numri i kufizuar dhe cilësia e dobët e pajisjeve për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve, mungesa e ndarjes së mbetjeve në burim dhe përqindja e ulët e riciklimit, mungesa e infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Sipas të dhënave nga Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT)¹ për vitin 2019, **shërbimi ofrohet për 87,9% të popullsisë dhe aktualisht ka 4 venddepozitime sanitare operative:** Bushati në Bashkinë Vau i Dejës, Sharra në Bashkinë e Tiranës, Maliqi në Bashkinë Maliq dhe Bajkaj në Sarandë. Por, nuk ka venddepozitime për mbetje të rrezikshme dhe për mbetje inerte.

¹ INSTAT (2019) Mbetjet e Ngurta Urbane në Shqipëri. <http://www.instat.gov.al/media/7500/alb-mbetjet-e-ngurta-urbane-ne-shqiperi-2019.pdf>

Hierarkia e mbetjeve nuk zbatohet dhe bashkitë nuk kanë një sistem për mbledhjen e mbetjeve në 4 drejtime: letër/karton; metale; plastikë dhe qelq, siç parashikohet nga ligji.

Ministria e linjës ka miratuar së fundmi dy dokumentet kryesore të politikave “Dokumenti Strategjik i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar 2020-2035” dhe “Plani Sektorial Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”, i cili përcakton objektivat strategjike, synimet dhe përcakton infrastrukturën kryesore të nevojshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Konceptet e ekonomisë qarkulluese mbeten ende në nivel teorik dhe ka mbështetje në politikat strategjike të zhvillimit ekonomik të vendit. Ky koncept barazohet dhe reduktohet në riciklimin e mbetjeve, ndërkohë që koncepti duhet të bazohet te novacioni në projektim dhe ndërtim. Ekonomia qarkulluese kërkon një kuptim të ri organizimi dhe zhvillimi të kompanive dhe ndërmarrjeve shqiptare, të cilat duhen nxitur dhe stimuluar ekonomisht. Ndërkohë, njësitë e kërkimit shkencor apo ato të planifikimit duhet të ndërfutin ciklet e prodhimit në hapësirat rajonale.

Duhet ndërmarrë një qasje e integruar për të përmbushur kërkesat e BE-së me **angazhim aktiv dhe bashkëpunim** midis autoriteteve kombëtare dhe OJQ-ve, akademisë, kompanive të riciklimit, prodhuesve dhe shitësve me pakicë, në mënyrë që të merren në konsideratë nevojat dhe qëndrimet e **të gjitha palëve të interesuara në proces**.

Uji: Shqipëria ka burime relativisht të bollshme të ujërave të ëmbla. Shtatë lumenj kryesorë kalojnë nga lindja në perëndim të Shqipërisë. Kontributi i shkarkimit të lumenjve në detin Adriatik është shumë i madh (95%), krahasuar me shkarkimin në detin Jon (5%). Bregdeti mbështet ekosisteme unike dhe siguron burime jetësore dhe rrugët e lidhjes për vendin. Bregu shqiptar është i gjatë 450 km dhe është i njohur për shumë ekosisteme të rëndësishme në rajonin e Mesdheut si laguna, ligatina, duna me rërë, delta lumore dhe pyje.

Monitorimi i cilësisë së ujit, i ndërmarrë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit **nuk përfshin raportimin e ujit të pijshëm dhe të cilësisë së ujërave nëntokësore**. Cilësia e ujërave të larjes është raportuar pjesërisht me cilësi jo të kënaqshme dhe në disa raste duke u përkeqësuar me rreth 53% të stacioneve bregdetare të cilësisë së ujit të klasifikuar si të dobët, në raportin e vitit 2020 të Agjencisë Evropiane të Mjedisit.

Sektori i ujit mbetet një nga sektorët më të shpërndarë, sa u përket përgjegjësi të menaxhimit. Sektori i Ujësjetës-Kanalizimeve (UK) përballët me një numër problemesh, duke filluar me një **nivel të ulët të përafrimit me *acquis*** të BE-së mbi shërbimet e furnizimit me ujë dhe cilësinë e ujit, si dhe mbledhjen, trajtimin dhe asgjësimin e ujërave të ndotura sidomos në zonat urbane. Legjislacioni në lidhje me ujin e pijshëm, trajtimin e ujërave të ndotura urbane dhe direktivat e aktet nënligjore të ujërave nëntokësore në shumicën e rasteve është jo i plotë dhe në disa raste ende mungon.

Presionet kryesore që lidhen me ujërat shqiptare, përfshirë zonat detare, bregdetare dhe ato në brendësi të territorit, përcaktohen më poshtë.

Ndotja është problematike pasi disa lumenj derdhen në ujërat shqiptare, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e tyre. Burimet kryesore të ndotjes janë:

- **ndotja nga shkarkimi i ujërave të patrajtuar urbane dhe mbetjeve të ngurta;**
- **ndotja nga aktivitetet bujqësore;**
- **ndotja nga shkarkimi i materialeve të ngurta**, kryesisht nga minierat dhe ndërmarrjet e përpunimit – këto lidhen me mineralet e bakrit, kromit dhe hekur-nikelit.

Sipas kushteve lokale, ujërat nëntokësore shfrytëzohen shumë përmes puseve, kryesisht në fusha dhe lugina, ose përmes burimeve, më shpesh në kodra dhe në zonat malore.

Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi, konkurrenca për autoritet midis disa agjencive, **kapaciteti i kufizuar i vendimmarrjes dhe menaxhimi i dobët**, mbeten mbizotëruese midis këtyre organizatave që ndikojnë në aftësinë e sektorit **për të përmirësuar shërbimet në mënyrë efikase** dhe për të shkuar **në linjë me *acquis*** e Bashkimit Evropian.

Natyra: Shqipëria konsiderohet si një pikë e nxehtë e biodiversitetit në Evropë me 30% të florës evropiane. Sidoqoftë, një biodiversitet i tillë, i jashtëzakonshëm, dhe burimet e vlefshme natyrore po përballen me sfida. Si vendet e tjera në zhvillim, Shqipëria po përballët me një zhvillim të shpejtë. Rugë dhe infrastrukturë të reja, diga, hidrocentrale, rezervuarë naftë dhe infrastrukturë masive e turizmit kanë për qëllim të rrisin ekonominë e vendit, ndërsa paraqesin një kërcënim serioz për burimet e mjedisit.

Gjatë dekadave të fundit, Shqipëria ka bërë disa përparime drejt politikës për zhvillimin e mjedisit, duke përfshirë mbrojtjen e natyrës. Në janar të 2016-ës, vendi ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Biodiversitetit të përditësuar dhe një Plan Veprimi për periudhën 2015-2020, duke identifikuar qartë fushat kryesore të punës, përfshirë ndër të tjera:

- rritjen e mbulimit të Zonave të Mbrojtura deri në 20% në ZM tokësore dhe 10% në ZM detare dhe ujëra në zonat në brendësi të territorit;
- përfundimin e i kornizës ligjore në përputhje me *acquis* të BE-së për natyrën dhe mjedisin në përputhje me Direktivën e Zogjve dhe Habiteteve;
- forcimin e zbatimit të ligjit me anë të përmirësimit të legjislacionit dhe ndërtimit të kapaciteteve institucionale.

Zhvillimet më të fundit (dhjetor 2020) me vendimin e KKT-së e rrisin sipërfaqen e mbrojtur në 20%, **por ka një zhbalancim të sipërfaqes së mbrojtur detare me atë tokësore**, ku zona detare e vendit ka ende vetëm një Park Kombëtar, atë të Karaburunit. Gjithashtu, qeveria miratoi krijimin e **fondit të zonave të mbrojtura** (janar 2021), por **financimet dhe burimet njerëzore mbeten tejte të pamjaftueshme**.

Për më tepër, raporti i progresit i Komisionit Evropian vëren se **zbatimi i ligjeve duhet të garantohet në rast të krimeve mjedisore (për shembull, shpyllëzimet dhe prerjet e pyjeve)** dhe fajtorët duhet të ndiqen penalisht. Investimet në **hidrocentrale** duhet të jenë **në përputhje me detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së natyrës dhe administrimit të ujit**, të sigurojnë **pjesëmarrjen dhe konsultimin me publikun**, dhe të garantojnë **raporte të VNM-ve** me cilësi të lartë që përfshijnë vlerësime të ndikimit në natyrë dhe biodiversitet.

Demokracia mjedisore: Kuadri ligjor mjedisor e përmban përfshirjen e publikut si element përshkues në tërësinë e tematikave mjedisore të natyrës, ajrit, ujit, mbetjeve etj., për të siguruar zbatimin e ligjit dhe të politikave si pjesë të demokracisë funksionale, respektimin e të drejtave të njeriut dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Transpozimi i plotë dhe zbatimi i direktivave të legjislacionit horizontal do të forcojë një shoqëri demokratike në Shqipëri. Do të ngadalësojë shkatërrimin e burimeve natyrore, biodiversitetit dhe peizazhit natyror. Ai do të ndërtojë besim midis qytetarëve dhe institucioneve qeveritare, posaçërisht institucioneve ligjvënëse dhe të ato të zbatimit politikave dhe në të njëjtën kohë do të rrisë bashkëpunimin ndërinstitutional e do të përmirësojë transparencën. Do të sigurojë **progres në zhvillimin e vendit sipas përparësive kombëtare, duke përfshirë investimet dhe qëndrueshmërinë e tyre, si dhe do të mbështesë ekonominë lokale dhe të brishta**. Zbatimi i legjislacionit horizontal është një mekanizëm mbështetës edhe për reformën e decentralizimit në Shqipëri.

Ndryshimet klimatike dhe energjia

Z. Rodion Gjoka / Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Në Shqipëri, jemi në kontekstin kur bashkimi i disa sektorëve që lidhen drejtpërdrejt me energjinë, mjedisin dhe klimën, nën drejtimin e një ministrie pritej të sillte kohezion dhe qeverisje më efikase, siç është rasti për mjedisin dhe turizmin apo infrastrukturën dhe energjinë. Kështu, moratoriumi i gjuetisë, pyjeve apo karrierave lumore, si edhe lejet e ndryshme për ndërhyrje në zona të mbrojtura, nuk kanë sjellë promovim të turizmit apo shtim e fertilitet të habitateve. Kemi mjaftueshëm raste konkrete kur detyrimet e parashikuara nga paketa e legjislacionit mjedisor nëpërkëmben me lehtësinë më të madhe, si nga autoritetet publike, ashtu edhe ato private. Me sa duket, haraçi paguhet duke sakrifikuar masat mjedisore.

Nga ana tjetër, infrastruktura është ende e pazhvilluar. Pas 30 vitesh plane dhe projekte, në shumë zona vijojmë të shkarkojmë ujërat e ndotura dhe mbetjet në tokë, lumenj dhe delta.

Nga **Agjencia Evropiane e Mjedisit** jemi klasifikuar si **vendi i dytë në Evropë me ujëra bregdetare më të ndotura dhe i pari me ujërat sipërfaqësore më të ndotura për njësi territori. Jemi i vetmi vend në kontinent që prej 5 vitesh nuk monitoron dhe deklaron situatën mbi cilësinë e ajrit**. Gjithashtu, nga të vetmet vende të cilave u mungon statusi mbi shëndetin publik (higjiena, shëndeti mjedisor urban), e shumë të tjera si këto.

Nga ana tjetër, nga të gjitha vendet që lagen nga pellgu i Mesdheut, jemi në krye të listës sa i takon riskut me të cilin duhet të përballemi si pasojë e ndryshimeve klimatike. Kjo, jo për shkak se jemi kontribuues (jemi ndër kontribuuesit më të vegjël), por sepse përgjatë tri dekadave të fundit nuk kemi ditur të menaxhojmë dinamikat dhe burimet e territorit të vendit tonë në mënyrë të zgjuar për një të ardhme të qëndrueshme dhe për aftësi ripërtëritëse. Kemi një ultësirë që në 1/3 e saj është bonifikuar dhe që me këtë ndërhyrje njerëzore ul mundësinë për mbrojtje dhe aftësi zbutëse të efekteve. Ndërkohë, nuk është punuar në këto vite për të natyralizuar, mbrojtur apo rikrijuar pyje bregdetare, duna, laguna dhe toka të lagura. Përkundrazi, urbanizimi në ultësirën perëndimore dhe fragmentimi i tokës bujqësore dhe ekosistemeve natyrore ka dëmtuar më tej faktorët mbrojtës të territorit. Po ashtu, kemi ndërhyrje në regjimin e rrjedhave natyrore të ujit, duke ndërtuar HEC-e të vogla në çdo përrua e paralelisht me shpyllëzimin dhe marrjen e inerteve të shtratit lumor, dhe dëmtimin e biodiversitetit, kemi ulur ndjeshëm mundësitë e vendit për të përballuar krizat ujore, të thatësirës dhe ato energjetike, për një të ardhme fatkeqësisht të afërt.

Çdo stinë, territori ynë përballlet me përmytje, thatësira, mungesë produktiviteti etj., në mënyrë gjithmonë e më të shpeshtë, ndërkohë instrumentet që përdoren zakonisht janë shpallja e fatkeqësisë natyrore, gjendja e emergjencës, dislokimi i autoriteteve të

emergjencave civile e ushtrisë dhe buxhete të rishikuara. Megjithatë, efektiviteti i këtyre instrumenteve është i diskutueshëm, për të mos thënë i ulët, dhe nuk ndihmon në rritjen e aftësisë ripërtëritëse.

Ndërkohë, në nivel qyteti:

- Sipërfaqet e betonizuara vazhdojnë të shtohen në një kohë kur klima nuk e lejon një gjë të tillë. Kështu, përmythen Durrësi, Vlora, Tirana etj., sepse zona urbane është koracuar intensivisht.
- Përmythen Tirana, Lezha, Laçi etj., sepse infrastruktura përcjellëse e ujërave të larta nuk e përballon dot ngarkesën e shirave.
- Qytetet janë të pashëndetshme, për të mos thënë të pabanueshme, nën pushtetin e të nxehtit në verë, me temperatura të paktën dy gradë më lart se periferitë e tyre të afërta.
- Katër qytetet më të mëdha në Shqipëri janë në nivel konstant gjatë gjithë vitit, nën pushtetin e ajrit të ndotur kryesisht nga transporti, ndërtimi dhe përdorimi ose humbja e energjisë në banesa.

Zhvillimi ekonomik e sektorial në Shqipëri duhet të karakterizohet nga 2 qasje: të nxitë efikasitet të shërbimeve të ofruara dhe të nxitë parandalim të kostove më të mëdha në një moment të dytë. Deri më sot, asnjë politikë nuk ka aplikuar investime strategjike për popullatën, efektet e të cilave do të reduktonin barrën fiskale, shëndetësore apo sociale të saj pas 5-10 apo 15 vitesh.

Për shembull, një banor në qytetet kryesore shfrytëzon për ngrohje, ftohje e gatim dy herë më tepër nga sa i nevojitet. Ndërsa në zonën e tretë klimatike të Shqipërisë, banorët nuk përdorin energji elektrike për ngrohje. Janë afro 80 000 banorë që klasifikohen si të varfër për arsye energjetike. Nga ana tjetër, humbjet në rrjet janë 10 pikë përqindjeje më lart se rajoni i Ballkanit Perëndimor dhe 16 pikë përqindjeje më lart sesa mesatarja e BE-së.

Vijojmë të humbasim para publike nga paqëndrueshmëria e sektorit të energjisë. Shqipëria, edhe pse arrin të prodhojë në terma vjetorë 17% më tepër energji nga sa ka nevojë, në periudha të caktuara, nuk arrin të mbulojë kërkesat e brendshme për energji, ndaj detyrohet të dalë në tregjet rajonale për të blerë energji. Mbetet e paqartë arsyeja përse qeveritë dhe politikat e tyre zgjedhin të paguajnë vit pas viti gjenerues të energjisë elektrike nga rajoni, në një kohë që potenciali nga energjia diellore është me bollëk dhe për fat mund të na furnizojë pikërisht në atë periudhë kur HEC-et nuk kanë më rendiment.

1. Nevoja, argumente dhe propozime për ndryshim

Situata e mësipërme dikton në mënyrë të përmblëdhur këto argumente kryesore për ndryshim:

- Vonesa e pajustificuar dhe e gjatë e transpozimit ligjor, për secilën nga direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian, në lidhje me klimën dhe energjinë:
 - a. Klima: aktualisht kryer 40, ndërkohë zbatimi 38%;
 - b. Elektriciteti: aktualisht kryer 58%, ndërkohë zbatimi 42%;
 - c. Lëndët Djegëse (nafta): aktualisht kryer 60%, ndërkohë zbatimi 49%;
 - d. Burimet e Rinovueshme: aktualisht kryer 59%, ndërkohë zbatimi 55%;
 - e. Eficienca e Energjisë: aktualisht kryer 52%, ndërkohë zbatimi 31%;
 - f. Infrastruktura Energjetike: aktualisht kryer 28%, ndërkohë zbatimi 22%;
 - g. Paketa e kapitullit 27: Transpozimi 49% dhe Zbatimi 28%.
- Buxhetet për të financuar çështjet mjedisore në Shqipëri janë tejet të ulëta dhe çështjet mjedisore trajtohen si eksternalitete të politikave ekonomike, e jo si prioritetet e politikës dhe zhvillimit.
- Mjedisi trajtohet si një kontejner që grumbullon abuzime dhe mbetje nga veprimtaritë e institucioneve publike e private.
- Burimet natyrore janë vënë në mënyrë të njëanshme në funksion të energjisë dhe energjia në funksion të zhvillimit jo të qëndrueshëm.
- Është krijuar një model i paqëndrueshëm dhe me varësi energjetike nga uji dhe impakti i hidrocentraleve.
- Tregu dhe vendimmarrja në sektorin energjetik janë të centralizuara.
- Shqipëria është kontribuues i vogël në ndryshimet klimatike, por një nga shtetet me risk më të lartë ndaj impaktit prej fatkeqësive që do të shkaktojnë ndryshimet klimatike. Qasja në përdorimin e burimeve nuk merr në konsideratë analizat e riskut të fatkeqësisë.

- Ndotjet sektoriale janë të larta dhe po kështu është impakti në shëndetin publik, në shëndetin e zonave urbane dhe në shëndetin e ekosistemeve jetësore.

2. Propozime për ndryshim

Për të adresuar problematikën e mësipërme, nevojitet marrja urgjente e një sërë masave në nivel politikash apo ndërhyrjesh konkrete. Në mënyrë të përmblodhur, këto masa do të konsistojnë në:

- Duhet të kryhet reforma në sektorin energjetik, duke konsistuar në:
 - adresimin e Varfërisë Energjetike, përmes larmisë së burimeve dhe instrumenteve financiare për grupet përkatëse;
 - rinovimin e stokut të ndërtesave publike dhe banesave me parimin e eficiencës së energjisë;
 - hapjen e tregut energjetik dhe vendosjen e rregullave të reja që shfrytëzojnë potencialin energjetik të komuniteteve urbane.
- Duhet të diversifikohen burimet prodhuese energjetike dhe të fuqizohet e të përdoret potenciali i burimeve të rinovueshme, që janë të konsiderueshme në Shqipëri.
- Të studiohet dhe parashtrohet funksioni alternativ i hidrocentraleve të vogla.
- Të kryhet në mënyrë urgjente dekarbonizimi i sektorit energjetik, shërbimeve dhe banesave.
- Zhvillimi ekonomik sektorial duhet të realizohet nën parimin e koordinimit ndërsektorial për përdorimin e burimeve dhe të parandalimit, duke kryer analiza të riskut të shumëfishtë dhe duke marrë vendime që kanë në fokus aftësinë ripërtëritëse të burimeve dhe territorit.
- Të alokohen buxhete të qenësishme për adresimin e investimeve të nevojshme për masat në funksion të kapitullit 27 të *Acquis*.
- Vendimmarrjet politike dhe institucionale për çështjet e klimës në Shqipëri duhet të bëhen të hapura, me pjesëmarrjen e aktorëve të shoqërisë civile, transparente dhe të jenë konsensuale, pse jo duke përdorur edhe forma të tilla si referendumet.


Pyjet dhe kullotat

Dr. Abdulla Diku / organizata PSEDA-ILIRIA

1. Nevoja, argumente dhe propozime për ndryshim

Dekadat e fundit, fondi pyjor shqiptar është zvogëluar në mënyrë të ndjeshme. Nëse pakësimi i sipërfaqes pyjore në vitet e ekonomisë së centralizuar justifikohet me hapjen e tokave të bukës (rreth 300 000 ha pyje ose rreth 25% e sipërfaqes pyjore të vendit u shpyllëzuan në vitet '70-80), për tri dekadat e fundit, kur vendi u fut në rrugën e demokracisë, ky justifikim nuk qëndron më. **Pakësimi i fondit pyjor kombëtar ka ardhur për shkak të keqmenaxhimit të tij, korrupsionit, politikave të gabuara të ndjekura ndaj sektorit të pyjeve, politizimit të administratës, rekrutimit të njerëzve pa asnjë njohuri profesionale në fushën e pyjeve dhe, mbi të gjitha, për shkak të mungesës së vëmendjes së duhur që qeveritë kanë patur ndaj mjedisit në përgjithësi dhe pyjeve në veçanti.** Rritja vjetore natyrore e pyjeve tona llogaritet në rreth 1,4 milionë m³/vit. Ndërkaq, prerja e pyjeve e tejkalon rritjen me 2-2,5 herë, duke kapur shifrat 2,5-3 milion m³/vit¹. Nëse në vitin 2006, Shqipëria kishte një fond pyjor prej 81,05 milionë m³ lëndë drusore, në vitin 2019 kjo shifër ishte 54 847 milionë m³ lëndë drusore². Pra, vetëm 15 vitet e fundit, Shqipëria ka humbur rreth 26,2 milionë m³ lëndë drusore, e cila përbën një vlerë bruto prej rreth 1 miliard euro.

Figura 1. Volumi i fondit pyjor kombëtar, 2006-2019 (në 000 m³)



Burimi: INSTAT, 2021


¹ World Bank, UDA, 2018 "Albania fuel wood demand assessment and analysis- Final report"

² INSTAT, 2021

E gjitha kjo nuk është vetëm humbje financiare. Humbjet dhe pasojat në ekosistem janë shumë herë më të mëdha. Në pyjet tona, kullot thuhet e gjithë gama e llojeve të blegtorisë që kemi, por kryesisht të imtat (rreth 1 milion krerë dhi/vit), gjë e cila nuk llogaritet askund si e mirë publike që ofron ky sektor.

Një dëmtim masiv i pyjeve ka ardhur nga zjarret e fuqishme, të cilat kanë djegur sipërfaqe të konsiderueshme pyjore. **Kështu, gjatë periudhës 2007-2019 janë djegur më shumë se 1/3 e sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar, ose rreth 337 800 ha³.**

Figura 2. Sipërfaqja e djegur nga zjarret në pyje, 2007-2019 (në ha)



Burimi: EFFIS, Copernicus Emergency Management Service, 2020

Një tjetër problem në pyje mbetet shkalla e lartë e informalitetit në përdorimin e prodhimeve pyjore. Rezulton se për rreth 90% të produkteve që merren nga pyjet, nuk paguhet. Politikat energjetike gjithashtu janë jofavorizuese ndaj pyjeve. Përdorimi i druve të zjarrit rezulton të jetë rreth 3-4 herë më i leverdishëm se burimet e tjera (energji elektrike, gaz, karburante). Kjo ka bërë që pyjet të shihen si mundësia më e mirë për ngrohje e gatim për shumë familje, duke kontribuar kështu në rrënimin e fondit pyjor. Po ashtu, **llogaritet se eficienta e përdorimit të biomasës pyjore të jetë shumë e ulët**, vetëm 40% (më e ulëta në Evropë).

³ JRC, EC, 2020: "Forest Fires in Europe, Middle East and North Africa"; European Commission, EFFIS https://effis-gwis-cms.s3-eu-west-1.amazonaws.com/effis/reports-and-publications/annual-fire-reports/2019_Fire_Report_HighRes_final_PTcorrection/Annual_Report_2019_final_topdf_2.pdf

Pikërisht për shkak të këtyre situatave të lartpërmendura, pyjet në Shqipëri, ndryshe nga çdo vend i BE-së apo nga shumica e vendeve të botës, rezultojnë çliruese të gazeve serrë (GS) me rreth 2 milionë tonë CO₂/vit ose rreth 25% të totalit të emetimeve të GS që çliron Shqipëria. Për shkak të ngrohjes globale, janë shfaqur **dëmtues e sëmundje** të cilat nuk njiheshin më parë, apo nuk kishin përhapje të tillë, e që po dëmtojnë masivisht pyjet tona, të tilla si: Flutura e Bushit, Grenxa aziatike e Gështenjës, Proçesionarja e pishës, Kanceri i rrapit etj.

Nga ana tjetër, përmbytjet që ndodhin në vend, kanë si shkak kryesor pikërisht shpyllëzimet masive që kanë ndodhur. Qeveritë, në vend që të punojnë për minimizimin e shkaqeve të përmbytjeve, merren me luftimin e pasojave nga ato, duke shumëfishuar kostot e menaxhimit të tyre dhe duke i kthyer në barrë të papërbalueshme financiare për vendin.

Prej dekadash tashmë nuk ndërmerret **asnjë masë kundër erozionit**, duke i lënë rrugë të lirë degradimit të tokës. Kujtojmë që për krijimin e 1 cm toke, natyrës i duhen 350-600 vjet, ndërsa erozioni e shkatërron atë për 5-10 minuta.

Administratat pyjore përbëhen nga **stafe joprofesionale** e militantë politikë, duke përkeqësuar tej mase cilësinë e trupës menaxhuese të pyjeve në vend. Këtij problemi i shtohet edhe fakti që bashkitë as kanë patur, e as do të kenë ndonjëherë kapacitete për menaxhimin e pyjeve. Edhe mënyra aktuale e organizimit të inspektimit veçse e ka përkeqësuar më tej situatën në pyje, duke u bërë pengesë dhe jo zgjidhje e problemeve. Investimet e kufizuara si në sasi monetare, ashtu dhe në sipërfaqe, kanë bërë që efektet e deritanishme të tyre të jenë tërësisht të padukshme dhe joefektive. Megjithatë vendi është përpjekur dhe përpiket të promovojë turizmin natyror, pyjet mbi të cilat ky turizëm zhvillohet kudo nëpër botë, vazhdojnë të dëmtohen masivisht, për shkak të neglizhencës së theksuar politike dhe mungesës së burimeve për menaxhimin e qëndrueshëm të tyre.

2. Propozime për ndryshim

Dalja nga situata e vështirë ku gjenden pyjet kërkon një qasje shumëdimensionale, kohë dhe burime në dispozicion. Mbi të gjitha, kërkohet që pyjet të menaxhohen bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm të tyre. Disa nga rekomandimet përfshijnë:

1. Masa të karakterit politik

- a. Menaxhimi i centralizuar i pyjeve, si në shumicën absolute të vendeve të botës, ndryshe nga sa po bëhet aktualisht në Shqipëri, ku menaxhimi i pyjeve bëhet nga bashkitë.

- b. Krijimi i një trupe të vetme pyjore, që të merret me menaxhimin dhe inspektimin.
- c. Përfshirja në administratën pyjore të specialistëve të pyjeve.
- d. Formalizimi i çdo lloj aktiviteti në fondin pyjor (kullotja, bimët mjekësore, shërbimet në ekosistem, prodhimet drusore etj.).
- e. Përmirësimi i politikave energjetike, në mënyrë që të ulët presioni mbi pyjet.
- f. Aplikimi i rregulloreve FLEGT dhe EUTR, si instrumente të rëndësishme për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.

2. Masa të karakterit teknik

- a. Aktivitete masive restauruese në fondin pyjor, duke u bazuar në nivel baseni, dhe jo projekte të vogla, të copëzuara e pa asnjë efekt.
- b. Ndryshimi i kursit të kontributit të pyjeve në drejtim të përthithjes së gazeve serrë, duke i kthyer pyjet nga çlirues të këtyre gazeve, në përthithës të tyre. Kjo nismë kërkon pyllëzimin e së paku 5000 ha në vit, për një periudhë prej 50 vitesh. Ndryshe nga praktikat e deritanishme, duhen mbështetur inovacionet në këtë fushë (mbjelljet me drone, mbjellje me kosto të lirë, si p.sh. me farë etj.).
- c. Aplikimi i silvikulturës moderne për përmirësimin e sipërfaqeve pyjore.
- d. Menaxhim mbi baza shkencore i sëmundjeve dhe dëmtuesve në pyje.
- e. Përmirësimi i menaxhimit të mbrojtjes pyjeve dhe kullotave nga zjarret.
- f. Krijimi dhe funksionimi i një kadastrë kombëtare funksionale për pyjet, në mënyrë që të dihet me saktësi çdo detaj lidhur me pyjet.
- g. Përmirësimi i eficiencës energjetike të përdorimit të biomasës pyjore, duke futur pajisje eficiente (si p.sh. soba), në mënyrë që të ulët sasia e pyjeve që priten.
- h. Maksimizimi i përdorimit të biomasës pyjore (duke përmirësuar teknologjitë e shfrytëzimit, trajtimit dhe përpunimit).
- i. Ndalimi i eksportit të produkteve dhe nënprodukteve drusore dhe lehtësimi i procedurave të importimit të tyre.

j. Masa në nivel kombëtar për luftimin e erozionit (masa bio-inxhinierike).

k. Ndalimi i djegies së kullotave dhe tokave, si praktikë e gabuar jo vetëm në aspektin mjedisor.

Për ta përmbyllur, dua të citoj fjalët e prof. McPherson nga Universiteti i Arizonës: **“Nëse mendoni se ekonomia është më e rëndësishme se mjedisi, provoni të mbani frymën ndërsa numëroni paratë tuaja”**.⁴

⁴ If you think the economy is more important than the environment, try holding your breath while counting your money. Guy McPherson, Shkolla e Burimeve Natyrore, Universiteti i Arizonës. Shkëputur nga postimi në blog “Time for a revolution”, 29 maj 2009.



QEVERISJE PËR NDRYSHIM

SHËNDETI,
TË DREJTAT
E NJERIUT,
ARTI DHE
KULTURA



TOGETHER
FOR LIFE



U.M.S.H.



AFI



SHKËMBIM

SHËNDETI, TË DREJTAT E NJERIUT, ARTI DHE KULTURA

Shëndeti dhe siguria ushqimore

Sistemi shëndetësor në Shqipëri, sfidat dhe problematikat në 30 vite demokraci

Znj. Eglantina Bardhi / Together for Life

Të gjithë pacientët (rreth 420 000 pacientë kronikë) në Shqipëri dhe familjarët e tyre. Shoqata "Together for life" ka 11 vite që është krijuar dhe është shoqata lider sa i takon mbrojtjes së të drejtave të pacientëve, nxitjes së llogaridhënies dhe transparencës në shëndetësi.

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Sektori i shëndetësisë është i financuar me rreth 3% të GDP-së, shumë pak me nivelin evropian, 7%; me GDP-në më të ulët në rajon për shëndetësinë: Maqedonia e ka 4,1%, Greqia 5,2, Serbia 5,4.

- Sektori i Shëndetësisë në Shqipëri mbetet ndër më problematikët, sa i takon korrupsionit. I renditur si i dyti më i korruptuari pas sistemit të Drejtësisë (burimet DASH, BB). Korrupsioni fillon nga nivelet e larta qeverisëse deri te nivelet më të ulëta, siç janë shefat e shërbimeve apo edhe mjekët. PPP-të në shëndetësi janë ndër faktorët kryesorë të korrupsionit dhe mungesës së transparencës në këtë sektor.

Raporti i INSTAT-it tregonte se sistemi shëndetësor është ai që tërheq më shumë rryshfet. Statistikat janë të frikshme, 71% të qytetarëve paguajnë mjekun për një shërbim që është falas.

- Konflikti i interesit të mjekëve, sidomos të shefave të shërbimeve, është një problem madhor i sistemit shëndetësor, pasi ky fenomen bie në kurriz të pacientit, i cili shpesh është subjekt abuzimi. E vetmja reformë e cila nisi për të luftuar konfliktin e interesit të shefave të shërbimit në 2005-ën, u shua shpejt brenda 3 muajve, për shkak të influencës që kanë shefat e shërbimeve.
- Mungesa e mjekëve specialistë është një tjetër problem madhor në sistemin e shëndetësisë. Spitalet rajonale dhe bashkiake nuk kanë mjekë specialistë, duke u mohuar shërbimin shëndetësor. Të dhënat tregojnë se numri i mjekëve që kërkojnë certifikatë për t'u larguar jashtë Shqipërisë çdo vit, është njësoj (ose më i madh) sa numri i mjekëve që nxjerr çdo vit nga bankat e shkollës Universiteti i Mjekësisë (1503). Si rrjedhojë e migrimit masiv dhe faktorëve të tjerë, Shqipëria ka normën më të ulët të mjekëve për mbulimin e kujdesit shëndetësor për popullsinë, me 1,2 mjekë për 1000 banorë. Ndërkohë, shoqatat e pacienteve janë shumë të dobëta ose nuk ekzistojnë fare. Shoqatat e pacientëve, si: Shoqata e Personave me Virusin HIV/AIDS, Shoqata e Diabetikëve, Shoqata e Personave me Hemofili, Shoqata e Personave me

Talasemi etj., përveçse janë shumë të dobëta në raportimin e problemeve që kanë pacientët që përfaqësojnë, edhe **nuk njihen** nga publiku.

- Ndërkohë, mediat nuk kanë qenë aktive sa duhet në investigimet rreth korrupsionit në shëndetësi, shkeljes së të drejtave të pacientëve.

Rekomandohet lufta kundra korrupsionit në sistemin shëndetësor, duke filluar nga nivelet më të larta të drejtuesve të shëndetësisë, të cilët kanë në dorë tenderët dhe PPP-të miliona euro në vit. SPAK-u duhet të fillojë hetimet nga koka e drejtuesve, duke u ulur në nivele të tjera, si shefat e shërbimeve.

PPP-të në shëndetësi duhet të jenë të kontrolluara dhe të këtë studime mirëfilli vizibiliteti se ku duhet të përqendrohet prioriteti i këtyre koncesioneve.

Sektori publik duhet të jetë kryesori në dhënien e shërbimit shëndetësor, ndërsa privati duhet të jetë komplementar.

Të luftohet në mënyrë emergjente konflikti i interesit, sidomos i shefave të shërbimeve, të cilët janë urë lidhëse mes publikut dhe privatit. Një shef shërbimi duhet të zgjedhë nëse duhet të shërbejë në publik apo në privat.

Të forcohet roli i shoqërisë civile dhe të forcohen shoqatat e pacienteve si një mekanizëm për të nxitur llogaridhënien ndaj qeverisë për sektorin.

Mediat nuk kanë qenë aktive sa duhet në investigimet rreth korrupsionit në shëndetësi dhe shkeljes së të drejtave të pacientëve. Si rrjedhojë, është e domosdoshme përfshirja e gazetarëve në raportimet e abuzimeve në sektorin e shëndetësisë.

Ne synojmë të vendosim një urë lidhëse mes shoqatave të pacientëve dhe gazetarëve që mbulojnë çështjet e shëndetësisë, dhe nxitjen e tyre në raportim dhe investigim në këtë sektor.

Studimi i perceptimeve mbi cilësinë e medikamenteve për sëmundjet kronike në sistemin shëndetësor në Shqipëri <https://togetherforlife.org.al/wp-content/uploads/2021/02/Studimi-i-perceptimeve-mbi-cil%C3%ABsin%C3%AB-e-medikamenteve-p%C3%ABr-s%C3%ABmundjet-kronike-n%C3%AB-sistemin-sh%C3%ABndet%C3%ABsor-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri.pdf> Ndikimi i COVID-19 te personat me aftësi të kufizuara <https://togetherforlife.org.al/wp-content/uploads/2021/01/Ndikimi-i-COVID-19-tek-personat-me-aft%C3%ABsi-t%C3%AB-kufizuar.pdf>

Qershor 2020 - Sistemi shëndetësor gjatë pandemisë COVID-19 dhe pajisja e stafit me materialet e mbrojtjes personale <https://togetherforlife.org.al/wp-content/uploads/2020/07/Sistemi-sh%C3%ABndet%C3%ABsor-gjat%C3%AB-pandemis%C3%AB-COVID-19-dhe-pajisja-e-stafit-me-materialet-e-mbrojtjes-personale.pdf>

Dhjetor 2019 - Health Sector in Albania Public-Private Partnerships <https://togetherforlife.org.al/wp-content/uploads/2020/05/HEALTH-SECTOR-IN-ALBANIA-PUBLIC-PRIVATE-PARTNERSHIPS.pdf> Prill 2019 –Monitorimi i listës së barnave esenciale <https://togetherforlife.org.al/wp-content/uploads/2019/04/Monitorimi-i-List%C3%ABs-s%C3%AB-Barnave-Esenciale.pdf> Tetor 2018 – Largimi i mjekëve nga Shqipëria <https://togetherforlife.org.al/wp-content/uploads/2018/12/Largimi-i-mjekeve-nga-Shqiperia.pdf>

Tetor 2018 - Raport vjetor mbi denoncimet e ardhura për sistemin shëndetësor në portalet shëndetësore të TFL-së <https://togetherforlife.org.al/wp-content/uploads/2018/10/Raport-vjetor-mbi-denoncimet-e-ardhura-p%C3%ABr-sistemin-sh%C3%ABndet%C3%ABsor-n%C3%AB-portalet-sh%C3%ABndet%C3%ABsore-t%C3%AB-TFL.pdf>

Dhjetor 2017 - Raport mbi prokurimin dhe buxhetimin e barnave në sektorin e shëndetësisë <https://togetherforlife.org.al/wp-content/uploads/2017/12/Raport-mbi-Prokurimin-dhe-Buxhetimin-e-Barnave-n%C3%AB-Sektorin-e-Sh%C3%ABndet%C3%ABsis%C3%AB.pdf>

Sistemi shëndetësor

Dr. Fatmir Brahimaj / Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë
Këshilli Kombëtar

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë, Këshilli Kombëtar, ka identifikuar disa nevoja dhe parashton, më poshtë, disa sugjerime ndaj klasës politike për programet që paraqiten në fushatat zgjedhore.

1. Mbrojtja e **shëndetit është një çështje mjaft e ndjeshme për publikun**. Ky fakt është shfrytëzuar gjithnjë nga klasa politike për të bërë premtime të bujshme dhe shpesh të parealizueshme, kur vijnë në pushtet. Fatkeqësisht, një pjesë e publikut mendon se ato do të realizohen qysh ditët e para pas zgjedhjeve, për këtë arsye i kërkon menjëherë, duke debatuar me personelin shëndetësor. Kjo gjë, veç të tjerave, thellon krizën e besimit midis publikut dhe bluzave të bardha dhe shton konfliktin midis tyre.

Sugjerim: Në programet zgjedhore, të ketë premtime reale të bazuara në mundësitë tona financiare, si dhe me afate të qarta për realizimin e tyre.

2. Gjatë tri dekadave është folur dhe punuar vazhdimisht për reforma të thella në shërbimin shëndetësor dhe për strategji kombëtare për përmirësimin cilësor të tij. Por, gjatë hartimit të tyre, raportet politikan-teknicien nuk janë të duhurat.

Sugjerim: Politika duhet ta marrë më shumë në konsideratë mendimin teknik.

3. Gjatë zbatimit të reformave dhe strategjive, shihet një raport jo i mirë midis militantëve dhe profesionistëve. Jo rrallë shihet të drejtojnë militantët me profil të ulët profesional, si mjekësor, ashtu edhe menaxherial.

Sugjerim: Përmirësim të raporteve politikan-teknicien dhe militant-profesionist. Të ketë realisht kritere që të vlerësojnë mendimin teknik dhe profesionistët në menaxhimin dhe drejtimin e shërbimit shëndetësor. Kjo do të përmirësojë cilësinë e shërbimit shëndetësor, si edhe ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve profesionale në ofrimin e tij.

4. Migrimi i mjekëve dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë, edhe pse një tendencë e kohës në shumë vende evropiane, duhet marrë fort në konsideratë nga politika. Mendojmë se sa më shumë të përmirësohet klima për t'i mbajtur të lidhur me vendin tonë, aq më shumë do të zbutet migrimi.

Sugjerim:

- ***Zbutja dhe më tej zgjidhja e krizës së besimit midis bluzave të bardha dhe publikut.***
- ***Të rritet më shumë vlerësimi moral dhe material.***
- ***Të përmirësohet vazhdimisht ngarkesa në punë, mbrojtja ligjore, siguria në vendin e punës, të futen siguracionet profesionale etj.***

5. Rritja e vazhdueshme e financimit të shërbimit shëndetësor.

- E menjëhershme: **të rritet përqindja e buxhetit shëndetësor.**
- Meqenëse çdo ambient jetësor është një ambient shëndetësor, sugjerohet **rritja e financimeve për sektorë të tjerë, të lidhur me mbrojtjen e shëndetit** (si transporti dhe siguria rrugore, mjediset e punës dhe të banimit, shërbimet e ushqimit social dhe siguria ushqimore etj.) do të ndikonte pozitivisht në financimin e kujdesit shëndetësor.

Siguria ushqimore si instrument për rritje të shpejtë ekonomike dhe punësim të profesionistëve

Z. Alban Zusi / Industria Ushqimore Shqiptare

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Siguria ushqimore është **detyrim social dhe kushtetues i çdo qeverie për shëndetin publik dhe sigurinë kombëtare**. Aktualisht, në Shqipëri vërehen disa problematika thelbësore dhe urgjente në lidhje me sigurinë ushqimore, si në vijim:

- **Mungesa e sigurisë ushqimore:**

1. është pengesa e vetme për dyfishimin e eksporteve të produkteve ushqimore shqiptare; aktualisht, 60% e prodhimit të përgjithshëm bujqësor është i paeksportueshëm;
2. është faktori kryesor i moskonsumimit të produkteve shqiptare nga shtresa e mesme dhe me të ardhura të larta e shoqërisë;
3. frenon uljen e afro 300 milionë eurove importe ushqimore.

- **Nënvlerësimi** i sigurisë ushqimore është faktori kryesor i papunësisë së profesionistëve të diplomuar në këtë sektor, me potencialisht 10 000 të rinj të diplomuar.

- Mungesa e sigurisë ushqimore dhe **Tregu pa Standarde** janë faktori kryesor i investimeve të kufizuara vendase e të huaja. Po ashtu, të dyja këto probleme kanë sjellë thithje të ulët të donacioneve apo kreditimit nga bankat, prej më pak se 2% të portofolit të tyre të kredisë.


2. Propozime për ndryshim

Për të adresuar shqetësimet themelore si më sipër, qeveria e Shqipërisë duhet të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- realizimin e një **Reforme Integrale** të Sistemit të Sigurisë Ushqimore¹ (fig. 1);
- krijimin e **enteve private** me funksione publike, si hallkë e ndërmjetme mes biznesit/ fermerëve dhe autoritetit publik;
- krijimin e një **baze të dhënash** shtetërore të unifikuar për menaxhimin e sistemit nga prodhimi primar deri në treg;
- angazhimin e një **trupe audituese ndërkombëtare** për vlerësimin e performancës së sistemit dhe të reformës;
- **ndërthurjen** e reformës integrale të sigurisë ushqimore me masat ekonomike dhe fiskale për **formalizim të ekonomisë**.

⁴ Kjo reformë dhe sistemi i propozuar u janë prezantuar ministrit të Bujqësisë në detyrë, në korrik 2015.

Fig. 1. Paraqitje skematike e funksionimit të Sigurisë Ushqimore, sipas reformës së propozuar



Sfidat për mbrojtjen e konsumatorit dhe kapitujt 12, 28

Granit Sokolaj / Qendra ALERT

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Siguria ushqimore është ende larg nevojave dhe garancisë ndaj konsumatorit vendas në të gjithë zinxhirin e saj, por edhe në raport me kushtet e vendosura nga Bashkimi Evropian (BE), sa i përket kapitullit 12.

Hartimi i përvitshëm i Vlerësimit të Riskut dhe si pasojë, edhe komunikimi e menaxhimi i tij, nuk janë në nivelet që kërkon siguria ushqimore e konsumatorit.

Shtimi i numrit të inspektimeve, rritjes së cilësisë së tyre, si dhe i ngritjes së kapaciteteve laboratorike, është një nevojë e domosdoshme, që kërkon ndërhyrje emergjente. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (**AKU**) ka në funksion **9 laboratorë rajonalë**, për të cilët BE-ja ka investuar të paktën 2.2 milionë euro, të cilët **nuk janë në gjendje të kryejnë as analizat më minimale** të produkteve ushqimore.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (**ISUV**), i vetmi laborator referencë, rezulton të ketë **probleme në kryerjen e proceseve laboratorike**, për shkak të situatave burokratike, mungesë reagentësh e kitesh. Edhe në rastin më të mirë, **kryhen vetëm analizat e planeve vjetore kombëtare** të AKU-së dhe të ISUV-së, referuar urdhrit të ministrit të Bujqësisë, nr. 524, datë 23.09.2019.

Pikat e Inspektimit Kufitar (**PIK**), pjesë e AKU-së, janë hallka e parë dhe kryesore për kontrollin e sigurisë së produkteve ushqimore, e ushqimit për kafshë, produkteve të mbrojtjes së bimëve apo medikamenteve bujqësore dhe blegtorale. Për shkak të mungesës, në shumë raste të profesionalizmit, numrit të vogël të inspektorëve, rasteve të dyshimta për afera, mungesës së laboratorëve në këto PIK-e, apo edhe të mungesës së stafeve me ekspertë të fushave respektive, **këto “porta” rrezikojnë sigurinë ushqimore të konsumatorëve**.

Ndërkaq, konsumatori has probleme nga më të ndryshmet dhe është i pambrojtur edhe për sa u përket **problematikave të tjera që nuk lidhen me ushqimin**, siç janë:

- kreditë konsumatore dhe marketingu në distancë;
- produktet joushqimore, si lodrat dhe produktet e tjera;
- diskriminimi i kategorive të veçanta;
- mungesa e shërbimeve shëndetësore dhe aksesit në shëndetësi i grupeve në nevojë, si pakicat romë dhe egjiptiane, popullsia në zonat e thella rurale, apo personat me aftësi të kufizuara.

2. Propozime për ndryshim

Për të përmirësuar gjendjen e sigurisë së konsumatorit, propozohet:

- **Hartimi i politikave kombëtare** për mbrojtjen e konsumatorit dhe plotësimi i kërkesave të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen e Konsumatorit 2014-2020.
- **Përafrimi i legjislacionit** shqiptar në raport me sigurinë ushqimore me *acquis* të BE-së, siç janë **ligji nr. 9563 “Për Ushqimin”, apo ligji “Për Shërbimin Veterinar”**.
- **Hartimi i një politike kombëtare të konsoliduar**, siç e kërkon edhe BE-ja, për rritjen e kapaciteteve inspektuese, kontrollet zyrtare, shëndetin e kafshëve dhe shpendëve, mbrojtjen e bimëve dhe të sigurisë ushqimore.
- **Hartimi i përvitshëm i strategjive të mirëfillta të menaxhimit dhe komunikimit të riskut**, mbi bazën e vlerësimit real të situatës nga ekspertë, profesorë, kërkues shkencorë dhe universitetet. Komunikimi i riskut të jetë pikë kyçe e sektorëve në institucionet shtetërore, si AKU apo ISHMT.
- **Të hartohet një metodologji e re e bazuar në risk për planifikimin e kontrolleve** zyrtare të sigurisë ushqimore dhe të zbatohen kontrollet zyrtare në përputhje me planet vjetore të inspektimit.
- Institucioni ligjzbatues, **AKU-ja, të ristrukturohet** dhe në brendësi të saj të krijohet **një drejtori për kërkimin shkencor**, si dhe të funksionojnë **panelet shkencore dhe bordet**.
- **Ndërgjegjësimi i konsumatorit** të jetë prioritet i institucioneve për produktet ushqimore dhe joushqimore.
- **Informim i konsumatorit** me anë të njoftimeve (*stickers*) për markete, tregje që nuk ofrojnë sigurinë e duhur, sipas standardeve shqiptare apo ndërkombëtare.
- **Plotësim i menjëhershëm i ligjeve me akte nënligjore**, për funksionimin dhe zbatimin më të lehtë të tyre, siç është ligji **“Për Shërbimin Veterinar”**, ligji për **“Sektorin e Energjisë Elektrike”**, ku në nenet 95 dhe 96 përcaktohet se si kategoritë në nevojë mund të përfitojnë energji elektrike, si e drejtë themelore.



Të Drejtat e Njeriut, rinia, arti dhe kultura

Për një respektim më të mirë të të drejtave dhe interesave të fermerëve shqiptarë

Znj. Erida Skendaj / Komiteti shqiptar i Helsinkit

Rasti nr. 1: Mbështetje për fermerët shqiptarë

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Fermerët në vendin tonë po përballen me probleme të ndryshme ekonomike dhe fiskale, çka afekton në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat e tyre me natyrë sociale-ekonomike.

Së pari, **skema e kompensimit për disa kategori të fermerëve**, e parashikuar në ligjin “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, në nenet 146, 147, 148 dhe 149, nuk po i shërben qëllimit për të cilin është krijuar. Në këtë ligj është parashikuar që norma e kompensimit të prodhuesve bujqësor është 6%. **Kjo skemë nuk po e realizon realisht kompensimin e fermerëve**, por thjesht po mundëson që blerësi të llogarisë TVSH-në në blerje për produktet që blen te fermeri. Gjithashtu, kjo skemë po falimenton tregtarët vendas dhe po zvogëlon edhe numrin e eksporteve.

Së dyti, fermerët janë të **pambrojtur përpara fatkeqësive natyrore**. Agjencitë e sigurimit në vendin tonë nuk preferojnë t’i sigurojnë fermerët, për shkak të riskut shumë të lartë që ka veprimtaria e tyre.

Së treti, fermerët shqiptarë **janë të pambrojtur në treg, në aspektin e likuidimit të faturave** të tyre nga grumbulluesit. Në raste të pamundësisë së likuidimit, nuk ka siguri që faturat e tyre do të mund të likuidohen nga fonde të mundshme garancie.

Së katërti, tregjet ku tregtohen prodhimet bujqësore vendase janë të pakontrolluara për sa i përket cilësisë së produkteve, duke lënë shkas për abuzime nga fermerë të caktuar. Më pas, kjo situatë reflektohet edhe në ulje të besueshmërisë të qytetarët për produktet vendase.

2. Propozime për ndryshim

Lidhur me problematikat e lartpërmendura, mund të ndërhyhet me **disa shtesa dhe ndryshime** në Ligjin nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, dhe në Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”.

Fillimisht, **duke ndryshuar skemën e kompensimit për fermerët**, që është parashikuar në ligjin për TVSH-në, dhe duke hartuar dispozita të reja që parashikojnë që një kategori të caktuar të fermerëve, që kanë nevojë për mbështetje, **do t’i sigurohet jo më kompensim në masën 6%, por subvencionim direkt nga ana e shtetit**.

Për sa i përket Ligjit “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, duhet të hartohen dispozita të reja ligjore, të cilat **do të parashikojnë një vlerësim dhe kompensim financiar me çmim dysHEME të tregut për produktet e humbura nga fatkeqësitë natyrore** dhe stokun e produktit të shkakuar nga çrregullime të forta të tregut. Gjithashtu, të parashikohet një fond garancie, i cili **garanton likuidimin e faturave të fermerëve** brenda një afati 45-ditor, të përcaktuar në ligj.

Po ashtu, në këtë ligj duhet të hartohen dispozita që parashikojnë **krijimin e një agjencie që do të merret me studimin e tregjeve të produkteve të fermerëve vendas**. Kjo agjenci duhet të kryejë analiza të tokës, të garantojë dhe të monitorojë cilësinë e inputeve bujqësore, dhe rrjedhimisht do të kontrollojë dhe do të monitorojë cilësinë e produkteve bujqësore. Ky lloj shërbimi do të ndihmonte eksportuesit dhe fermerët për të qenë më të orientuar drejt kulturës, varietetit etj., gjithashtu do të luftonte konkurrencën e pandershme në treg.

Rasti nr. 2: Metoda alternative “IN VITRO” e garantuar nga shteti

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Kuadri ligjor në vendin tonë **nuk e garanton në mënyrë të qartë** stimulimin e rritjeve në numrin e lindjeve falas, nëpërmjet metodës alternative **in vitro për familjet që nuk kanë të ardhura të mjaftueshme ekonomike** për ta përballuar në institucionet private. Kjo çështje ndikon drejtpërsëdrejti tek e drejta për një jetë familjare dhe private e qetë, e sanksionuar në nenin 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e parë në raport edhe me të drejtat me natyrë sociale-ekonomike. Duke parë nën këndvështrim krahasues me vendet e tjera evropiane, të cilat kanë miratuar politika fikse për ofrimin e fertilizimit in vitro falas, si një formë e rëndësisë strategjike për luftën ndaj plakjes së popullsisë, vërehet se Shqipëria nuk i ka ofruar rëndësi kësaj tematike. Ndër praktikatat pozitive përmendet Hungaria, e cila në shkurt 2020 ka nisur ofrimin e trajtimit IVF falas në 6 prej klinikave publike, në pronësi të qeverisë. Në saj të këtyre programeve, Hungaria ofron medikamentet e përdorshme në fertilizimin in vitro falas, ndërkohë që është shmangur në mënyrë absolute lista e pritjes. Vendet pjesë e SHBA-së kanë njohur praktika të ndryshme të ofrimit të subvencionit ndaj familjeve në pamundësi për të lindur në mënyrë natyrale. Spanja, nga ana tjetër, e mundëson mbulimin e të gjitha shpenzimeve për ofrimin e kësaj metode, por pas përmbushjes së disa kushteve specifike, të cilat lidhen me moshën, gjendjen shëndetësore etj.

Nga të dhënat e ofruara nga grupet e interesit, Komiteti shqiptar i Helsinkit u informua se vetëm analiza për përzgjedhjen gjenetike ka një kosto prej 5000 eurosh, ndërkohë që realizimi i trajtimit duke përfshirë injeksione dhe medikamente të ndryshme, **mund të arrijë deri në 2500 eurosh**.

Duke hedhur vështrimin në vendin tonë, **rezulton se viti 2012 ka qenë viti i parë dhe i fundit kur media ka trajtuar një tematikë të tillë**. Në këtë vit, rezulton se në maternitetin “Koço Gliozheni” kishte filluar të zbatohet një projekt i financuar nga BE-ja, lidhur me mundësimin e pajisjeve të nevojshme për të ofruar fekondimin in vitro në këtë institucion shtetëror⁴. Shifrat e larta financiare me anë të të cilave duhet të mbulohet një trajtim i tillë, **vakumi ligjor** që nuk parashikon mundësinë e ofrimit të trajtimit ose të medikamenteve konkrete falas të mbuluara nga skema e sigurimeve shëndetësore për shtetasit me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme, në kushte të rënda ekonomike, si dhe **trajtimi jo i barabartë në raport me vendet e tjera** evropiane dhe ato të rajonit, i ka vendosur këto familje në kushte të papërshtatshme.

2. Propozime për ndryshim

Me synim advokimin për ofrimin e një zgjidhjeje të përshtatshme për këta shtetas, sugjerohet **amendimi i kuadrit ligjor në fuqi**, konkretisht Ligjit nr. 56/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8876/2002 Për shëndetin riprodhues”, duke përcaktuar në mënyrë të qartë mbulimin **e të gjithë ose një pjese të shpenzimeve për realizimin e këtij trajtimi** për shtetasit/familjet **që provojnë pamundësinë ekonomike**.

Terminologjia “**të përballueshme**” duhet të përkufizohet në mënyrë të qartë n.q.s. nënkupton gjendjen ekonomike apo shëndetësore. Në momentin e përcaktimit të mbulimit të këtyre shpenzimeve nga ana e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor, të **përcaktohen edhe kriteret e subjekteve** që përfitojnë nga këto avantazhe ligjore, procedurat që duhet të ndiqen, si dhe penaltetet në rastet e ofrimit të të dhënave të pavërteta lidhur me kushtet dhe gjendjen ekonomike. Ofrimi i kësaj metode të garantuar për një kategori të caktuar individësh sugjerohet të **realizohet në spitalet publike**, për shkak se shtrirja e këtyre funksionaliteteve në frymën e planifikimit familjar dhe në spitalet private do të përbënte cenim të padrejtë në autoritetit shtetëror në sektorin privat.

Ndërkohë, sa u përket **spitaleve/klinikave private** të miratuara për ofrimin e këtyre trajtimeve kundrejt pagesës, sugjerohet që **shteti të monitorojë në mënyrë eksplicite dhe objektive lidhur me ndërhyrjet që trajtohen prej tyre**, duke garantuar në mënyrë të drejtpërdrejtë konfidencialitetin e çifteve subjekt trajtimi. Një qasje e tillë do të përmirësonte tregun, ndërkohë që prezantimi i praktikave të ndjekura, trajnimit të stafëve mjekësorë në raport me stresin infertil me të cilat përballen këto familje të reja, do të mundësonte **ndërgjegjësimin në një masë të gjerë të popullatës për t’ju drejtuar këtyre metodave** me synim krijimin e një jete të re.

⁴ <http://www.panorama.com.al/fekondimi-in-vitro-do-te-kryhet-edhe-ne-spitalet-publike/>

Të drejtat e njeriut

Znj. Ina Xhepa / Qendra Europiane

Qendra Europiane është një organizatë jofitimprurëse e pavarur, e themeluar në qershor 1999, e cila e ka shtrirë aktivitetin e saj në të gjithë Shqipërinë. Misioni i saj është të kontribuojë në konsolidimin e shtetit të së drejtës, me një fokus të veçantë në standardet e të drejtave të njeriut dhe përmirësimin e njohurisë së përgjithshme mbi procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

1. Respektim dhe zbatim në praktikë i të drejtave të njeriut tashmë të njohura nga kuadri ligjor, veçanërisht – e drejta e jetës, ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor apo degradues, e drejta për liri dhe siguri, akses në drejtësi, liria e shprehjes dhe e drejta për informim, si dhe liria e tubimit.

Në kuadër të respektimit dhe zbatimit në praktikë të të drejtave të njeriut, do të dëshiroja të vendosja theksin në lirinë e tubimit dhe organizimit – një nga liritë me të cilat është **abuzuar shumë në formën e mosdhënies së lejes për organizimin e protestave dhe tubimeve, si dhe me ushtrimin e dhunës ndaj tubuesve/protestuesve**. Një ndër tubimet më të fundit, i cili u realizua në shkelje të masave të marra për kufizimin e përhapjes së Pandemisë Covid-19, ishte pikërisht dhe ai kundër prishjes së Teatrit Kombëtar në Tiranë. Kjo protestë, e cila kulmoi në 17 maj 2020, kishte nisur kohë më parë, me qëllim mbrojtjen e godinës së Teatrit nga shembja. Pavarësisht qëllimit për të cilin u organizua, i cili datonte kohë më parë se nisja e pandemisë, **një pjesë e pjesëmarrësve në këtë protestë, përfshirë këtu politikanë dhe gazetarë, u dhunuan dhe u shoqëruan drejt komisariteve të policisë**. Në vazhdim të organizimit dhe tubimit qytetar ka qenë edhe protesta e gjerë studentore e nisur në vitin 2019. Reagimi kundërshtues studentor erdhi dhe si rrjedhojë e parashikimeve nënligjore për tarifa shtesë për provimet e mbartura. Protesta nisi pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe vazhdoi edhe pranë Kryeministrit. Protestat ishin paqësore dhe u shtrinë edhe në mjediset e universiteteve, ndonëse pati raste kur forcat policore hynë në mjediset universitare, madje dhunuan disa studentë.¹

2. Buxhetim i qëndrueshëm i programeve, që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe respektim i këtyre buxheteve.

Në kuadër të buxhetimit të qëndrueshëm të programeve që mbrojnë të drejtat e njeriut, dëshiroj të ndalem te **Ndihma Juridike Falas**. Plani i Veprimit 2019-2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, ka parashikuar për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dy nënobjektiva kryesorë, ngritjen e sistemit të Ndihmës Juridike Parësore dhe ngritjen e sistemit të Ndihmës Juridike Dytësore, me funksionalitet të plotë. Lidhur me nënobjektivin

¹ Liria e Tubimit dhe Organizimit – Manual i hartuar nga Fondacioni Qendra Europiane në bashkëpunim me Konrad Adenauer Stiftung, Programi i Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore.

e parë, në PV 2019-2021 janë parashikuar një tërësi veprimtarish që lidhen me zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuere; plotësimin e kuadrit nënligjor; ngritjen e 4 zyrave të para rajonale; ngritjen e 4 zyrave rajonale shtesë, rekrutimin dhe trajnimin e punonjësve me trajnim të posaçëm; publikimin e listës së OJF-ve të autorizuara në përfundim të procedurës ligjore, ngritjen dhe funksionimin e klinikave ligjore pranë 4 universiteteve që kanë fakultet juridik juridik - Tiranë, Durrës, Vorë dhe Shkodër etj. Lidhur me nënobjektivin e dytë, në PV 2019-2021 janë parashikuar një tërësi veprimtarish që lidhen me plotësimin e kuadrit nënligjor (pika 1), përzgjedhjen dhe trajnimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë dytësore dhe publikimin e listës; trajnimi i gjyqtarëve; përmbushjen e të paktën 40% të nevojave kombëtare etj. ***Nga sa më sipër, vihet re që PBA 2020-2022 për drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas nuk ka parashikuar të gjitha aktivitetet e programuara për këtë institucion në Planin e Veprimit 2019-2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë.***²

3. Respektim i pavarësisë dhe paanësisë së gjyqësorit.

Sistemi gjyqësor duhet të jetë i pavarur nga palët dhe mbi të gjitha, nga pushtetet e tjera: legjislativi dhe ekzekutivi. Pavarësia e gjykatave në raport me pushtetet e tjera është një nga shprehjet më evidente të parimeve të ndarjes së pushteteve, të shtetit ligjor dhe gjykimit të drejtë. Gjithashtu, paanësia e gjyqësorit është një element tepër i rëndësishëm, i theksuar edhe nga jurisprudenca ndërkombëtare, që lidhet me mosparagjykimin e çështjes për gjykim dhe qëndrimin e paanshëm dhe josubjektiv të gjyqtarëve, lidhur me palët apo çështjen. Në Shqipëri vërehet ***një diskurs politik, i cili ul imazhin e gjyqësorit te qytetarët***, një ndërhyrje dhe ***tejkallim i kompetencave të pushtetit ekzekutiv në pushtetin gjyqësor***, ndërkohë që vetë politikanët shihen duke mbajtur relata joformale me gjyqtarët e gjykatave të ndryshme në vend. ***Korrupsioni*** është një tjetër element, i cili, fatkeqësisht, ka prekur pushtetin gjyqësor në Shqipëri. Të gjitha më sipër sollën nevojën e një reformimi total të sistemit gjyqësor.

4. Bashkëpunim me shoqërinë civile përmes konsultimit publik real dhe jo vetëm pro forma.

Bashkëpunimi institucional me organizatat e shoqërisë civile vazhdon të ndeshë problematika. Qendra Europiane, së bashku me 5 organizata të shoqërisë civile, i janë drejtuar me një kërkesë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë lidhur me Informimin e Shoqërisë Civile mbi PBA 2021-2023 dhe organizimit të proceseve të buxhetimit me pjesëmarrje, në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit

² Analizë e zbatimit të Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë nga institucionet e reja të krijuara në kuadër të reformës në drejtësi dhe institucioneve ekzistuese që veprojnë në fushën e drejtësisë – Fondacioni Qendra Europiane në bashkëpunim me OSFA.

buxhetor Afatmesëm”, në linjë me rregullimet e reja, për shkak të situatës së COVID-19. Nëpërmjet kësaj shkrese është kërkuar dhe organizimi i një seance konsultimi me MFE dhe ekipet e Menaxhimit të Buxhetit në Ministrinë e Linjës, konkretisht në rastin tonë Ministrinë e Drejtësisë. Por në të dyja rastet, ***nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga MFE.***

2. Propozime për ndryshim

1. ***Ndërgjegjësim dhe rritje e kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese mbi rëndësinë e respektimit të të drejtave themelore të qytetarëve.*** Kjo mund të konsistojë në trajnime të vazhdueshme me stafet e institucioneve të ndryshme si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, gjyqtarë e magjistratë, si dhe vlerësime periodike të situatës për të adresuar problematikat dhe për të parë rezultatet e arritura.
2. ***Forcim i sanksioneve për shkelësit e të drejtave të njeriut.*** Këto mund të konsistojnë në shtrëngimin e kushteve për lirim me kusht, arrestin nga shtëpia, shërbimin e provës etj. Gjithashtu, mund të rishikohet kufiri minimal dhe maksimal për disa kundërvajtje dhe vepra penale.
3. ***Ndryshim i retorikës së pushteteve të tjera në lidhje me gjyqësorin, forcim i pavarësisë së këtij pushteti.*** Është e nevojshme të respektohet sistemi gjyqësor si një pushtet i veçantë, i pavarur dhe i paanshëm, pa lidhje të ndërthurura me pushtetet e tjera. Gjithashtu, mund të parashikohen sanksione për të dënuar paragjykimin e procesit si nga ana e vetë gjyqtarëve, ashtu edhe nga ana e pushtetit ligjor apo ekzekutiv.
4. ***Planifikim buxhetor i qëndrueshëm dhe transparent për të gjithë institucionet publike në varësi të ekzekutivit apo të pavarura.***
5. ***Përmirësim i kuadrit ligjor mbi njoftimin dhe konsultimin publik, duke shtuar sanksionet për institucionet që shkelin këtë kuadër.*** Sa u takon dy pikave të mësipërme, sugjerohet rritja e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike ndaj qytetarëve apo grupeve të interesit, nëpërmjet forcimit të sanksioneve për institucionet që nuk e respektojnë detyrimin e llogaridhënies dhe transparencës. Gjithashtu, sugjerohet nxitja e bashkëpunimit të institucioneve publike me organizatat e shoqërisë civile në kuadër të hartimit të programeve buxhetore të qëndrueshme dhe që u përgjigjen nevojave të qytetarëve.

Rinia

Z. Rigels Xhemollari / Qëndresa Qytetare

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

- Sipas raporteve të Qëndresës Qytetare, problem shqetësues është korrupsioni dhe mungesa e transparencës në universitete. 77% e studentëve e perceptojnë praninë e korrupsionit në universitete. Në vitin e fundit akademik, 6 universitetet kanë shpenzuar 2,5 milionë euro për honorarë, 80 000 euro për telefona, 650 000 euro për pajisje zyre dhe 250 000 euro për udhëtime. Ndërkohë, është shpenzuar 0 lek për kërkim shkencor apo shërbime ndaj studentëve.
- Pësia e votës së studentëve në universitete është e papërfillshme, vetëm 10%, fakt që i hap rrugën klanizimit, politizimit dhe ndikimit të universitetit nga faktorë të jashtëm dhe jo nga vetë studentët.
- Mungesa e një strategjie në arsimin e lartë ka lejuar prodhimin e diplomave të paorientuara me tregun e punës, duke nxitur emigracionin dhe papunësinë e studentëve.
- Shkollat e mesme janë ende larg ambicieve për të pasur klase digjitale, ushqim, psikologë të mjaftueshëm apo edhe kushte infrastrukturore, si ngrohja dhe laboratorët.
- Në të gjithë territorin e Shqipërisë operojnë vetëm 4 qendra rinore të mbështetura nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe nga bashkitë. Ky është një numër i pamjaftueshëm për të ofruar mundësi për të gjithë të rinjtë e vendit.
- Organizatat rinore përballen me vështirësi fiskale dhe procedurale për të hapur dhe zhvilluar aktivitetin e tyre në mënyrë të qëndrueshme. Nga ana tjetër, prej 5 vitesh, Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile, AMSHC, nuk kalon fondin e dedikuar për organizatat rinore, i cili duhet të jetë sa 20% e totalit. Në këtë mënyrë, organizatat rinore vendosen në konkurrencë të hapur me organizatat me më shumë eksperiencë.

2. Propozime për ndryshim

Vetingu në arsimin e lartë, duke përfshirë:

- kontrollin e ligjshmërisë së titujve dhe gradave shkencore në vend;

- kontrollin e kurrikulave universitare, duke pastruar sistemin arsimor nga tekstet e kopjuara dhe të vjetruara;
- kontrollin e pasurisë për të gjithë drejtuesit e universiteteve në poste akademike dhe administrative;
- kontrollin e plagjiaturave për të gjitha punimet shkencore të stafeve akademike në vend.

Ndryshimet në ligjin 80/2015 për arsimin e lartë:

- rritja e peshës së votës studentore nga 10% në 30%;
- rritja e autonomisë në hartimin e kurrikulave nga ana e stafeve akademike nga 20% në 40%;
- aplikimi i kredisë studentore.

Lidhja e universitetit me tregun e punës:

- hartimi i një strategjie kombëtare për arsimin e lartë;
- nënshkrimi i marrëveshjeve paraprake me kompani private për përgatitjen e profesionistëve të rinj në funksion të tyre;
- lehtësira fiskale për kompanitë që punësojnë studentët e sapodiplomuar.

Arsimi parauniversitar duhet të përmirësohet në këto drejtime:

- nga 1 psikolog për 3 shkolla, duhet të kemi 3 psikologë për 1 shkollë;
- duhen rritur kapacitetet infrastrukturore në shkolla: laboratorë, palestra, kompjuterë;
- digjitalizimi i procesit të mësimi dhe kurrikulave;
- duhen krijuar zyra karriere funksionale në dispozicion të maturantëve, duke i ndihmuar në zgjedhjen e preferencave të tyre për të studiuar në universitet.

Rinia

Infrastruktura rinore:

- minimalisht, çdo njësi administrative me mesatarisht 50 000 banorë të ketë qendrën e saj rinore;
- qendrat rinore duhet të reformojnë qasjen e tyre ndaj të rinjve, duke siguruar një program ditor apo javor dhe jo të shërbejnë si ambiente me qira për OJF-të rinore.

Organizatat rinore:

- krijimi i një fondi të dedikuar për të mbështetur organizatat rinore;
- transparenca dhe integriteti në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë;
- lehtësira fiskale dhe procedurale në themelimin dhe funksionimin e organizatave rinore.

Mirëqenia e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri: Thellimi i sfidave nga pandemia e Covid-19

Z. Igli Çerpja / World Vision Albania

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Mirëqenia e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri vijon të përballet me **sfida që janë thelluar** dhe më shumë nga situata e **posttërmetit dhe pandemia Covid-19. Mungesa e financimit** të mjaftueshëm të strategjive dhe planeve kombëtare që prekin direkt jetën e fëmijëve dhe, si pasojë, mungesa e shërbimeve në komunitet, kanë sjellë më shumë sfida që kërkojnë zgjidhje sa më parë.

Gjatë muajve qershor-korrik 2020, 477 fëmijë dhe të rinj të moshave nga 12-16 vjeç në 9 bashki të Shqipërisë u përfshinë në studimin “Si një pandemi globale po ndryshon jetën e fëmijëve në Shqipëri dhe Kosovë” nga *World Vision Albania*. Tri çështjet kryesore që theksohen më fort në këtë studim nga fëmijët dhe të rinjtë janë:

1. Rritja e nivelit të stresit te të rinjtë, si pasojë e izolimit social:

- 60% e fëmijëve deklarojnë që janë ndier të stresuar gjatë periudhës së karantinës;
- 41,6% e fëmijëve deklaruan që përvoja e ndjekjes së mësimi gjatë pandemisë ishte stresuese.

2. Mungesa e së drejtës për **arsim cilësor** gjatë periudhës së të mësuarit në distancë:

- 16,4% e fëmijëve deklaruan që e kishin **komplet të pamundur të ndiqnin mësimin online** gjatë periudhës së karantinës;
- 62% prej tyre u shprehën të shqetësuar nëse do t'i riktheheshin procesit të të mësuarit online.

3. **Dhunë fizike dhe emocionale** e shtuar ndaj fëmijëve gjatë periudhës së pandemisë:

- 50% e fëmijëve që **kanë pësuar dhunë fizike**, shprehën se kjo është shkaktuar nga një anëtar i familjes;
- 31% e fëmijëve të përfshirë në studim, deklarojnë që kanë përjetuar të paktën një rast **dhune emocionale**.

Fëmijët janë **në risk të dhunës së shtuar** në familje, si pasojë e një sërë faktorëve që kanë prekur aspektet sociale dhe ekonomike të familjeve, dhe që kanë rritur nivelin e ankthit, stresit dhe pasigurinë për të ardhmen në familjet shqiptare.

Të gjitha këto sfida me të cilat po përballen fëmijët dhe të rinjtë e Shqipërisë kërkojnë vëmendjen e politikëbërësve, organizatave, agjencive dhe institucioneve vendore dhe kombëtare. Mbi të gjitha, theksohet nevoja për **përfshirje të fëmijëve dhe të rinjve në hartimin e politikave dhe shërbimeve** që prekin drejtpërdrejtë jetën e tyre.

2. Propozime për ndryshim

Propozimet në vijim përfaqësojnë diskutime të kryera nga autori dhe 677 të rinj të moshës 14-18 vjeç nga klubet IMPACT në gjithë Shqipërinë, në kuadër të konsultimit të Strategjisë së re të Bashkimit Evropian (BE) për të Drejtave e Fëmijëve 2021-2024, organizuar në tetor 2020. Fushat e prioritarizuara lidhen me: a) mbrojtjen e fëmijëve **nga dhuna në familje**, shkollë dhe komunitet; b) **arsimin cilësor** dhe gjithëpërfshirës; c) përkujdesjen për **shëndetin fizik dhe mendor**. Këto nuk janë vetëm prioritete të grupit të interesit të të rinjve, por duhet të përfshihen në prioritetet kombëtare dhe të financohen, në kuadër të përpjekjeve për anëtarësim në BE.

Propozimet më prioritare renditen më poshtë:

1. **Shtimi i numrit të psikologëve** dhe punonjësve socialë **të kualifikuar, të dedikuar** në shkolla. Kjo duhet të shoqërohet me ngritjen e programeve dhe hapësirave në shkolla ku, nëpërmjet shërbimit të dedikuar, sportit, artit, kontaktit me natyrën, të mbështeten të rinjtë për të përballuar situatat e ankthit, stresit, problemet, ngacmimet, bullizmin, duke marrë shërbimin e duhur.
2. **Trajnimi** i vazhdueshëm në shkolla i mësuesve për **pedagogji dhe ngarkesë të lehtësuar** gjatë procesit mësimor, qoftë në kohë pandemie ose jo, dhe pajisja e shkollave me **infrastrukturën digjitale** të nevojshme, veçanërisht për fëmijët nga familjet në nevojë.
3. Shtimi i numrit të **punonjësve të mbrojtjes** së fëmijëve, trajnimi i vazhdueshëm i tyre, mbështetja për shërbime konkrete sa më afër zonave ku banojnë të rinjtë dhe fëmijët në rastet e dhunës në familje. Kjo kërkon një **sistem të integruar** që punon **kundër dhunës** ndaj fëmijëve së bashku me familjen, shkollën, policinë, institucione të mbrojtjes së fëmijëve etj.

Arti dhe kultura, një vektor i rëndësishëm zhvillimi

Znj. Ilda Mara / Organizata Argjiro

1. Nevoja dhe argumente për ndryshim

Buxhet 1% për kulturën

Arti dhe kultura përbëjnë vetëm 0,4% të buxhetit të shtetit, duke e renditur Shqipërinë të fundit në rajon dhe Evropë. Aspirata jonë është: në 4-vjeçarim e ardhshëm të ndërmerren politika të tilla që sikurse sektorët e tjerë, edhe sektori i artit dhe kulturës të përafrohet me ato të BE-së. Kultura duhet parë si sektor prioritar në ekonominë shqiptare dhe buxheti i saj të rritet nga 0,4% në nivelin ambicioz të 1%!

Kjo është një nismë aktuale e rrjeteve, organizatave, artistëve në mbarë Evropën: ***Supporting Europe is supporting Culture, 1% for Culture***

Paketë financiare lehtësuese

- **Parashikimi i një pakete lehtësuese fiskale** për organizatat kulturore, si p.sh. reduktimi i tatim-burimit (nga 15% në 6% si në rastin e turizmit).
- **Krijimi i një fondi të dedikuar për bashkëfinancimin e projekteve të ndihmës së huaj** pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE):
 - për mbulimin e 15% e bashkë-financimeve për projektet evropiane (fond i dedikuar siç funksionon në Itali, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Kosovë, Greqi);
 - mbështetje e drejtpërdrejtë nga shteti i organizatave dhe subjekteve që rezultojnë fituese nga programet kulturore të BE-së si *Creative Europe* etj., nëpërmjet mbulimit të pjesës së bashkëfinancimit, që për organizatat shqiptare mbetet një sfidë financiare problematike (programi *Creative Europe* kërkon 40-50% bashkëfinancim nga organizatat fituese të granteve).

Statusi i artistit

Ligji për të drejtën e autorit është një avancim për rregullimin e statusit të artistit, por ka ende shumë për të arritur një zbatim transparent:

- Regjistrimi i artisteve të pavarur (*freelancer*) në Drejtorinë Tatimore dhe pajisja e tyre me NIPT; (Rasti i "pagës së luftës" vitin që shkoi ishte një shembull ku artistet e pavarur, të paregjistruar, nuk e përfituan; vetëm subjektet që ishin të pajisur me NIPT).
- Krijimi i regjistrimit për Industrinë Krijuese dhe Kulturore:

- krijimi i kategorive të artisteve dhe profesionisteve të fushës art-kulturë, që ka nevojë për një formalizim dhe kategorizim në regjistrin e profesioneve të rregulluarak
- krijimi i indikatorëve matës të kulturës

2. Propozime për ndryshim

Decentralizim i prodhimit artistik

Nevoja për një qendër kombëtare të ARTEVE të dedikuar arteve pamore, arteve skenike, muzikës, festivaleve, artit të rrugës, projekteve multidisiplinore, industrisë krijuese është një domosdoshmëri e madhe. Një qendër e tillë do të ishte një instrument që do të decentralizonte prodhimin artistik dhe do të bënte të mundur fleksibilitetin e nevojshëm menaxherial në rritjen e buxhetit. Kemi shembuj të dy qendrave të suksesshme: Qendra Kombëtare e Kinematografisë - QKK, dhe Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit - QKLL.

Nxitje e investimit të biznesit në art

Nxitjen e investimit të biznesit në art dhe trashëgimi nëpërmjet miratimit të një ligji të veçantë ose të dispozitave të veçanta, në mënyrë që të krijohen mekanizma mbështetës për t'i çelur dritën jeshile investitorëve privatë në kulturë (modelet franceze dhe italiane të investimit në art).

Përmirësimi i ligjit për sponsorizimet

Një përmirësim i ligjit të sponsorizimeve, duke marrë si shembull modelin italian. Skema e ashtuquajtur **Art Bonus** në Itali lejon një zbritje prej 65% të taksave për dhurimet e pranueshme. Praktika e ofrimit të këtyre përfitimeve do të ishte inkurajimi i privatëve për të dhuruar për artin, kulturën dhe ku roli i institucioneve publike do të përqendrohej në trajtimin, vetëruajtjen dhe promovimin e kulturës.

Iniciativa e qeverisë italiane rrok potencialin e filantropisë në vend, duke krijuar një ulje të taksave pikërisht për mbrojtjen e kulturës italiane, përmes kësaj skeme për donatorë, të cilët duan të japin shuma nga 10 deri në 10 ml. €.

Tiranë, 5 Mars 2021

Lehtësuar nga:



Me mbështetjen e:



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian.

Në bashkëpunim me:

